

R E V

# REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Fuqia e strategjisë

O L U C

GARY KEESEE

I O N I

I dashur mik ne Krishtin,

Lutja jonë është që ky burim mësimor do të jetë bekim dhe inkurajim për ty! Të lutem ndihë i lirë ta ndash këtë material me miqtë, familjen dhe anëtarët e kishës tënde. Gjithashtu, mund të vizitosh [FLNFree.com](http://FLNFree.com) për të shkarkuar kopje shtesë dhe për më shumë mësimë në gjuhën tënde.

Perëndia të do dhe ka një plan të mrekullueshëm për jetën tënde! Të mësonim si operon Mbretëria e Perëndisë e ndryshoi jetën tonë për mirë, dhe besojmë se do të ndodhë njësoj edhe për ty!

Me dashuri në Krishtin

Gary dhe Drenda Keesee



P.S. Mos harro të vizitosh website-in tonë [FLNFree.com](http://FLNFree.com) për të shkarkuar më shumë nga mësimet tona falas në gjuhën tënde!

R E V

**REVOLUCIONI  
YT FINANCIAR**

Fuqia e strategjisë

O L U C

**GARY KEESEE**

I O N I

Revolucioni yt financiar: Fuqia e strategjisë  
E drejta e autorit © 2019 nga Gary Keesee.

Nëse nuk tregohet ndryshe, të gjitha shkrimet e shenjta janë marrë nga varianti i Biblës në shqip nga Shoqëria Biblike Shqiptare (Albanian Bible Society). Të përdorura me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të gjitha të drejtat të rezervuara sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtën e autorit. Nuk lejohet riprodhimi i përmbytjes dhe/ose i kopertinës plotësisht ose pjesërisht në asnjë formë pa pëlqimin e shprehur me shkrim të botuesit.

ISBN: 978-1-945930-14-0

Botuar nga Free Indeed Publishers.  
Shpërndarë nga Faith Life Now.

Faith Life Now  
P.O. Box 779  
New Albany, OH 43054  
1-(888)-391-LIFE

Mund të kontaktosh me "Faith Life Now Ministries" në internet, në adresën [www.FaithLifeNow.com](http://www.FaithLifeNow.com).

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta e autorit

© 2009 Shoqëria Biblike Shqiptare. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje. Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

Ky libër është një dhuratë nga autori dhe NUK ËSHTË PËR SHITJE

Mund të gesh shërbesat e Faith Life Now në internet në [FaithLifeNow.com](http://FaithLifeNow.com)

Më shumë burime nga i njëjti autor gjenden falas për shkarkim në [FLNFree.com](http://FLNFree.com)

# DEDIKIM

Këtë libër dua t'ia kushtoj bashkëshortes sime, Drendës, pasi kanë qenë inkurajimi, pasioni për gjërat e Perëndisë dhe dashuria për familjen e saj dhe për mua që më kanë frymëzuar gjatë gjithë këtyre viteve. Së bashku, ne e kemi vërtetuar se të gjitha ëndrrat bëhen vërtet realitet!

—Gary Keese



# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	7
<b>KAPITULLI 1:</b> Çfarë do ti që të bëjë?.....	19
<b>KAPITULLI 2:</b> Mbretëria.....	33
<b>KAPITULLI 3:</b> Mahnitur.....	41
<b>KAPITULLI 4:</b> Baza: Mos dil nga shtëpia pa këtë.....	57
<b>KAPITULLI 5:</b> Prova e shkrimit të shenjtë.....	75
<b>KAPITULLI 6:</b> A luten të gjithë në gjuhë?.....	85
<b>KAPITULLI 7:</b> Sënduku i thesarit!.....	97
<b>KAPITULLI 8:</b> Pozita e vështirë e promovimit .....	115
<b>KAPITULLI 9:</b> Zëri i vogël, i qetë.....	125
<b>KAPITULLI 10:</b> Vegimet dhe ëndrrat.....	139
<b>KAPITULLI 11:</b> Fryma e Shenjtë flet si shefi im .....	153
<b>KAPITULLI 12:</b> Si të lutesh dhe të marrësh pagëzimin e Frymës së Shenjtë.....	169





# HYRJE

*Revolucioni yt financiar: Fuqia e strategjisë* është libri i tretë i serisë “Revolucioni financiar”. Në përfundim do të jenë pesë dhe të gjithë janë një version i zgjeruar i një konference që zhvillova në Shqipëri në vitin 2005. Dhe pikërisht në këtë konferencë drejtimi i jetës sime ndryshoi në mënyrë rrënjësore. Nëse e ke dëgjuar këtë histori, mund të duash ta kapërcesh hyrjen dhe të nisësh në kapitullin 1. Por nëse nuk e ke dëgjuar, atëherë prit dhe më lër të të tregoj rreth mjegullës blu. “Mjegulla blu”, mund të pyesësh ti, “çfarë është ajo?”. E kuptoj pyetjen. Kur e pashë, as unë nuk e dija se çfarë ishte, por fuqia e Perëndisë është kaq e fortë, saqë e kuptova se ishte prej Tij. Më lejo të ta tregoj historinë.

Unë dhe gruaja ime e filluam martesën me borxhe dhe jetuam me borxhe për nëntë vjet. Jo vetëm me borxhe, por me vuajtje nga stresi dhe frika ligështuese për paratë dhe problemet me paratë. Edhe pse nuk kishim synuar kurrë ta shkatërronim jetën tonë nga ana financiare, kjo është pikërisht ajo që bëmë. Filluam me një kartë krediti të thjeshtë benzine, më pas një kartë Visa, pastaj dhjetë karta Visa. Kur nuk mundëm t'i shlyenim kartat Visa, morëm hua nga kompania financiare me njëzet e tetë deri në tridhjetë e tre për qind interes për të konsoliduar detyrimet tona. Por më pas vazhduam duke i përdorur përsëri kartat dhe borxhi sa vinte e rritej! Në fund, ne përfunduam me dhjetë karta

kreditit të maksimizuara dhe të anuluar, tre hua nga kompanitë financiare dhe konfiskimin tatimor të dhjetëra mijëra dollarë nga IRS, plus shumë borxhe të tjera më të vogla. I kishim borxh dhjetëra mijëra dollarë dentistit tonë, pikave të pastrimit kimik, prindërve tanë, pagesat tona për dy makina, qiranë e një shtëpie dhe lista vazhdon më shumë. Ne jetonim me komisione në atë kohë dhe stresi po më vriste, me të vërtetë. Kisha kriza paniku dhe merrja antidepresantë, të cilët nuk më ndihmonin.

Gjithçka që kishim ishte prishur. Makinat tona kishin bërë të gjitha mbi 200 000 milje. Shtëpia jonë e vogël, e vjetër në fermë, e vitit 1856, të cilën e morëm me qira për 300 dollarë në muaj, kishte probleme. Shumë nga dritaret e vjetra ishin thyer dhe meqë nuk kishim para për t'i riparuar, thjesht vendosim shirit ngjites mbi të çarat. Por edhe kjo nuk mjaftonte. Hardhitë nga jashtë po depërtonin nëpër të çarat e kornizave. Gruaja ime, Drenda, thjesht i shkurtonte sikur të ishin pjesë e dekorit të shtëpisë. Tapetin në dhomën e gjumit të djemve tanë e kishim gjetur anës rrugës në një grumbull plehrash. Dyshekët e tyre i kishim gjetur në një grumbull mbeturinash të një shtëpie pleqsh. Çdo mobilie e kishim gjetur aty ku shiteshin sende të vjetra ose e kishim gjetur të hedhur në grumbullin e plehrave të dikujt.

Jeta nuk është argëtuese kur çdo ditë që zgjohesh e pyet veten se si do ta ushqesh familjen tënde. Frika pushtoi jetën time dhe gëzimi dhe shpresa u mbytën në kaosin e mbijetesës. Drenda dhe unë jetuam kësh-tu për nëntë vite të gjata! Nëntë vite të gjata! Mund ta kuptoj një muaj, apo në rastin më të keq, një vit, por nëntë vjet? Pas nëntë vjetësh me atë lloj stresi, emocionet shprehen të pafiltruara dhe durimi nuk ekziston.

Gjatë gjithë atyre nëntë viteve, ne ishim të krishterë që frekuentonim një kishë të madhe që na mësoi se varfëria nuk ishte vullneti i Perëndisë për popullin e Tij. Ne i jepnim të dhjetat dhe dhuronim shpesh, por gjithsesi financat tona nuk pasqyronin besnikërinë e Perëndisë dhe atë që tregonte Fjala e Perëndisë. Unë kisha një diplomë në studimet e Dhiatës së Vjetër dhe gjithashtu kisha ndjekur për më

shumë se një vit shkollën biblike. E dija se kishte diçka që nuk shkonte, por vetëm vazhdova të shpresoja se, një ditë, gjërat do të ndryshonin. Por ato nuk ndryshuan për nëntë vite të gjata. Kreditorët po telefononin pothuajse çdo ditë dhe Drenda dhe unë kishim humbur pothuajse çdo shpresë.

Përveç kësaj, mjekët thoshin se kisha të gjitha shenjat e fillimit të sëmundjes së diabetit, pasi përballesha me probleme të rënda shëndetësore. Paratë mungonin, çdo kartë krediti ishte anuluar dhe nuk kishte ushqim në shtëpi. Frika ma torturonte jetën deri në pikën që me të vërtetë kisha frikë të dilja nga shtëpia. Gruaja ime filloi të planifikonte në mendjen e saj se si ajo dhe fëmijët do të duhej të ktheheshin në shtëpinë e prindërve të saj, pasi mendonte se po e humbiste burrin e saj. Megjithatë, këtu, në pikën time më të ulët, jeta ime mori një kthesë.

Një avokat më kishte telefonuar dhe unë vazhdoja t'ia premtoja atij pagesën, të cilën kisha shpresuar se mund të bëhej, por nuk i pata kurrë paratë për ta paguar faturën. Kështu që mëngjesin që më mori, e kishte humbur durimin. “Ju duhet t’i sillni paratë këtu pas tre ditësh ose unë do të ngre një padi kundër jush për paratë që i detyroheni klientit tim.” Pikërisht në atë çast e kuptova se shtirja kishte mbaruar. Nuk kisha para dhe as familja ime nuk do të na jepte më hua. I dëshpëruar, ngjita shkallët për në dhomën tonë të gjumit në fermën e vogël, u shtriva mbi shtrat dhe i thirra Perëndisë. Çuditërisht, nga thellësia e shpirtit tim, Ai u përgjigj menjëherë. Së pari, Ai thjesht më kujtoi një shkrim të shenjtë që e kisha dëgjuar dhe lexuar shumë herë, Filipianëve 4:19:

*“Perëndia im do të plotësojë përmes Krishtit Jezu çdo nevojë tuajën, sipas pasurive të tij të laudishme.”*

“Sigurisht, unë e di atë shkrim të shenjtë”, i thashë Zotit dhe vazhdova të them, “por kjo nuk po ndodh në jetën time. Asnjë nga nevojat e mia nuk po plotësohet.” Zoti m’u përgjigj: “Nuk kam asnjë lidhje me ngatërresën në të cilën ndodhesh. Ti je në atë ngatërresë sepse nuk ke mësuar kurrë se si funksionon Mbretëria Ime.” Ai vazhdoi të më thosh-

te disa gjëra të tjera, por mora mesazhin: Borxhi nuk ishte vullneti i Tij për jetën time. Edhe pse u emocionova që e kisha dëgjuar Perëndinë, do të më duhet ta pranoj se nuk e dija se çfarë donte të thoshte me Mbretëri. Unë kisha një diplomë në studime biblike dhe mendoja se e njihja mjaft mirë Biblën, por, me sa duket, gabohesha. Gjëja e parë që bëra pasi dëgjova këto fjalë ishte të gjeja Drendën dhe të pendohesha para saj për ngatërresën në të cilën ishim futur të gjithë. Më pas, të dy iu lutëm Perëndisë dhe i kërkuam të na mësonte se si funksiononte Mbretëria e Tij. Po ashtu, u penduam që mbështeteshim në borxhe dhe vendosëm që nuk do të vareshim më nga borxhi si mënyrë për të jetuar. Por, në realitet, edhe pse kisha një diplomë në studime biblike, në atë pikë Mbretëria ishte një mister. E vetmja herë kur mund të kujtoja fjalën “mbretëri” të përdorur në Dhiatën e Re ishte në Lutjen e Zotit.

*“Ardhtë mbretëria jote, u bëftë vullneti yt, si në qiell, edhe në tokë”*  
(Mateu 6:10)

Ne nuk arrinim ta kuptonim atë që Perëndia po përpiquej të na thoshte, por ndërsa filluam të kërkonim Zotin, Ai filloi të na mësonte. Gjëja e parë që duhej të kuptonim ishte se çfarë ishte mbretëria dhe pse Perëndia e kishte përdorur atë term. Çfarë po përpiquej të na tregonte? Pas disa kërkimeve, mësova se një mbretëri nuk ishte thjesht një turmë njerëzish. Ishte një turmë njerëzish që jetonin nën juridiksionin e një qeverie dhe një mbreti. Në fakt, fjala “mbretëri” në të vërtetë i referohet sundimit të një mbreti. Sundimi i mbretit, ose autoriteti dhe ligjet e tij, i përcillen çdo qytetari nën sundimin e tij nëpërmjet qeverisë së tij. Pra, këtu gjendej një çelës kryesor për mua: Mbretëria e Perëndisë është një qeveri.

Dhe qeveritë kanë ligje!

Pra, unë e shihja Perëndinë siç e shohin shumica e të krishterëve, duke e kuptuar gabim atë që Ai mund të bëjë. Unë supozova se për shkak se ishte Perëndi, Ai mund të bënte gjithçka që donte, kur të donte. E di që në këtë pikë të librit do të thuash se e kam gabim, por më lejo të vazhdoj. Për shkak se besoj se Perëndia mund të bënte gjithçka

që donte, kur të donte, e shihja lutjen pa përgjigje si një kërkesë që Ai e kishte mohuar. Kjo pasiguri në lidhje me lutjen më shtynte vetëm të shpresoja se Ai do të përgjigjej. Kështu, formati i pjesës më të madhe të lutjeve të mia ishte ai i përgjërimit dhe thirrjes për mëshirë, duke shpresuar vetëm që rasti im të dukej mjaft serioz për të tërhequr vëmendjen e Zotit. Por kur Perëndia filloi të më mësonte se e gjithë Mbretëria e Tij është një qeveri me ligje që ne mund t'i mësojmë dhe t'i përdorim, u emocionova. Mësova se kur erdha te Krishti u bëra trashëgimtar dhe qytetar i Mbretërisë së Tij të madhe.

*“Prandaj ju nuk jeni më të huaj e bujtës, por jeni bashkëqytetarë me të shenjtët dhe pjesëtarë të shtëpisë së Perëndisë” (Efesianëve 2:19).*

Mbaj mend që e lexova atë shkrim të shenjtë dhe mendova: *Unë kam të drejta ligjore në Mbretërinë e Tij!* A mund të jetë vërtetë kaq e thjeshtë? Si qytetar i Shteteve të Bashkuara, nuk kam pse të lutem dhe të *përgjërohem* për atë që tashmë është e imja si qytetar. Nuk më duhet të *ndiej mornica* për të provuar se jam qytetar. Unë kam lindur këtu. Kur u rilinda në Mbretërinë e Perëndisë, u bëra qytetar i Mbretërisë së Tij. Kjo do të thotë se unë kam akses ligjor në çdo ligj dhe përfitim të *mundshëm* që është regjistruar në ligjet e Mbretërisë së Tij. Bota ime ndryshoi në mënyrë rrënjësore kur Perëndia filloi të ma tregonte këtë. Pra, unë dhe Drenda, si shumica e të krishterëve, nuk e kuptonim Mbretërinë dhe ligjet e Mbretërisë.

Në fakt, kur dikush përballet me një kohë vështirësie, do të dëgjosh shumicën e të krishterëve të thonë gjëra të tilla si: “Perëndia lejon, Perëndia e di më mirë, Perëndia e ka nën kontroll, ose Perëndia është sovran”. Këto komente tregojnë besimin se Perëndia ka fuqinë për të dhënë përgjigjen, por nuk është i gatshëm ose nuk ka vendosur të përfshihet. Këto koncepte të rreme në lidhje me Perëndinë janë rezultat i mosnjohjes së karakterit të Perëndisë ose të moskuptuarit se si funksionon Mbretëria e Perëndisë.

Më lejo ta ilustruj atë që po them. Nëse do të kishe një miliard do-

llarë në bankë, do të thoshe: “Unë kam një miliard dollarë.” Por fakti është se ti nuk ke një miliard dollarë në xhep kur e thua këtë. Përkundrazi, ti ke një miliard dollarë në një institucion, për transferimin e të cilave duhet të ndjekësh një proces ligjor për t’i sjellë në duart e tua. Mbretëria e Perëndisë është e njëjtë. Si qytetarë dhe anëtarë të shtëpisë së Perëndisë, ne në fakt jemi trashëgimtarë të gjithçkaje që ka Perëndia. Por ka ligje dhe procese përmes të cilave ne e marrim atë që tashmë është e jona ligjërisht.

Meqenëse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë Mbretërinë e Perëndisë dhe nuk i kuptojnë proceset dhe ligjet përmes të cilave ajo funksionon, kur diçka nuk ndodh siç e thotë Fjala e Perëndisë, njerëzit supozojnë se faji është i Perëndisë, jo i tyre.

Ja se çfarë zbulova. Le të themi se ke vendosur të hidhesh nga “Empire State Building”, pa parashutë, pa asgjë, por je i bindur se nëse i përplas krahët aq fort sa duhet, mund të fluturosh poshtë pa u rrezikuar. Mendoj se e di rezultatin e asaj akrobacie të pamend. Arsyeja pse e di rezultatin është sepse ti e kupton ligjin e rëndesës. Duke ditur që ligji i rëndesës nuk ka anësi, nuk ka të preferuar dhe funksionon në të njëjtën mënyrë çdo herë, do të ishe i sigurt për rezultatin. Në të njëjtën mënyrë, kur ndez një çelës dritash, pret që dritat të ndizen sepse i kupton ligjet e elektricitetit. Kur udhëtoj me aeroplan, pres që ai të fluturojë sepse e kuptoj ligjin e ngritjes në ajër. Aeroplanët dhe dritat funksionojnë çdo herë ngaqë funksioni i tyre bazohet në ligje që mund të mësohen dhe më pas të kopjohen për të prodhuar të njëjtat rezultate dhe funksion çdo herë. Mbretëria e Perëndisë vepron me të njëjtin nivel sigurie.

*Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson: Dhe nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij.*

— 1 Gjonit 5:14-15

Kjo është siguria jonë. Nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të Perëndisë, ne e dimë se Ai na dëgjon, dhe nëse e dimë se Ai na dëgjon, ne e dimë se e kemi atë që kemi kërkuar prej Tij. Pra, unë mund të jem i sigurt për rezultatin, sepse Mbreti është ai që e ka bërë ligjin. Ai gjithashtu do ta mbështesë ligjin e Tij. Kur shkrimi i shenjtë thotë se Ai na dëgjon, nuk i referohet dëgjimit të fjalëve tona në mënyrë të dëgjueshme, por përkundrazi, i referohet mënyrës se si një gjykatës e dëgjon një çështje për të bërë drejtësi. Gjykatësi nuk gjykon bazuar në ndjenjat e tij, por përkundrazi, ai është aty për të garantuar që ligji të zbatohet për të mirën e qytetarëve të mbretërisë. Unë tashmë e di se si do të përfundojë çështja gjyqësore që para se të fillojë.

Kur filluam të zbatonim ligjet e Mbretërisë në jetën tonë, Drenda dhe unë pamë që ndodhnin gjëra të jashtëzakonshme. Ne u çliruam plotësisht nga borxhet pas rreth dy vjet e gjysmë. Ne kaluam nga detyrimi për të ndarë një “Vakt të lumtur” midis tre fëmijëve në kryerjen e pagesës me para në dorë për makina të reja dhe ndërtimin e shtëpisë sonë të ëndrrave në 22 hektarë, si dhe shlyerjen e saj. Ne krijuam kompani që ende vite më vonë po gjenerojnë me qindra mijëra dollarë fitime neto. Më pas hapëm një kishë në qytetin tim të lindjes për të ndarë me njerëzit atë që zbuluam për Mbretërinë e Perëndisë. Dhe zbuluam se shumë njerëz duan të dinë atë që zbuluam dhe të jetojnë jetën e mirë që ofron Mbretëria e Perëndisë. Për shkak të lajmit të mirë të Mbretërisë, kisha është rritur që nga ajo kohë duke u bërë mijëra herë e fortë.

Megjithëse ia mësoja Mbretërinë pothuajse çdo ditë kujtdo që do të dëgjonte, kisha dëshirë që, në formën e një eksperimenti, të kontaktoja një grup njerëzish që nuk e kishin dëgjuar kurrë më parë. E dija se për të parë ndryshimin në jetën e dikujt në lidhje me kuptueshmërinë e tij për Mbretërinë, do të më duhej më shumë se një seancë për të përcjellë kuptimin bazë të Mbretërisë. Koncepti që mendoja se do të funksiononte lindi nga përvoja ime duke u rritur në një kishë metodiste. Kur isha i ri, zhvilluam takime ripërtëritjeje një-javore gjatë

mbrëmjeve. Kështu që unë ëndërroja të zhvilloja një ripërtëritje financiare një-javore. E parashikova që të zgjaste pesë seanca në mbrëmje. Nuk e kisha dhënë kurrë më parë mësim rresht pas rreshti Mbretërinë dhe pyesja veten se si do ta realizoja këtë. Por unë isha kureshtar se çfarë ndikimi do të kishte mësimdhënia e pesë seancave rresht te njerëzit që do ta dëgjonin atë. Fillova të lutem për mbajtjen e një takimi të tillë dhe i kërkova Perëndisë një mundësi për ta bërë këtë. Kërkesa ime do të ishte t'ia mësoja atë një grupi njerëzish që nuk e kishin dëgjuar më parë.

Një pasdite, takova një mikun tim që ishte misionar në Shqipëri. Biseda jonë u rrotullua rreth shumë aspekteve të kishës dhe shërbesës dhe, përfundimisht, biseda jonë u zhvendos drejt asaj që më kishte treguar Perëndia. Lerrri do të zhvillonte konferencën e tij mbarëkombëtare vjetore të shërbimit në Shqipëri më vonë atë vit, në vjeshtë, dhe më ftoi të isha një nga folësit. Nuk ia tregova dëshirën time për të bërë pesë seanca, por u emocionova kur tha se do të bëja tre seanca atje. Ai tha se do të më duhej të paguaja udhëtimin, si dhe të paguaja udhëtimin e shumë prej pastorëve që donin të vinin, pasi Shqipëria në atë kohë ishte shumë e varfër. Unë rashë dakord dhe bëra plane për të mbërritur në Shqipëri në vjeshtën e vitit 2005.

Më në fund erdhi koha e udhëtimit, dhe unë u emocionova aq shumë që do të mund t'i mësoja për Mbretërinë një grupi njerëzish që sapo kishin filluar të mësonin se çfarë do të thoshte të ishe një i krishterë. Kur mbërrita në Shqipëri, Lerrri më priti në aeroport dhe tha se një nga folësit e tij kishte bërë anulim dhe se tani do të bëja pesë seanca. E kuptova që ky ishte një organizim i Frymës së Shenjtë me siguri! Kisha shënime për tre seanca, por shpejt u luta dhe i shkrova dy seancat e tjera. Isha pak i shqetësuar se si do të përgjigjeshin njerëzit pasi varfëria e tyre ishte e rëndë dhe korrupsioni prekte çdo aspekt.

Gjatë seancës së parë e kuptova që ata ishin pak hezitues, por ndërsa vazhdova t'u jepja mësim atë që më kishte mësuar Perëndia, së bashku me historitë që vërtetonin atë që po u mësoja, njerëzit u bënë më të lumtur dhe më të emocionuar. Në seancën time të katërt, ata qeshnin



dhe ishin aq të lumtur për atë që po dëgjonin, saqë disa po bërtisnin. Çuditërisht, ndjeva se Zoti më tha se do të mblidhja një ofertë në seancën e pestë. E them çuditërisht sepse kisha paguar që shumë nga këta njerëz të vinin në mbledhje dhe e dija që paratë e tyre ishin shumë të pakta ose të papërfillshme. Por pasi e mendova këtë, kuptova se njerëzit do të duhej të vepronin sipas asaj që po dëgjonin. Megjithatë, isha pak i shqetësuar se si do t'ia thosha Lerrit këtë, por ai më tha menjëherë që të vazhdoja me mbledhjen e ofertës. Sigurisht, nuk po mblidhja një ofertë për veten time; oferta do të qëndronte atje në Shqipëri për të mirën e kishave shqiptare.

Erdhi seanca e fundit dhe unë po jepja mësim në përputhje me çlirimin e besimit, duke sqaruar disa nga ligjet që i kisha dhënë mësim. Në fund të shërbesës, kur mblodha ofertën, gjithçka u çlirua. Njerëzit filluan të bërtisnin dhe të kërcenin ndërsa vajosja e Perëndisë mbushi sallën. Kishim katër veta që qëndronin përpara me kosha, dhe ata mezi qëndronin në këmbë. Ata qanin dhe dridheshin nën praninë e Perëndisë ndërsa njerëzit sillnin ofertat e tyre. Nuk kisha parë kurrë një takim të tillë, sidomos për dhënien e parave!

Pasi unë dhe Lerrri dolëm nga takimi, folëm se si u befasuam nga vajosja e fuqishme dhe përgjigja e njerëzve atë natë. Pasi mbërritëm në apartamentin e Lerrit, ai ishte kureshtar të numëronte paratë pasi kurrë më parë nuk kishte pasur dy çanta plot me para nga një ofertë. Një e katërta e një çante ishte shuma e zakonshme që ai tha se kishte mbledhur nga një ofertë në të kaluarën. Ndërsa Lerrri e hodhi përmbajtjen në tavolinën e dhomës së tij të ndenjes, papritmas një mjegull blu e lehtë e mbushi dhomën dhe një vajosje siç nuk e kisha ndjerë kurrë më parë erdhi mbi ne. Nuk mund të bënim gjë tjetër veçse të uleshim përsëri në vendet tona. Teksa shikoja grumbullin e parave në tavolinën përpara nesh, vura re unazën e martesës së një burri në mes të grumbullit. E dija që unaza ishte dhënë nga dikush që nuk kishte para, por që kishte dhënë gjithçka që kishte. Ndërsa pashë unazën, Zoti më foli.

“Unë po të thërras të shkosh te kombet për t’ua mësuar besëlidhjen

Time të bekimit financiar dhe kudo që të të dërgoj, unë do të paguaj për të.»

U trondita. Nuk munda të flija për tre ditë. Ajo vajosje më zgjati për javë të tëra më pas. Nëse do të takoja ndonjëherë dikë nga një komb tjetër, do ta ndjeja përsëri atë vajosje. Edhe pse oferta u la për kishat shqiptare, pasi u ktheva në shtëpi, Lerrri më telefonoi dhe tha se Zoti i tha të më dërgonte unazën. U emocionova. Megjithëse nuk i kisha thënë asgjë Lerrit për dëshirën time për ta pasur atë unazë, ai e dëgjoi nga Perëndia dhe ma dërgoi. E desha atë unazë në përkujtim të asaj që më tha Zoti dhe sot e kam të vendosur në mur.

Kur u ktheva në shtëpi në Ohajo, një mik pastor i Lerrit, i cili drejton një kishë të vogël në Juta, dëgjoi për atë që ndodhi në Shqipëri dhe më kontaktoi për të dalë nëse do të doja. Ai shërbente si pastor në një rezervat indian dhe tha se njerëzit ishin shumë të varfër. Ai tha se kisha e tij kishte vetëm rreth 60 njerëz, por unë i thashë se nuk kishte problem; do të shkoja.

Zhvillova po ato pesë seanca që kisha dhënë në Shqipëri. Nuk e pashë mjegullën blu atje, por vajosja ishte përsëri jashtëzakonisht e fortë.

Oferta në këtë rast ishte për shërbimin tim, kështu që mbylla zinxhirin e çantës së parave dhe e çova në Ohajo. Kur mbërrita në zyrë, ia dhashë çantën sekretares sime për ta numëruar dhe për ta depozituar, gjë pas së cilës u nisa për në drekë. Ndërsa isha në drekë, më ra telefoni celular dhe pashë të shfaqej numri i telefonit të sekretares sime. Megjithatë, kur iu përgjigja telefonit, nuk dëgjova askënd në linjë. Kur po bëhesha gati ta mbyllja telefonin, mendova se dëgjova dikë duke qarë. «Trejsi?», i thashë. Trejsi u përgjigj, duke u përpjekur të përmbante emocionet e saj. «Pastor,» tha ajo, «çfarë ndodhi në Juta me këto para?» «Çfarë do të thotë çfarë ndodhi me paratë?» «Epo,» tha ajo, «kur hapa çantën dhe e derdha në tavolinën time për ta numëruar, papritmas vajosja e Perëndisë erdhi aq furishëm mbi mua, saqë rashë në tokë. Sekretarja tjetër që e dëgjoi zhurmën doli nga zyra e saj për të parë se çfarë

po ndodhte dhe fuqia e Perëndisë e goditi në të njëjtën mënyrë! Çfarë ndodhi me paratë, pastor?” I tregova asaj se çfarë kishte ndodhur në Juta dhe vajosjen e fortë të përjetuar atje ndërsa mblodha ofertën, por përveç kësaj, asgjë tjetër nuk ndodhi në të vërtetë. Më duhet ta pranoj se m’u ngjall kureshtja për atë që po ndodhte pasi kurrë më parë nuk kisha dëgjuar apo parë diçka të tillë. Edhe pse nuk e kuptova, dukej qartë se vajosja nga mbledhja ishte mbi ato para! Vërtet!

Filluam të zhvillonim ato që i quajtëm “Konferenca të revolucionit financiar” në të gjithë vendin, në kisha të mëdha dhe të vogla, kudo ku dikush dëgjonte. Edhe pse mjegullën blu e pamë vetëm në disa raste, vajosja ishte gjithmonë shumë e fortë. Ashtu si në Shqipëri, edhe në ofertën nga kisha indiane në Juta, vajosja linte gjurmë mbi vetë ofertën. Vura re se, pas një takimi dhe pasi oferta ishte numëruar, mund të mbaje një monedhë nga ajo ofertë dhe thjesht të filloje të dridheshe nën fuqinë e Frymës së Shenjtë. Një tjetër gjë interesante që vumë re ishte se çdo para ose çek ishte i ndryshëm. Ata të gjithë nuk kishin të njëjtin nivel vajosjeje mbi ta. Më vonë mësova se kjo ishte si rezultat i besimit të çliruar mbi ofertën nga individit. E pabesueshme!

Seria “*Revolucionit yt financiar*” me pesë libra trajton pesë seancat që bëra në atë takim të parë shqiptar. Librat janë, natyrisht, pak më të zgjeruar se konferenca e parë. Unë besoj se ndërsa fillon ta studiosh Mbretërinë ashtu siç e kemi bërë Drenda dhe unë, do të ndryshojë mënyra se si e shikon gjithçka, ashtu siç ndodhi dhe me ne. Ky libër, i treti i serisë, u quajt fillimisht *Pasuri nga Fryma e Shenjtë* kur e dhashë mësim në Shqipëri. Besoj se ky pohim është i vërtetë edhe sot. Do të jenë strategjitë e frymëzuara nga Fryma e Shenjtë ato që do të bëjnë që të përparosh. Shpresa ime është që përmes këtij libri të mësosh se si Fryma e Shenjtë vepron në mbretërinë e tokës për t’i realizuar ato strategji.



# KAPITULLI 1

## ÇFARË DO TI QË TË BËJMË?

Kur u ktheva për herë të parë nga Shqipëria, isha lëmsh. Ndikimi i asaj që Zoti kishte bërë në jetën tonë dhe më pas mënyra se si Ai më kishte thënë se do ta çoja këtë te kombet ishte tepër i fortë. Kombet? Unë isha personi që i tha Drendës kur u martuam se nuk do të udhëtoja kurrë dhe kurrë nuk doja të shkoja në një udhëtim misioni në vende të tjera. Por Perëndia kishte plane të tjera, sigurisht. Unë do të shkoja te kombet, por si? Kisha një biznes që mbulonte pjesën më të madhe të Shteteve të Bashkuara, një kishë për të drejtuar, një familje për t'u kujdesur dhe një mori përgjegjësish të tjera. Thjesht nuk e kuptoja se si mund të shkoja te kombet. Por Perëndia kishte një plan, një plan që me të vërtetë nuk më kërkonte të udhëtoja, një plan që nuk do ta kisha marrë kurrë në konsideratë, as nuk doja ta merrja në konsideratë – televizionin.

Unë dhe Drenda nuk dinim absolutisht asgjë për televizionin. Në atë kohë, as shërbesat tona nuk i regjistronim në video. Por Perëndia filloi të na tregonte se çfarë do të ndodhte dhe si të vepronim, dhe ne po ndjenim tërheqjen për ta shqyrtuar idenë e televizionit. Gjëja e parë që mësova ishte se duhen para, shumë para për të bërë programe në TV. Kur i bëmë llogaritë, zbuluam se do të duheshin rreth 300 000 dollarë për të nisur punën vitin e parë të TV. Më duhet ta pranoj se u trondita

pak se sa i shtrenjtë ishte televizioni. Problemi kryesor ishte se kisha tashmë kishte bërë shumë shpenzime financiare pasi po ndërtonim “Now Center” (Qendra Tani), kampusin e shërbimit tonë dhe thjesht nuk kishte para shtesë për të paguar për TV. Dhe këtë i thashë Zotit, se nuk kishte para për të nisur TV tani. Mbaj mend që Ai ra dakord me mua dhe më tha: “Po, prandaj për të do të paguani ti dhe Drenda!”

Është eufemizëm të thuash se u tronditëm, veçanërisht pasi ishim pikërisht në mes të një projekti ndërtimi prej gjashtë deri në shtatë milionë dollarësh me kishën. Më beso, projekti “Now Center” në vetvete ishte një sipërmarrje e madhe besimi dhe po përthithte të gjitha burimet që po grumbulloheshin. Plus, Drenda dhe unë ishim zotuar të jepnim 250 000 dollarë për projektin, dhe në atë kohë nuk i kishim ende të gjitha ato para. Të shtojë 300 000 dollarë të tjera mbi këtë shifër, që do të duhej brenda të njëjtit vit, dukej e pamundur.

E dija se udhëtimi që kisha nisur ishte i Zotit dhe premtimi i Tij për të siguruar paratë kudo që më dërgonte, po jehonte ende në shpirtin tim. Por megjithatë, në mënyrë të natyrshme, pavarësisht se si i shikoja shifrat, nuk mund të shihja asnjë mënyrë se si Drenda dhe unë

**E DIJA SE PERËNDIA ËSHTË  
BESNIK NDAJ FJALËS SË  
TIJ DHE E DIJA SE DO TË  
MË DUHEJ TË VEPROJA ME  
BESIM, DUKE I BESUAR  
ATIJ QË TË MË TREGONTE  
SE ÇFARË TË BËJA.**

do të ishim në gjendje t'i paguanim ato 300 000 dollarë përveç gjithçkaje tjetër që po bënim.

E dija se Perëndia është besnik ndaj Fjalës së Tij dhe e dija se do të më duhej të veproja me besim, duke i besuar Atij që të më tregonte se çfarë të bëja. Do të doja të të thosha se isha i sigurt dhe i pashqetësuar për këtë

vendim, por nuk isha. Kisha po përdorte çdo qindarkë të ardhurash për ndërtesën. Të gjitha paratë e mia personale po përdroreshin për të paguar 250 000 dollarët për të cilat isha zotuar dhe shumë anë të tjera në biznesin tim gjithashtu duhej të financoheshin atë vit. Thjesht nuk

kishte para në dispozicion për koston fillestare prej 300 000 dollarësh për televizionin!

Unë dhe Drenda kishim planifikuar një pushim dyjavor në Havai dhe kur të kthehesha në shtëpi, do të më duhej të firmosja kontratat për të filluar me TV. Sigurisht që më pëlqen Havai, por më duhet ta pranoj se ishte pak e vështirë të çlodhesha plotësisht pasi ishte e vështirë ta hiqja nga mendja peshën e këtij vendimi me të cilin do të përballesh kur të mbërrija në shtëpi. Përveç aspektit të parave të të bërit televizion, unë isha krejtësisht i papërgatitur për të bërë TV pasi e kisha siklet të flisja para kamerës. Mund të flisja me mijëra njerëz në një takim, por para një kamere televizive, thjesht më kapi paniku. Me gjithë këto që kalonin nëpër mendjen dhe shpirtin tim, po luftoja me frymën e frikës për të marrë atë vendim.

Megjithëse e dija me bindje se e kisha dëgjuar nga Zoti, përsëri po përballesh me faktin se thjesht nuk kishte para. Biznesi im ishte tashmë i shtrënguar financiarisht për atë vit, dhe nuk arrija ta kuptoja se si kjo mund të funksiononte. Po, ishte frikë, po, ishte mosbesim. Unë e di këtë. Po tregohem i sinqertë. E dija se duhej të kapesha pas Fjalës dhe t'i hiqja sytë nga ajo që kisha dhe të vazhdoja ta shikoja atë unazë. Ai tha se do të paguante për të! Gjatë kësaj kohe, një monedhë ari u hodh në një prej ofertave tona. Sinqerisht, nuk kisha parë kurrë një monedhë ari përpara se ta mbaja këtë monedhë në dorë. Ndërsa e mbajta, Zoti më foli. “Ashtu siç i tregova Pjetrit se ku ishte monedha për të paguar taksat e tij, unë do të të tregoj se ku t'i gjesh paratë për të paguar për TV.”

E mora atë monedhë ari me vete në pushimet tona në Havai dhe ecja përgjatë plazhit dhe lutesha, duke mbajtur atë monedhë për të më kujtuar se Perëndia e kishte zgjidhur çështjen e TV. Udhëtimet e mia të lutjes në plazh zakonisht ishin të tilla. Pasi lutesha në Frymë për disa minuta, kisha paqe për nënshkrimin e asaj kontrate dhe filloja të ecja përsëri drejt shtëpisë, por sa ngjitesha vetëm rreth 6 deri në 15 metra

në kodër, mendja ime fillonte të më bërtiste përsëri se në tokësoren nuk kishte mënyrë për t'i gjetur paratë. Faktet ishin se nuk kishim para, nuk dinim të bënim televizion, nuk kishim pajisje e kështu me radhë. Por në shpirtin tim vazhdova të dëgjoja atë që më tha Zoti në Shqipëri, se kudo që të më dërgonte, Ai do të paguante. Ishte tashmë në muajin maj kur kjo po ndodhte dhe, në realitet, më duhej të kisha 300 000 dollarë deri në fund të vitit që kjo të funksiononte, gjë që ma bënte edhe më të vështira për ta ngjitur atë mal.

Edhe fryma e frikës po më fliste, duke vënë në provë vendosmërinë time për t'u kapur fort pas asaj që Perëndia më tha. «Ti jep mësim për integritetin financiar dhe se çfarë do të thotë të mos i paguash dot faturat e tua?» Atëherë kthehesha mbrapa sërish në atë plazh, duke u lutur dhe duke ripërtërirë mendjen time me Fjalën e Perëndisë derisa të gjeja paqe për të. Bëra ecejake para-mbrapa, duke luftuar në mendjen dhe shpirtin tim për këtë kontratë për rreth një javë derisa e kuptova me siguri që gjithçka do të shkonte mirë dhe frika nuk mund të më mundonte më me mendime negative. Unë dhe Drenda nuk e kishim idenë se nga do të vinin paratë, por e dinim se Perëndia na kishte folur. Kështu që kur u ktheva në shtëpi, e nënshkrova kontratën dhe filluam të mësonim se si të bëjmë TV.

Për sa i përket aspektit financiar të ekuacionit, çuditërisht, mora një telefonatë nga një burrë në Atlanta, të cilin nuk e njihja, disa muaj para se të planifikoheshin këto pushime në Havai. Ai tha se e kishte parë librin tim mbi financat dhe e kishte pëlqyer. Në atë kohë, librin e botoja vetë dhe nuk ishte shitur askund, përveçse në qytetin tim. Por me sa duket një nga punonjësit e mi kishte bërë pushime në Atlanta dhe kishte filluar një bisedë rreth punës që bënte me këtë njeri, të cilin e takoi rastësisht në aeroport. Dhe ndodhi që punonjësi im e kishte me vete librin tim dhe ia dha atij.

Kështu, pasi e lexoi, ai tha se ishte aq i interesuar për të, sa që i duhej të fliste me mua. Biseduam për një kohë të gjatë dhe ai përmendi



se ishte një ungjilltar udhëtues, fokusi kryesor i punës së të cilit ishin vendet e huaja. Ai më pyeti nëse mund të takoheshim dhe unë i përmenda se do të isha në aeroportin e Atlantës pas rreth një muaji rrugës për në një takim, që do të ndodhte pas pushimeve të mia. Ne ramë dakord të takoheshim. Patëm një bisedë të mrekullueshme kur më në fund u takuam. Më pëlqeu shumë të dëgjoja të gjitha historitë e tij të mrekullive dhe rreziqeve me të cilat duhej të përballej shpesh në udhëtimet e tij. Por tema e financave ishte e përbashkëta jonë. Ai dukej i magjepsur nga libri im dhe historia ime e shpëtimit nga borxhi.

Gjatë bisedës sonë, ai më tha se sapo ishte kthyer nga Sharlot, ku ishte i ftuar në një emision televiziv dhe mendoj se historia ime financiare do të ishte një histori e mrekullueshme për atë emision. Ai tha se do t'ua jepte librin tim dhe do t'u tregonte për mua. Ndjehesha pak i tronditur nga e gjithë kjo.

As që kisha dëgjuar për programin televiziv që ai kishte përmendur, por sigurisht, disa javë më vonë, mora një telefonatë nga drejtori i programit që më pyeti nëse do të doja të isha në emision. Një nga kërkesat për të qenë në emision ishte të kishe një produkt që mund ta ofronin në transmetim. Kështu që u thashë se kisha një regjistrim me pesë CD të mësimin tim të Revolucionit Financiar. Më thanë se ishte gjë e përsosur dhe më pas ne ramë dakord për çmimin me të cilin do t'ua jepja kompletet e CD-ve. Sigurisht, serinë ua dhashë me çmim shumice, por edhe duke e prodhuar serinë me shumicë, krijova mundësinë e njëfarë fitimi për shërbimin tonë. Çuditërisht, emisioni pati shumë sukses dhe ne shitëm mijëra e mijëra nga ato komplete CD-sh. Vetëm fitimet nga kjo ishin me mijëra për buxhetin tonë televiziv nga një burim për të cilin nuk dija asgjë kur e nënshkrova atë kontratë.

Pastaj një tronditje tjetër: një burrë i kishës sime, i cili erdhi në kishën time i falimentuar financiarisht dhe gati për t'u dëbuar nga shtëpia disa vjet më parë, m'u afrua dhe donte të ndihmonte me financimin e transmetimit televiziv. Ai kishte praktikuar atë që kishte

dëgjuar të predikohej për Mbretërinë dhe nuk ishte më i varfër. Ai më dha 120 000 dollarë për shërbimin tonë televiziv!

Duke llogaritur shitjen e atyre kompleteve të CD-ve, dhuratën nga miku im në kishë dhe dhuratat e tjera që erdhën, unë dhe Drenda nuk kishim nevojë të vendosnim fare nga paratë tona për vitin e parë të televizionit! Perëndia u tregua besnik ndaj fjalës së Tij. Ai tha se do të paguante për të dhe Ai e bëri. Në rregull, gjysma e problemit u zgjidh, por unë kisha një problem tjetër po aq të madh që duhej të zgjidhej. Siç thashë më herët, nuk dija asgjë rreth bërjes së TV!

Atë vjeshtë, Drenda mori pjesë në një konferencë të madhe të grave të krishtera dhe e ftuan të shkonte në dhomën e gjelbër ku të gjithë të ftuarat mbledheshin në mes të mbledhjeve. Ishte një nder i madh për Drendën që e ftuan dhe ajo ishte e emocionuar që do të shkonte. Pas një seance, ndërsa u ul për të ngrënë drekë, pranë saj u ul një grua që nuk e kishte takuar kurrë më parë. Pasi shkëmbyen pak informacion për njëra-tjetrën, papritmas gruaja pyeti: “Pra, a jeni duke bërë akoma TV?” Drenda u befusua pak, por tha: “Jo, por ne po mendonim për këtë.” Gruaja më pas tha: “Epo nëse e bëni, telefono këtë djalë dhe ai mund t’ju ndihmojë.” Drenda shkroi numrin dhe emailin që gruaja i dha dhe e futi në çantë.

Kaluan disa javë në shtëpi dhe ajo e harroi vërtet copën e letrës që e kishte futur në çantë. Por një natë, pasi e gjeti, ajo vendosi t'i dërgonte një email djalit vetëm për të parë se çfarë do t'i thoshte. Ai dukej i interesuar dhe i kërkoi asaj t'i dërgonte kompletin e CD-ve të mia të *Revolucionit Financiar*, gjë që ne e bëmë. Pas një jave apo më shumë, ndihmësi i tij na telefonoi përsëri dhe tha se ky zotëri ishte shumë i interesuar dhe donte të na takonte në konferencën vjetore të Transmetuesve Kombëtarë Fetarë, e cila ishte pas disa javësh. Ne i thamë se do të vinim.

Drenda dhe unë shkuam me makinë në konferencë dhe ishim pak nervozë para takimit. Kisha blerë një kostum të ri, të zi, për takimin

dhe vërtet nuk dija çfarë të prisja. Ai na kishte kërkuar që ta takonim në suitën e tij të hotelit për të diskutuar për TV. Teksa ngjiteshim në suitë, më kujtohet se fillimisht ecëm lart e poshtë në korridor disa herë përpara se të trokisnim në suitën me dy dyer, sa për t'u qetësuar pak. Ndërsa hymë në dhomë, u befasuam kur gjetëm një grup të tërë njerëzish që prisnin të flisnin me ne. Karriget ishin vendosur në një gjysmërrethi dhe unë dhe Drenda ishim ulur përballë tyre. Nuk kishim takuar kurrë më parë asnjë prej tyre, por të gjithë ishin të veshur me kostume zyrtare.

Filluam me një bisedë të thjeshtë, por më pas ata filluan të bënin pyetje në lidhje me dëshirën tonë për të bërë TV. Më kujtohet ende pyetja e parë, “Pse doni të bëni TV?” Megjithëse nuk e dija në atë kohë, njerëzit e mbledhur në sallë ishin të gjithë drejtues të nivelit të lartë në shumë aspekte të ndryshme të prodhimit televiziv. Sigurisht, njeriu me të cilin kishim biseduar ishte atje, por kishte edhe njerëz të produksionit, njerëz të marketingut dhe të tjerë që bënin pyetje të vështira. Në përgjithësi, ndjeva se takimi shkoi mjaft mirë. Ne ishim vetvetja, nuk përpiqeshim t'i bënim përshtypje askujt, por thjesht po ndanim historinë tonë të asaj që Perëndia kishte bërë për ne. Të gjithë dukeshin të kënaqur me vizionin dhe pasionin tonë dhe na thanë se do të na telefononin pas disa javësh për të diskutuar më shumë detaje.

Kështu që pas disa javësh, folëm përsëri; dhe këtë herë, ne të gjithë vendosëm të kalonim në një seancë të planifikimit real për transmetimin tonë televiziv. Në atë kohë, kishim arritur në përfundimin se mund ta filmonim programin në shtëpinë tonë, kështu që zotëria me të cilin Drenda kishte komunikuar më pyeti nëse mund të takoheshim në shtëpinë tonë për takimin e radhës. Ai donte të shihte shtëpinë tonë për të parë nëse kjo do të funksiononte vërtet.

Kështu erdhi dita kur ai erdhi në shtëpinë tonë dhe u ulëm të gjithë të bisedonim. Deri në këtë vizitë, vërtet nuk dija shumë për historinë e tij në TV, vetëm se zonja në takimin ku Drenda kishte marrë pjesë, i

kishte dhënë numrin e tij. Por ndërsa u ulëm, ai filloi të na tregonte për të gjitha programet televizive që kishte prodhuar dhe po bënte aktualisht. Emrat ishin të gjithë të njohur! Unë rrija ulur atje i mahnitur: “Zot, si e solle këtë djalë, nga Los Anxhelosi, në shtëpinë time në rrugën e vogël të shtruar me dhe këtu në këtë fshat, në mes të askundit?” Ai pranoi të bënte programin e plotë për ne, duke e xhiruar, montuar dhe prodhuar me një çmim shumë të përshtatshëm. Ne gjithashtu ramë dakord që ta regjistronim programin në shtëpinë tonë, si fillim në dhomën e ndenjjes.

Erdhi dita e parë e regjistrimit dhe e pranoj se isha nervoz. Siç thashë, nuk kisha përvojë me TV. Nuk e dija se si duhej ndërtuar një program televiziv, nuk kisha folur kurrë më parë me një kamera; gjithçka ishte e re. Isha i emocionuar që do ta tregoja historinë time për Mbretërinë, por TV ishte një tjetër prag i frikshëm në jetën time që duhej ta kapërcejta.

Për t’i bërë gjërat edhe më keq, ditën e regjistrimit ndodhi një ngjarje shumë mallëngjyese që e bëri atë ditë edhe më të vështirë. Producenti që u dërgua për të filmuar regjistrimin një-javor ishte nisur në mes të natës. Në mënyrë tragjike, djali i tij i vogël ishte përplasur dhe vrrarë nga makina e fqinjit teksa po ecte mbrapsht. Asistenti që ndodhej atje shpjegoi se çfarë kishte ndodhur dhe vendosëm të mos i tregonim

askujt derisa të përfundonin xhirimet.

Por në njëfarë mënyre e kaluam. Ne regjistruam tre emisione atë ditë dhe ishim zyrtarisht në TV. Ua!

## **A VUAN NDOJË NGA JU? LE TË LUTET.**

— JAKOBI 5:13

Kur e filluam transmetimin tonë televiziv, nuk e kishim idenë se si të

vazhdonim të paguanim për kohën e transmetimit. Por Perëndia filloi të na mësonte se Ai jo vetëm që do të siguronte 300 000 dollarët që na duheshin për ta filluar transmetimin, por gjithashtu do të vazhdonte të siguronte për kohën e transmetimit. Kishim shumë për të mësuar. E

dini, ne as që e kishim menduar se njerëzit do të donin të mbillnin në shërbimin tonë televiziv; kaq naivë ishim.

Më kujtohet se sekretarja ime Trejsi më telefonoi nga zyra menjëherë pasi programi ynë filloi të transmetohej. Kur u përgjigja, arrita ta kuptoja se ajo po dridhej. Zëri i saj dridhej. “Pastor”, tha ajo, “dikush që e pa shfaqjen na dërgoi një çek për 500 dollarë. Dhe, pastor, kur e mora, e njëjta vajosje ishte mbi këtë çek që ishte në ato para që ju sollët nga rezervati indian.” “E ke seriozisht?”, belbëzova unë. “Dikush me të vërtetë na dërgoi para?” Para se të shfaqej ai çek, nuk më kishte shkuar kurrë në mendje se njerëzit do të dërgonin para për të mbështetur transmetimin. Por, lavdi Perëndisë, njerëzit kanë dërguar që atëherë, duke e çuar programin në mbarë botën, tanimë çdo ditë, në çdo zonë kohore! Faturat kanë arritur miliona në vit, por Perëndia e ka përmbushur gjithmonë fjalën e Tij ndaj meje. Ai e paguan gjithmonë faturën.

Ky libër ka të bëjë me dëgjimin dhe udhëheqjen e Frymës së Perëndisë në jetë. Historia jonë me TV është një shembull i mirë se si Fryma e Shenjtë i udhëheq njerëzit të bëjnë gjëra më të mëdha nga sa kanë ëndërruar ndonjëherë. Gjithçka që Perëndia ka bërë në jetën tonë ka ardhur nga aftësia jonë për të ditur jo vetëm se si funksionon Mbretëria e Tij, por edhe për të qenë në gjendje të dëgjojmë Perëndinë të na japë drejtimin, mençurinë dhe përgjigjet që na duhen. Historia që sapo të tregova nuk do të kishte ndodhur kurrë nëse nuk do të dija si ta dëgjoja Frymën e Shenjtë. Ndonjëherë ne të gjithë mund të përballemi me situata të vështira që mund të duken të pashpresa. Por Perëndia e ka përgjigjen.

*“A vuan ndonjë nga ju? Le të lutet” (Jakobi 5:13).*

Pse të lutemi? Sepse duhet të dëgjosh përgjigjen, drejtimin dhe zgjidhjen e problemit. Siç e kemi kuptuar shumë herë unë dhe Drenda, Perëndia është në gjendje të bëjë më shumë seç mund ta imagjinonim

ndonjëherë kur përballemi me telashe. Ai do të të ndihmojë me zgjidhje dhe strategji unike dhe ndonjëherë të çuditshme, në mënyrë që të mund t'i kapërcësh ato që mendon se janë situata të pamundura. Shumë herë, aftësia jote për të dëgjuar përgjigjen mund të jetë ndryshimi midis suksesit dhe dështimit, jetës dhe vdekjes. Do të flas gjerësisht rreth të dëgjuarit të zërit të Frymës së Shenjtë në këtë libër, por së pari, më lejo të të jap një ilustrim tjetër se si Fryma e Shenjtë mund të të ndihmojë në kohë të vështira.

Kur nisëm projektin tonë të ndërtimit të “Now Center”, i cili ishte një projekt prej 6,5 milionë dollarësh, ne mblodhëm fillimisht 2,5 milionë para në dorë dhe përdorëm gjithashtu disa para të ruajtura në bankë. Ne kishim edhe fondet që u mblodhën gjatë vetë projektit të ndërtimit 18-mujor. Ishte një projekt i madh për t'u realizuar nga një kishë prej 550 vetash. Ne e hapëm kantierin në vjeshtën e vitit 2007 dhe gjithçka po shkonte mirë deri në pranverën e vitit 2008. Mund të të kujtohet recesioni i vitit 2008. Epo, ne ishim në mes të punimeve të ndërtimit. Çmimet për gjithçka u rritën në maksimum! Çmimet e çelikut arritën të ishin më shumë se 300 000 dollarë më të larta se çmimi i ofertës së kuotuar. Ky është vetëm një shembull. I gjithë projekti e tejkaloi buxhetin pasi çmimet e mallrave u rritën në kulm atë vit.

Nga fundi i vitit 2008, bankat në zonën tonë, dhe në fakt në të gjithë vendin, po tërhiqnin linjat e tyre të kreditimit dhe po kërkonin shlyerjen e kredive ndërsa recesioni thellohej. Kontraktori ynë erdhi tek ne një ditë gjatë kësaj kohe për një pagesë, e cila tashmë ishte miratuar paraprakisht nga banka jonë. Ai duhej të paguante nënkontraktorët e tij dhe faturat e tjera të papaguara, para që ai i kishte shpenzuar tashmë. Çeku prej një milion dollarësh do të mbulohej nga financimi i paracaktuar i bankës pasi në atë pikë, ne e kishim shteruar tashmë pjesën tonë të parave në dorë për fondet. Por nuk kishte çek prej një milion dollarësh në dispozicion. U tronditëm kur zbuluam se banka kishte

tërhequr ofertën dhe kishte tërhequr linjën e kreditimit. Gjithsesi, nuk ishte vetëm banka jonë; këtë kishte bërë çdo bankë në qytet. Titujt e asaj jave në gazetën tonë lokale kishin bankën tonë në faqen e parë. Ata sapo kishin pushuar nga puna 550 punonjës atë javë dhe po luftonin për t'i mbijetuar krizës financiare.

Megjithatë, çështja urgjente ishte se kontraktori ynë duhej të paguante nënkontraktorët e tij dhe furnizimet që i kishte përdorur tashmë. Ky çek prej një milion dollarësh nuk ishte për diçka që do t'i duhej në të ardhmen. Ai e kishte shpenzuar tashmë atë milion! Tani kishte kompani dhe familje të tjera që kishin nevojë që ne të paguanim kontraktorin tonë që ai t'i paguante ato. Ashtu si ne, ai kishte supozuar se banka do t'i përmbahej angazhimit të vet. Po tani? Çfarë do të bëje në një kohë si kjo? Nuk kisha një milion dollarë në dorë dhe nuk do të lypja para te njerëzit e kishës sonë. Përveç kësaj, televizioni po shtrenjtohej pasi ne ishim zgjeruar në shumë rrjete të tjera; koha jonë e transmetimit tani kushtonte 50 000 dollarë në muaj. Çfarë mund të bënim veçse të bënim atë që tha Jakobi 5:13, të luteshim!

Për rastësi, ne kishim fituar një tjetër udhëtim në Havai përmes biznesit tim gjatë asaj kohe. Mësova se banka e kishte tërhequr kredinë vetëm disa ditë para se të niseshim. Ndërsa kalova përmes aeroportit për të kapur fluturimin tonë për në Maui, më duhet të pranoj se isha ende pak i tronditur. Mendja ime po vraponte një milion milje në orë. Por ndërsa po ecja nëpër aeroport, i tunduar të më vinte keq për veten, dëgjova zërin e Zotit. Ai tha: «Ngrije shkopin tënd!» Ndërsa ndalova dhe sodita atë që Zoti po përpiquej të më thoshte, papritmas e kuptova.

Kjo është pikërisht ajo që Perëndia i tha Moisiut kur Izraeli nuk kishte ku të kthehej, pasi ushtria e Faraonit i kishte bllokuar në buzë të Detit të Kuq. Perëndia i tha Moisiut të ngrinte shkopin e tij mbi det dhe kur e bëri, ai u nda, duke i hapur rrugën Izraelit që të kalonte dhe të shpëtonte. Shkopi që mbante Moisiu përfaqësonte premtimet që i kishte dhënë Perëndia, si dhe autoritetin që iu dha për të kryer punën.

E kuptova se çfarë po më thoshte Perëndia në atë moment. Unë isha udhëheqësi, pastori i kësaj kishe; më ishte dhënë autoriteti për t'u marrë me këtë situatë. Më duhej të merrja autoritetin tim dhe të ngrihesha e të gjeja një zgjidhje. Kur mbërritëm në Havai, gjithçka që mund të bëja ishte të lutesha. Nuk mund të flija natën. Shpirti im ishte i trazuar dhe e dija se po luftoja në Shpirt për përgjigjen që më nevojitej. Më në fund, Drenda pati një ide që ajo besonte se ishte nga Zoti. Faleminderit Perëndisë për gruan time! Ajo është përdorur shumë herë për të gjetur planet dhe drejtimin e nevojshëm në të gjitha llojet e situatave. Nuk mund ta shpreh se sa e vlefshme është për mua dhe sa shumë e dua. Ajo nuk dorëzohet kurrë!

Plani i saj ishte i thjeshtë por i thellë. Nuk kishte asnjë tregues se do të funksiononte, por ne filluam menjëherë punën për të. Plani ishte që ne të bënim një prezantim që do t'ia bënim bankës së kontraktorit tonë, jo bankës sonë, duke i kërkuar të na jepnin para hua. Prezantimi ynë do t'i tregonte bankës se kush ishim dhe pse mendonim se dhënia e kredisë ishte më e mira për të dy palët. Ishte një përpjekje thuajse e pamundur, sepse siç thashë, çdo bankë në qytet kishte bllokuar të gjitha huadhëniet. Ideja jonë ishte që, nëse kontraktori ynë nuk paguhej, atëherë mund t'i duhej të deklaronte vetë falimentimin, duke vënë në rrezik për mosshlyerje të gjitha kreditë që kishte aktualisht në bankën e tij. Ishim të sigurt se kjo do të ishte një sipërmarrje e kushtueshme për bankën e tij, që ishim të sigurt se ata nuk e donin. Dhe përsëri, kjo nuk ishte banka jonë dhe ata nuk kishin asnjë lidhje apo histori me ne.

Kështu, ne bëmë një tabelë të përmbledhur që tregon demografinë e zonës sonë dhe sa shpejt po zhvillohej zona. Ne i treguam bankës historinë tonë dhe rritjen tonë të parashikuar. Ne përmendëm gjithashtu mënyrat e shumta se si ndërtesa jonë do të gjeneronte të ardhura jashtë shërbesave të kishës, si p.sh. sa shpejt po rriteshin të ardhurat tona nga televizioni dhe shumë gjëra të tjera që mendonim se do të ishin me interes për ta. Ne donim t'i siguronim se ishim një risk i madh që do



të rezultonte fitimprurës për bankën, edhe në këto kohë të vështira. Ne donim gjithashtu të theksonim se nëse kontraktori nuk paguhej, ata mund të rrezikoheshin nga humbjet e mundshme për të cilat ne donim t'i "ndihmonim" t'i shmangnin. Ne kërkuam të takoheshim me nën-presidentin e bankës i cili ishte përgjegjës për sektorin e kredive tregtare. Ne u lutëm dhe hymë në zyrën e tij, duke ditur me siguri se ky ishte plani që na kishte dhënë Fryma e Shenjtë dhe e paraqitëm kërkesën tonë.

Çuditërisht, pas prezantimit tonë, punonjësi i kërkoi sekretares së tij që t'i plotësonte menjëherë një çek kishës për 500 000 dollarë që ta merrnim me vete. Ai tha se ajo që po bënte ishte jo

e zakonshme dhe jo mënyra e zakonshme e të vepruarit. Nuk kishte asnjë garanci, asnjë formular, vetëm një çek për 500 000 dollarë. Ai tha se 500 000 dollarët e tjerë do të duhej të kalonin përmes garancisë, por ai na siguroi se do të miratoheshin sepse ishte ai që mori vendimin dhe ashtu u bë. Ne i paguam kontraktorit tonë një milion dollarë dhe e përfunduam ndërtesën.

Është e vështirë t'ju them se si u ndjemë unë dhe Drenda në një orë udhëtim me makinë për në shtëpinë tonë me atë çek prej 500 000 dollarësh në xhep. Ne ishim jashtë mase të gëzuar dhe ndiheshim për mrekulli! Nuk ka asnjë fjalë që mund ta përshkruajë siç duhet se si ndiheshim në atë moment, por ishim të mahnitur nga ajo që sapo kishte bërë Fryma e Shenjtë. Personi i parë që telefonuam ishte kontraktori ynë. Ende e dëgjoj gëzimin në zërin e tij kur i thamë lajmin e mirë. «Çfarë bëtë?», tha ai. «Jua dhanë çekun në vend?» Të dy e dinim se e bëri Perëndia.

Si ndodhi kjo? Fryma e Shenjtë! Perëndia ka përgjigjet që të

**NËSE DO TË SHFRYTËZOSH  
NDONJËHERË POTENCIALIN  
E MREKULLUESHËM TË  
MBRETËRISË SË PERËNDISË,  
DO TË TË DUHET TË MËSOSH  
SE SI TA DËGJOSH FRYMËN E  
SHENJTË.**

nevojiten, mik. Nëse do të shfrytëzosh ndonjëherë potencialin e mrekullueshëm të Mbretërisë së Perëndisë, do të të duhet të mësosh se si ta dëgjosh Frymën e Shenjtë. Dhe për këtë bën fjalë ky libër.

Të kapërcesh situatat me Frymën e Shenjtë është më emocionuese se çdo film i Xhejms Bondit që ke parë ndonjëherë! Dhe ashtu si filmi, ti gjithmonë e di se kush fiton në fund, pavarësisht se sa momente të tensionuara mund të shfaqen.

## KAPITULLI 2

# MBRETËRIA

Jam i sigurt që ke dëgjuar për shumë nga paditë joserioze që depozitohen, të cilat më pas pushohen. Këtu është një shembull.

Një i burgosur në një burg në Kolorado ka ngritur një padi për më shumë se 88 miliard dollarë (po, *miliarda*) kundër Ligës Kombëtare të Futbollit. Padia rrjedh nga një vendim i marrë nga zyrtarët gjatë një loje play-off-i midis Dallas Cowboys dhe Green Bay Packers. Zyrtarët përcaktuan se një kapje e bërë nga Dez Bryant (nga Cowboys) ishte e papërfunduar. I burgosuri nuk është dakord. Padia e tij pretendon se zyrtarët e NFL vepruan në mënyrë të pakujdesshme dhe shkelën përgjegjësinë e tyre. Pse i burgosuri ngre padi për 88 miliardë dollarë? Numri i fanellës së zotit Bryant është 88.<sup>1</sup>

Çmenduri, apo jo? Unë mendoj se të gjithë mund ta kuptojnë se ajo çështje nuk po shkon askund. Por çfarë e përcakton nëse një çështje është e vlefshme apo jo? Epo, sipas law.com, dy arsyt kryesore përse një çështje pushohet është se ka një problem juridiksioni ose nuk ka asnjë bazë ligjore për ta vazhduar. Pse po përmend çështje ligjore në një libër mbi Frymën e Shenjtë? Sepse nëse do të shohësh Frymën e Shenjtë të veprojë në situatën tënde, duhet të jesh i qartë se çfarë thotë ligji. Mbretëria e Perëndisë është pikërisht ajo, një mbretëri, e cila vepron brenda kufijve të ligjeve të Mbretërisë. Në dy librat e mi të mëparshëm në këtë seri, *Revolucioni juaj Financiar: Fuqia e Besnikërisë dhe Revolucioni juaj Financiar: Fuqia e Prehjes*, unë parashtrova bazat

se si funksionon Mbretëria e Perëndisë për sa i përket juridiksionit dhe ligjit. Por për të kuptuar atë që po them në lidhje me Frymën e Shenjtë, mund të na bëjë mirë të kthehemi dhe të paktën t'i kujtojmë vetes këto parime. Le të fillojmë me një pyetësor.

*Por Jezusi u tha atyre: “Asnjë profet s’është i përbuzur përveç në vendlindjen e tij, në faretisin e vet dhe në shtëpinë e vet”. **Dhe nuk mundi** të kryejë aty asnjë vepër të pushtetshme, përveçse shëroi disa të lëngatë, duke vënë mbi ta duart. Dhe çuditej për mosbesimin e tyre; dhe dilte nëpër fshatra përreth e i mësonte.*

— Marku 6:4-6

A mund të më thuash pse Jezusi nuk mundi t'i shëronte njerëzit në këtë fragment? Përgjigja standarde fetare është se duhet të ketë qenë vullneti i Perëndisë që të mos i shërojë ata. Në fund të fundit, Perëndia e di më mirë dhe nëse do të donte t'i shëronte ata, do ta kishte bërë, apo jo? Dua të them, Ai është Perëndia. A do të supozoje gjithashtu se atje kishte njerëz që duhej të shëroheshin, por nuk e morën shërimin e tyre? Unë mendoj se kjo është e qartë edhe nga teksti. Njohja e përgjigjes se përse Jezusi nuk mundi t'i shëronte njerëzit lidhet me një pyetje jetike, pyetje që duhet marrë përgjigje. Nëse lexojmë përfundimin e historisë, zbulojmë se Jezusi thotë se ishte mungesa e besimit të njerëzve që i pengoi ata të merrnin. Për ta kuptuar vëzhgimin dhe përfundimin e Jezusit se përse njerëzit nuk morën, do të duhet të kujtojmë mirë se çfarë është besimi dhe pse kërkohet në mbretërinë e tokës në mënyrë që qielli të ketë juridiksion ligjor këtu.

Më lejo ta përmbledh çështjen në këtë rast. Nuk ishte mungesë fuqie, apo vullneti nga këndvështrimi i Jezusit. Çështja ishte çështje juridiksioni. Në thelb, qielli nuk kishte bazën ligjore për të vepruar në atë situatë për shumicën e njerëzve atje. Atëherë, përpara se ta flakësh këtë libër në dhomë duke thënë se nuk e kam idenë se për çfarë po flas,

më jep një minutë të shpjgohem.

Kur Adami dhe Eva u vendosën mbi tokë, ata kishin autoritet të plotë dhe absolut mbi mbretërinë e tokës. Mendoj se fragmenti i mëposhtëm e vërteton qartë pohimin tim.

*Ti e bëre për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe ... Ti i vure të gjitha nën këmbët e tij. Sepse, mbasi i vuri të gjitha nën pushtetin e tij, nuk la asgjë pa iu nënshtrua.*

— Hebrejve 2:7-8

Vër re se Bibla thotë se Adami u kurorëzua me lavdi dhe nder. Termi “e kurorëzove” këtu i referohet një pozite autoriteti nga i cili sundoi Adami, jo se ai në fakt mbante një kurorë në Kopsht. Por ne mund të supozojmë se mund të ketë pasur një shkëlqim ose një aureolë rreth tij, thjesht një mendim. Adami kishte lavdinë (vajosjen dhe madhësitinë e Mbretërisë) dhe nderin (pozitën e autoritetit) të Mbretërisë së Perëndisë. Dhe me këto dy gjëra, ai sundoi mbi tokën, me autoritet të deleguar, në emër të Mbretërisë së Perëndisë. Satani, i cili ishte tashmë në tokë kur u krijua njeriu, e përçmoi njeriun dhe lakmoi autoritetin që ai kishte. Duke ditur se ai nuk mund t’i merrte lehtë kurorën e autoritetit Adamit, sepse Adami kishte autoritet të plotë mbi të, atij iu desh të sajonte një mashtrim për ta shtyrë disi ta dorëzonte kurorën (autoritetin) në mënyrë vullnetare.

Kështu Satani e mashtrroi Evën dhe Adami e ndoqi, duke u rebeluar kundër Perëndisë, duke rezultuar në humbjen e pozitës së tyre në Mbretërinë e Perëndisë. Duke ndjekur Satanin, ata tanimë ranë nën juridiksionin e mbretërisë së tij. Kështu që ti mund të pyesësh: “Pikë së pari, pse e lejoi Zoti Satanin në Kopsht?” Ishte i detyruar. E di që mund të tronditesh pak nga kjo përgjigje, por do të zbulosh se është e vërtetë. Le të hedhim një vështrim të shpejtë te Zanafilla 2:8-9.

*Pastaj Zoti Perëndi mbolli një kopsht në Eden, në lindje, dhe vendosi në të njeriun që kishte formuar. Pastaj Zoti Perëndi bëri që të mbijnë nga toka lloj-lloj pemësh të këndshme nga pamja dhe që jepnin fruta të mira për t'u ngrënë; në mes të kopshtit gjendeshin edhe pema e jetës dhe pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes.*

Duke lexuar këtë fragment, ne mund të pyesim veten pse Perëndia do ta vendoste pemën e njohjes të së mirës dhe të së keqes pikërisht në mes të Kopshtit pranë Pemës së Jetës. Në thelb, për ta bërë të ligjshme që Perëndia ta pushtonte territorin e Satanit, Perëndia duhej t'i jepte njeriut një zgjedhje për t'i shërbyer atij ose Satanit. Perëndia nuk mund të hynte ligjërisht në juridiksionin e Satanit dhe të caktonte një njeri atje. Për ta bërë atë të ligjshme, njeriu duhej të kishte mundësinë të zgjidhte se kujt do t'i nënshtrohej. Për sa kohë që njeriu zgjidhte Perëndinë, Pemën e Jetës, njeriu do të sundonte mbi Satanin. Kështu, Pema e Njohjes së së Mirës dhe së Keqes duhej të vendosej pikërisht pranë Pemës së Jetës.

Ja një vëzhgim i rëndësishëm që duhet të bëjmë. Njeriu nuk mund të ishte vendosur në tokë pa vullnet të lirë. E di, shumica e krishterimit thotë se ne u krijuam me një vullnet të lirë që Perëndia të mund të shihet se kush e donte Atë. Mendoj se ky pohim është pak i vërtetë. Por, në thelb, do të kishte qenë e paligjshme pa aftësinë për të zgjedhur. Nëse njeriut nuk do t'i ishte dhënë vullneti i lirë, ai nuk mund të vendosej këtu. Unë mund të trajtoj plot gjëra të tjera në këtë diskutim, por ato janë trajtuar në dy librat e mi të mëparshëm.

Kështu Adami zgjedh mashtrimin e Satanit, humbet Mbretërinë e Perëndisë dhe Perëndia përballet me njeriun te Zanafilla 3:17-19:

*Toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frutën e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe.*

Në thelb, Perëndia i thotë Adamit se ai, Adami, e ka mallkuar tokën. Për shkak se Adami ka sundim absolut mbi tokë, ai është personi që i ka hapur derën sundimit të Satanit dhe në thelb e ka dëbuar Perëndinë. Duart e Perëndisë tani janë të lidhura dhe Adami tani do të mbijetojë me mundin dhe djersën e tij. Ka një detaj të vogël që Satani harroi t'ia thoshte Evës kur po e tundonte. Dhe ky ishte se Perëndia e kishte gjykuar tashmë Satanin, e kishte dëbuar nga parajsja dhe kishte shpallur se shtëpia e tij e përjetshme do të ishte një vend i quajtur ferr. Është e rëndësishme që ti ta kuptosh këtë. Shumë njerëz do të thonë: “Si mundet një Perëndi i dashur t'i hedhë njerëzit në një vend të quajtur ferr?” Nuk e bëri Ai, Adami e bëri. Siç e shohim në fragmentin e mëposhtëm, ferri nuk u krijua kurrë për njeriun.

*Pastaj ai do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: “Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, **të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij**” (Mateu 25:41)*

Kur Adami dhe Eva u vendosën nën juridiksionin e Satanit, ata gjithashtu ranë nën gjykimin e Satanit. E gjithë raca njerëzore u vendos nën sundimin e Satanit nëpërmjet Adamit. Mendo për rritjen e bagëtive. Nëse një nga lopët e tua pjell një viç, ai viç do të shënohet me markën tënde pasi të takon, sepse e gjithë tufa të përket ty. Pra, të gjithë pasardhësit e Adamit u vendosën automatikisht nën juridiksionin e Satanit. Kuptimi standard fetar, ose duhet të them mungesa e të kuptuarit, është se fati i një personi, qoftë ky parajsja apo ferri, bazuar në sa i mirë apo i keq është ai, është një koncept krejtësisht i gabuar. Fakti është se gjykimi i tyre tashmë është vendosur. Ata të gjithë po shkojnë në ferr. Jo për shkak të ndonjë gjëje që kanë bërë keq, por për shkak të asaj që bëri Adami. Tani, për shkak të dashurisë së Perëndisë për burrat dhe gratë që krijoi, Ai vuri në zbatim një plan shpëtimi nëpërmjet Jezu Krishtit që u mundëson burrave dhe grave t'i shpëtojnë atij gjykimi dhe të kthehen në juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë.

*“Ai na nxori nga pushteti i errësirës dhe na çoi në mbretërinë e Birit të tij të dashur”*. (Kolosianëve 1:13)

Duhet të theksohet se Perëndia ka përgatitur një arratisje ligjore nga juridiksioni dhe gjykimi i Satanit. Por për të përfitur nga kjo, çdo burrë, grua dhe fëmijë duhet të zgjedhë personalisht të përfitojë prej tij duke thirrur emrin e Jezusit. Të krishterë, më dëgjoni për një çast. Ajo zonjë e sjellshme në rrugë do të përfundojë në ferr nëse dikush nuk i thotë të thërrasë emrin e Jezusit para se të vdesë. Do të ketë shumë njerëz të mirë në ferr. Është gënjeshtria e Satanit që i bën njerëzit të mendojnë se mund t'i shpëtojnë ferrit duke bërë vepra të mira. Emri i Jezusit është i vetmi emër që u është dhënë burrave dhe grave për shpëtim dhe për t'i shpëtuar gjykimin të Satanit. Gjithashtu, dua të sqaroj se kur Adami ra, ai vdiq shpirtërisht dhe u shkëput nga Perëndia; megjithatë, ai ende ruan mundësinë e të banuarit në tokë në mënyrë të ligjshme. Meqenëse është kështu, Satani duhet të përdorë njerëz të frymëzuar nga demonët dhe Perëndia duhet të përdorë njerëz të mbushur me Frymë për të kryer gjërat në mbretërinë e njerëzve. Pra, për ta përsëritur, ne kuptojmë se shkuarja në parajsë ose ferr është një çështje ligjore dhe nuk bazohet në atë se sa të mirë jemi ne, por bazohet në fitoren ligjore që Jezusi fitoi mbi Satanin në Kryq. Megjithëse Jezusi e bëri të ligjshme që njeriu të dilte nga juridiksioni i Satanit, përsëri, çdo person duhet të thërrasë emrin e Jezusit me besim për ta përvetësuar atë.

E di që e lamë këtë diskutim disa paragrafë më parë, por tani le të kthehemi te pyetja që bëmë më parë: “Pse Jezusi nuk mundi t’i shëronte njerëzit te Marku 6?” E thashë që ishte një çështje juridiksioni, dhe është. Meqenëse Adami ia dorëzoi Satanit juridiksionin shpirtëror të mbretërisë së njerëzve, Perëndia nuk mund të hyjë me forcë këtu sa herë që Ai dëshiron, pasi kjo do të ishte e paligjshme. Tani, mos e ngatërro atë që sapo thashë me atë se kush e zotëron vetë tokën. Bibla e thotë qartë se Perëndia zotëron tokën dhe plotësinë e saj. Megjithatë,



në lidhje me mbretërinë e njerëzve, Perëndia nuk ka juridiksion ligjor mbi ta. Këtë mund ta gjejmë te Lluca 4:5–7

*Pastaj djalli e çoi në një mal të lartë dhe, për një çast, i tregoi të gjitha mbretëritë e botës. Dhe djalli i tha: “Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse m’u dha mua në dorë dhe unë ia jap kujt të dua. Në qoftë se ti, pra, duke rënë përmbys, më adhuron, do të jetë krejt jotja”.*

Këtu mund të shohim se Adami i dha Satanit juridiksionin ligjor mbi mbretëritë e botës. Për shkak të kësaj, Perëndia nuk mund të bëjë atë që dëshiron me burrat dhe gratë në mbretërinë e tokës. Por nëse Perëndia mund të gjejë një burrë ose një grua që i beson Atij dhe është plotësisht i bindur për autoritetin e qiellit, atëherë Perëndia mund ta ushtrojë autoritetin e Tij nëpërmjet atij personi. Kjo ishte e njëjta mënyrë se si Satani fitoi hyrjen në mbretërinë e tokës në fillim, nëpërmjet atij që kishte banimin e ligjshëm në tokë, Adamit. Kur Perëndia e humbi njeriun e Tij Adamin, Atij iu desh të gjente një hyrje tjetër në tokë për të vënë në zbatim planin e Tij të shpëtimit, dhe emri i atij njeriu ishte Abram.

*Por Zoti i tha Abramit: “Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd, dhe shko në vendin që do të të tregoj. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës”.*

— Zanafilla 12:1-3

Abrami, ose Abrahami, ishte dera që Perëndia përdori për të hyrë përsëri në mbretërinë e tokës dhe për t’i sjellë njerëzimit planin e Tij të

shpëtimit. Perëndia bëri një besëlidhje me Abrahamin dhe pasardhësit e tij dhe nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ligjore, Perëndia pati të drejtën për të hyrë e për të sjellë Jezu Krishtin në botë, por vetëm nëpërmjet prejardhjes së Abrahamit. Kjo është arsyeja pse Jezusi duhej të ishte pasardhës i Abrahamit dhe pse Izraelit nuk iu lejua të martohej me kombet fqinje. Është gjithashtu arsyeja pse libri i parë i Dhiatës së Re nuk është gjë tjetër veçse një gjenealogji. Ai dëshmon se Jezusi është, në fakt, një pasardhës ligjor i Abrahamit, duke i vërtetuar kështu Satanit se ishte e ligjshme që Jezusi të vinte dhe të paguante çmimin e mëkatit.

Meqenëse burrat dhe gratë kanë ende kontroll ligjor mbi tokën, që nuk duhet ngatërruar me kontrollin shpirtëror, Perëndia dhe Satani duhet të përdorin njerëz për t'i bërë gjërat. E thënë thjesht, burrat dhe gratë janë të vetmit persona juridikë në tokë. Por, ashtu si Satani fitoi akses nëpërmjet Adamit dhe Evës që e besuan atë që ai tha, ashtu edhe Perëndia duhet të gjejë njerëz që do të besojnë atë që thotë Ai që të mund të veprojnë në tokë. Kur një burrë ose një grua janë plotësisht të bindur në zemrën e tyre për atë që thotë qielli në vend të asaj që thotë mbretëria e Satanit, ky quhet besim dhe i jep juridiksion ligjor parajsës për të vepruar përmes atij personi në tokë dhe për të zbatuar vullnetin e Perëndisë kundër mbretërisë së Satanit. Ka shumë më tepër për të thënë, por këtë e kam trajtuar me shumë detaje në dy librat e mi të parë.

Ideja kryesore është kjo. Meqenëse Satani është këtu në tokë, ai gjithmonë mbron mbretërinë e tij dhe gjithmonë përpiqet t'u mbivendoset planeve të Perëndisë. Për shkak të kësaj, Perëndia punon në fshehtësi për të futur planet dhe strategjitë e Tij në mbretërinë e tokës. Dhe është në njohjen e mënyrës sesi Perëndia punon në fshehtësi ku ti do të gjesh çelësin më të madh të suksesit dhe fitores tënde në jetë. Unë e quaj Fuqia e Strategjisë!

## KAPITULLI 3

# MAHNITUR

Telefonata erdhi nga një djalë që nuk e kisha takuar kurrë. Ai u prezantua dhe tha se ai dhe disa djem po e shijonin vërtet librin tim “*Gjuetia e besimit*” dhe mësimin tim mbi Mbretërinë e Perëndisë. Në fakt, ai më pyeti nëse mund të isha i interesuar të shkoja në Montana dhe t’i jepja mësim të premtën në mbrëmje dhe të shtunën në mëngjes një grupi prej rreth 70 burrash. Përpara se të mund të përgjigjesha, ai më tha: “Pasi të jepni mësim të shtunën në mëngjes, ne do të dëshironim t’ju çonim për të gjuajtur antilopa pasi është sezoni i tyre.” Epo, nuk m’u desh shumë kohë për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Ai tha se edhe djemtë e mi ishin të ftuar të vinin nëse u pëlqente. Gjatë muajve të verës në vijim, ata më ndihmuan të merrja licencën e duhur për gjuetinë time të ardhshme atë vjeshtë. Djali im, Timi, kishte vendosur të vinte gjithashtu; edhe ai e nxori licencën.

Siç mësova, ky ishte një grup i “Mbajtësve të Premtimit” dhe ata ishin të mahnitur me historitë e gjuetisë që tregova në mësimin tim dhe se si e prita drerin tim me besim. Ata donin të dëgjonin më shumë rreth asaj se si gjithmonë e kapja drerin e synuar në 30 ose 40 minuta dhe se si Perëndia më mësoi të jem specifik në lidhje me llojin e kafshës që do të kapja për sa i përket gjinisë dhe madhësisë së brirëve. Do të më duhej ta pranoja se historitë që kisha parë të ndodhnin ishin pothuajse të pabesueshme, dhe nëse nuk do t’i kisha parë të ndodhnin në të vërtetë, ndoshta do të isha po aq kureshtar sa ata.

Më në fund, erdhi java për të shkuar në Montana. Unë dhe Timi fluturoam me avion dhe takuam disa nga drejtuesit e grupit të burrave, një grup djemsh të mrekullueshëm që e donin vërtet Zotin. Ata na nxorën për të peshkuar troftë si dhe na çuan në një poligon qitjeje për të parë pushkët që na kishin përgatitur. I rritur në Ohajo, nuk isha mësuar të gjuaja me çifte për distanca të gjata. Ligjet tona lejonin vetëm armë gjahu për drerët, dhe distancat ishin pothuajse gjithmonë më pak se 91 metra, shumicën e kohës edhe më pak se 45 metra. Pra, kur ata vendosën objektivin në 180 metra, m'u desh të përshtatesha; por me pak praktikë, arrita të godas pllakën e çelikut dhe u thashë se isha gati për t'u nisur.

Atë mbrëmje, u dhashë mësim burrave në një auditor të shkollës lokale, por edhe mëngjesin tjetër gjithashtu. Djemtë ishin të gjithë të etur për të dëgjuar dhe mësuar për Mbretërinë e Perëndisë, veçanërisht se si Perëndia m'i mësoi ligjet e Mbretërisë nëpërmjet gjuetisë. Pas drekës, ata thanë: «Në rregull, le ta ndjekim atë antilopë». Unë kurrë nuk kisha gjuajtur antilopa dhe mendoj se nuk e kuptoja se cila do të ishte procedura. Nga përvoja ime e gjuetisë, ti del më së shumti me dy ose tre djem. Por ata po merrnin tre ose katër makina me njerëz. Mbjaj mend që një natë më parë Timi më pyeti: “Babi, a nuk je i shqetësuar për kapjen e antilopës? Ti do t'u japësh mësim atyre për Mbretërinë dhe do të shpallësh me siguri se Mbretëria funksionon çdo herë, por po sikur të mos e kapësh antilopën dhe të gjithë ata të të shikojnë?” I thashë se nuk isha nervoz për kapjen e antilopës. Unë dhe Drenda tashmë kishim mbjellë farën tonë dhe ramë dakord për atë antilopë; do të ishte aty.

Ndërsa po shkonim me makinë për në fermën ku kishin leje për të gjuajtur, ata po shpjegonin se antilopa është kafsha më e shpejtë në Amerikën e Veriut dhe kafsha e dytë më e shpejtë në planetin tokë, që ia kalon vetëm gatopardi. Ata shpjeguan se antilopa ka shikim të përsosur dhe mbrojtja e saj kryesore është vrapimi, kështu që nëse do të

të pikaste, do të zhdukej brenda një sekonde. Etiketa ime vlente për një antilopë mashkull, dhe Timi kishte etiketë për një drenushë.

Plani ynë ishte që të shkonim me makinë në fermë, të ngjiteshim në lartësi dhe më pas të ngjiteshim në këmbë deri në majë dhe të shikonim nga lart disa nga luginat e cekëta për të parë nëse mund të dallonim disa kafshë. Ndërsa po ngjiteshim në këmbë në majë, vumë re një grup antilopash në distancë. Për shkak të terrenit, ne ndjemë se mund të afroheshim mjaftueshëm për një gjuajtje duke qëndruar në grykat e ulëta. Do të na duhej të ngjiteshim fshehtazi me shumë kujdes deri në majë të kodrës së fundit, pastaj do të tërhiqeshim ngadalë në kreshtën e kodrës nëse antilopa do të ishte ende aty kur të mbërrinim. Kur të arrinim, do të mund t'i gjuanim nga një pozicion 180 metra deri në 230 metra.

Timi dhe unë u zvarritëm ngadalë mbi bark për një kohë të gjatë për t'u afruar në skajin e kodrës nga ku dukej gryka në të cilën i kishim pikasur. Plani ishte që pasi të qëlloja unë, Timi do të gjuante një drenushë. U zvarrita ngadalë deri në buzë dhe hodha shikimin. Sigurisht, plani ynë kishte funksionuar; tufa e vogël nuk na kishte parë. Ngrita pushkën dhe e pata të vështirë ta mbaja dorën të palëvizur për shkak të distancës dhe frymëmarrjes sime të rënduar nga zvarritja. Por më në fund, kur mendova se e kisha drerin në shënjestër, tërhoqa këmbëzën. Më shpëtoi. Tufa dukej e hutuar ndërsa bëra një goditje të dytë. Më shpëtoi përsëri. Tani tufa po lëvizte ndërsa unë qëllova për herë të tretë dhe më pas të katërt, të gjitha pa sukses. Teksa u përgatita për gjuajtjen e pestë, gjithçka që dëgjova ishte një kërcitje. Më kishte mbaruar municioni.

Për shkak të rrëmujës, nuk e kisha vënë re, por e gjithë tufa ishte larguar dhe ishte jashtë rrezes. Të gjithë, përveç drerit që kisha qëlluar. Ai qëndronte përsosurish i palëvizur vetëm pak metra larg vendit ku kishte qëndruar për goditjen time të parë. Me nxitim i kërkova Timit pushkën e tij. Tashmë isha ngritur në këmbë, dhe bëra një goditje të menjëhershme, dhe dreri u plandos. Isha i emocionuar dhe i lehtësuar

në të njëjtën kohë. E zura drerin. Ndërsa ktheva kokën pas, u befasova kur pashë një grup djemsh që bërtisnin dhe festonin së bashku. Disa po flisnin në celularët e tyre dhe dëgjova njërin të thoshte: “Po, ishte

**BOTA ËSHTË E  
URITUR PËR TË  
PARË TË VËRTETËN  
DHE PERËNDISË I  
PËLQEN T’I MAHNITË  
GJITHASHTU.**

tamam si në librin e “*Gjuetia e besimit*”, vetëm rreth 40 minuta dhe dreri qëndronte i palëvizshëm, ashtu si në libër.” Të gjithë kishin ardhur për të parë funksionimin e Mbretërisë. Në fund të fundit, unë u kisha dhënë mësim atyre për orë të tëra dhe ata donin ta shihnin në praktikë. Epo, pavarësisht gjuajtjes sime të keqe, ajo kishte funksionuar gjithsesi dhe i kishte shtuar besueshmëri mësimëve të mia. Timi e qëlloi drenushën e tij atë pasdite me një goditje të përsosur të drejtuar një antilope në vrapim e sipër. Të dy ishim shumë të emocionuar! Montana është shumë e bukur dhe Timi dhe unë patëm një përvojë të mrekullueshme të Mbretërisë. E kam kokën e antilopës të montuar dhe të varur mbi tavolinën në zyrën time për të më kujtuar Mbretërinë dhe besnikërinë e Perëndisë.

Pse do ta tregoja një histori gjuetie në këtë libër? Sepse Perëndia dëshiron të të përdorë për t’ua treguar Mbretërinë e Tij të gjithë miqve, fqinjëve dhe familjes sate. Të gjithë duan ta shohin atë në praktikë. Bota është e uritur për të parë të vërtetën dhe Perëndisë i pëlqen t’i mahnitë gjithashtu. Për t’i mahnitur ata, do të të duhet të mësosh se si funksionon Mbretëria e Perëndisë dhe si Fryma e Shenjtë sjell përgjigjet dhe mundësitë që të nevojiten për t’i mahnitur të gjithë, madje edhe veten tënde. Siç kuptova më vonë, ata pak djem që drejtonin grupin e burrave më çuan drejt qëllimit shumë të veçantë për t’ua demonstruar Mbretërinë shumë njerëzve që ishin të mbërthyer në fe. Më vonë kuptova se shumë prej tyre ia kishin dhënë zemrën e tyre Zotit për shkak të mësimit tim atë ditë. Fryma e Shenjtë e zbatoi atë plan dhe Ai do të të ndihmojë edhe me planet e tua drejt suksesit.

Më lejo të të tregoj edhe një histori, por kjo është drejtpërdrejt nga Bibla dhe do të ilustronjë përsëri se si Perëndia dëshiron të të befasojë me plane dhe strategji të mbinatyrsme që do të sjellin prova të realitetit dhe dashurisë së Tij për ata që të rrethojnë.

*Dhe ndodhi që Jezusi, kur po ndodhej në bregun e liqenit të Gjenezaretit e ndërsa turma po shtyhej rreth tij për të dëgjuar fjalën e Perëndisë, pa dy barka të lidhura në breg të liqenit, nga të cilat kishin dalë peshkatarët dhe po lanin rrjetat. Atëherë hyri në një nga ato barka, në atë që ishte e Simonit, dhe iu lut që të largohej pak nga bregu. U ul dhe mësonde turmat nga barka.*

*Dhe kur mbaroi së foluri i tha Simonit: “Shko në të thella, dhe hidhni rrjetat tuaja për të zënë peshk”.*

*Dhe Simoni, duke u përgjigjur, i tha: “Mësues, u munduam gjithë natën dhe nuk zumë asgjë; por, për fjalën tënde, do ta hedh rrjetën.”*

*Dhe, si bënë kështu, zunë një sasi aq të madhe peshku, sa po shqyhej rrjeta. Atëherë u bënë shenjë shokëve të tyre që ishin në barkën tjetër, që të vinin e t'i ndihmonin. Dhe ata erdhën dhe i mbushën të dy barkat aq sa gati po fundoseshin.*

*Simon Pjetri, kur pa këtë, i ra ndër këmbë Jezusit dhe i tha: “Zot, largohu prej meje, sepse jam njeri mëkatar”. Në të vërtetë Pjetri dhe të gjithë ata që ishin me të, habiteshin për shkak të sasisë së peshkut që kishin zënë. E njëjta gjë u ngjau edhe Jakobit dhe Gjonit, bijve të Zebedeut, që ishin shokë të Simonit*

— Luka 5:1-10

Pjetri, Jakobi dhe Gjoni kishin peshkuar gjatë gjithë natës dhe nuk kishin kapur asgjë. Këta ishin peshkatarë me përvojë që ishin rritur në liqen dhe e njihnin mirë atë, por dolën duarbosh. Por, sigurisht, historia nuk përfundon me kaq. Jezusi merr hua barkën e Pjetrit për të predikuar dhe më pas i thotë të shkojë në ujëra të thella për të peshkuar. Pjetri, pak i tronditur, thotë se ata kishin peshkuar gjithë natën pa kapur asnjë peshk, por ngaqë Jezusi ua kërkoi, ai do ta hidhte rrjetën. Kur Pjetri hodhi rrjetën, Bibla thotë se ai kapi aq shumë peshq, sa rrjeta e tij u shqye, kështu që ai thirri shokët e tij për ta ndihmuar. Shkrimi thotë më pas se edhe rrjetat e shokëve të tij pothuajse u shqyen dhe se të dyja varkat u mbushën aq shumë me peshq, saqë për pak do të fundoseshin. Bibla thotë se këta peshkatarë me përvojë ishin aq të habitur nga sasia e peshkut të kapur atë ditë, saqë hoqën dorë nga peshkimi dhe ndoqën Jezusin.

Kjo është një nga historitë e mia të parapëlqyera në Bibël, sepse tregon qartë një pamje të dallimeve midis dy mbretërive, mbretërisë së errësirës dhe Mbretërisë së Perëndisë. Mbretëria e errësirës, sundimi i Satanit, është një sistem i prishur, i varfër, ku peshkon gjithë natën dhe nuk kap asgjë, plot mundime dhe djersë vetëm për të mbijetuar. Unë e quaj atë sistemi i mallkimit të tokës, i shkaktuar nga rebelimi i Adamit, krahasuar me tablonë e lavdishme të Mbretërisë së Perëndisë dhe me atë që prodhon ajo. Hidhi një sy të dy ekstremeve dhe kupto se Perëndia të ka dhënë derën numër dy, Mbretërinë.

Në këtë pikë, çdo i krishterë do të bërtasë, do të duartrokasë dhe thotë: “Po, Mbretëria e Perëndisë është e madhe; shiko çfarë sasive peshku të kapur!” Por shumë pak do të pyesin se si e bëri Jezusi këtë dhe shumica nuk e dinë se atyre u janë dhënë i njëjti autoritet dhe aftësi për të gëzuar të njëjtin nivel sigurie që patën atë ditë Pjetri, Jakobi dhe Gjoni. Përgjigjja standarde në lidhje me një shpjegim se si Jezusi e bëri atë që bëri atë ditë është se Jezusi mund ta bënte atë sepse Ai është Jezusi. Por prit; ne e pamë tashmë se Jezusi nuk mund t’i shëronte



të gjithë te Marku 6, sepse qielli nuk kishte juridiksion atje. Jo, atë ditë ishin në veprim ligje shpirtërore të Mbretërisë, që lehtësuan dhe realizuan kapjen e asaj sasi peshku.

Por ja cili është problemi. Shumica e të krishterëve që takoj as që e mendojnë të mundur të bëjnë të njëjtat gjëra që bëri Jezusi, dhe po ta mendojnë, ata nuk e kanë idenë se si Ai i bëri ato. Unë kam një thënie që e përdor në konferencat e mia që, nëse nuk mund të japësh mësim diçka, nuk mund ta jetosh atë. Ajo që dua të them është se nëse nuk mund ta përcaktosh se si u kap ajo sasi peshku, nuk do të jesh kurrë në gjendje ta imitosh atë. Pra, si u shfaq ajo sasi e madhe peshku? A mund ta përcaktosh? Nëse do që të arrish atë lloj suksesi, do të të duhet të kuptosh se si u shfaqën ata peshq. Megjithatë, shumica e njerëzve tronditen kur filloj të flas kështu. Por çfarë tha Jezusi?

*Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: kush beson në mua do të bëjë edhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse unë po shkoj tek Ati.*

— Gjoni 14:12

Kur Jezusi tha se ne mund të bënim të njëjtat vepra që po bënte Ai sepse po shkonte tek Ati, Ai i referohej Frymës së Shenjtë që do të vinte mbi ne pas vdekjes dhe ringjalljes së Tij. Ky është i njëjti Frymë e Shenjtë që erdhi mbi Të në lumin Jordan, duke e lejuar Atë të bënte veprat e fuqishme të Perëndisë që ne i shohim kur ndjekim shërbimin e Tij. Meqenëse e dimë se kjo fuqi u pengua te Marku 6 për shkak të mosbesimit të njerëzve, por nuk u pengua te Lluca 5 në lidhje me peshqit, ne duhet t'i studiojmë ligjet e Mbretërisë në mënyrë që të mund të përcaktojmë se çfarë pengon ose çfarë lehtëson rrjedhshmërinë e lirë të Frymës së Shenjtë në çdo situatë. Pra, le t'i hedhim një sy historisë dhe të shohim nëse mund t'i kuptojmë ligjet dhe parimet e Mbretërisë të cilat mund t'i identifikojmë dhe prej të cilave të mësojmë.

Nëse e ke lexuar librin tim të parë, e di se çfarë ndodhi në këtë rast nga ana shpirtërore kur Pjetri i dha Jezusit barkën për ta përdorur. Varka e Pjetrit, dhe në fakt i gjithë biznesi i peshkimit, ndryshuan mbretëritë ose juridiksionet! Po, kur Jezusi mori varkën nën shërbimin e Tij, varka e Pjetrit u vendos nën juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë. Pasi varka hyri nën juridiksionin e Mbretërisë së Perëndisë, Fryma e Shenjtë pati juridiksion ligjor për t'i dhënë Jezusit një Fjalë Njohurie për vendndodhjen e tufës së peshqve në ujërat e thella. Sasia e madhe e peshkut ishte rezultat i një plani dhe strategjie të mbinatyrshme që Fryma e Shenjtë ia dha Pjetrit nëpërmjet Jezusit atë ditë. Unë e quaj njohuri sekrete, dhe për shkak të saj, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni kapën sasinë më të madhe të peshkut që kishin parë ndonjëherë. Në fakt, Bibla thotë se këta peshkatarë me përvojë u habitën.

Unë besoj se Jezusi do që edhe ti të jetosh një jetë mahnitëse, një jetë që e demonstroi Mbretërinë në mënyrë që njerëzit përreth teje të mahniten nga ajo që shohin dhe të njohin gjithashtu Jezusin. Unë besoj se varkat boshe të fesë nuk do t'i joshin kurrë njerëzit drejt Perëndisë. Perëndia dëshiron që njerëzit ta shohin mirësinë e Mbretërisë së Tij, në mënyrë që të gjithë të shohin dhe besojnë se Ai është i mirë dhe i gatshëm t'i pranojë të gjithë ata që vijnë tek Ai. Isaia foli për këtë kur shpalli profecinë e mëposhtme, e cila i referohej kishës.

*“Ata [duke na u referuar neve] të quhen lisa të drejtësisë, mbjellja e Zotit, për të paraqitur laudinë e tij (Isaia 61:3b)*

Pra, cili është mesazhi që dua që të marrësh nga historia e peshkimit në kapitullin 5 të Llukës? Epo, ka shumë ligje shpirtërore që mund t'i nxjerrësh nga ajo histori, por edhe ky mendim i vetëm do të ta ndryshojë jetën.

Çdokush mund të kapë **peshk nëse Jezusi i tregon me saktësi se ku të hedhë rrjetën!! Ose më lejo ta them në këtë mënyrë: Çdokush**

## **mund të kapë peshk nëse Jezusi i tregon se ku janë peshqit dhe si t'i kapë ata!**

Njerëzit më thonë: “Epo, kjo është gjë e mirë, Geri, por Jezusi nuk është më këtu.” Jo, por i njëjti Frymë e Shenjtë që i tha Atij atë ditë se ku ishin peshqit, është sot këtu dhe jeton në ty nëse je besimtar. Dëgjoje atë që Jezusi u tha dishepujve të Tij ndërsa po përgatitej t'i linte ata.

*Ju kam thënë këto gjëra, ndërkaq jam me ju; por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë. Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.*

— Gjoni 14:25-27

Cila ishte paqja e Jezusit? Ishte Fryma e Shenjtë që i tha Atij se si ta trajtonte çdo situatë që do të ndeshte. Jezusi e quajti Frymën e Shenjtë Këshilltar. Mik, ky Këshilltar jeton në ty dhe nuk do të të lërë kurrë. A po e dëgjon Atë? Duhet të biesh dakord se Perëndia e ka me siguri përgjigjen për çdo situatë në të cilën mund të gjendesh. Jezusi thotë se ky Këshilltar mund të të mësojë ose të të japë këshilla për të gjitha gjërat. Sipas *Treguesit të Plotë Alfabetik të Biblës nga Strong* (3875), fjala në greqisht e përkthyer këtu “Këshilltar”, fjalë për fjalë do të thotë: i thirrur ose i thirrur në mbrojtje të dikujt, veçanërisht i thirrur për ndihmë. Gjithashtu, do të thotë ai që paraqet çështjen e dikujt tjetër përpara gjykatësit, një këshill i mbrojtjes, një asistent ligjor ose një avokat. Në kuptimin e saj më të gjerë, fjala do të

**JEZUSI E QUAJTI FRYMËN E SHENJTË KËSHILLTAR. MIK, KY KËSHILLTAR JETON NË TY DHE NUK DO TË TË LËRË KURRË.**

thotë një ndihmës ose një që sjell ndihmë, ose një asistent.

Nuk e di për ty, por mua më hyn në punë një asistent i tillë; po ty? Fryma e Shenjtë ishte përgjigja e Pjetrit kur ata kishin peshkuar gjithë natën dhe nuk kapën asgjë. Dhe Fryma e Shenjtë ishte përgjigja ime kur nuk e kisha idenë se ku t'i gjeja paratë që më duheshin për të shlyer borxhin. Pasi e futa familjen time në një ngatërresë të tillë financiare për gjithë ato vite, kur iu drejtova Zotit për ndihmë, ishte Fryma e Shenjtë që më dha një ëndërr një natë duke më treguar të largohesha nga kompania ku punoja dhe të hapja kompaninë time nga e para.

Ishte Fryma e Shenjtë që më tha se misioni i kësaj kompanie të re ishte të shpallte mirësinë e Perëndisë dhe t'i ndihmonte njerëzit të shpëtonin nga borxhi, që në atë kohë ishte mendimi më i çmendur që kisha dëgjuar ndonjëherë. Unë t'i ndihmoj njerëzit të shpëtojnë nga borxhi? Unë isha fëmija shembull se çfarë nuk duhet bërë me paratë. Jeta ime ishte një makth financiar. Por kjo është ajo që Ai tha të bënim, kështu që, me besim, Drenda dhe unë hodhëm hapat dhe në thelb thamë të njëjtën gjë që bëri Pjetri. “Zot, kjo nuk ka kuptim, por meqë e thua, ne do ta bëjmë.” Duke ndjekur këshillën e Frymës së Shenjtë, ajo kompani e re sa vinte e rritej dhe siguroi paratë që më mundësonin mua dhe Drendën të shpëtonim plotësisht nga borxhi. Ajo kompani kryen ende veprimtari sot, tashmë 30 vjet më vonë, dhe ende po gjeneron qindra mijëra dollarë fitim në vit.

Ej, unë nuk jam aq i zgjuar dhe as ti, por Perëndia të ka dhënë Frymën e Shenjtë për të të ndihmuar me përgjigjet që të nevojiten në jetë. Por siç do ta mësojmë në këtë libër, ne kemi rolet tona për të luajtur, duke punuar me Frymën e Shenjtë për të realizuar vullnetin e Perëndisë.

Fatkeqësisht, nga përvoja ime me njerëzit, duket se shumë të krishterë nuk kanë përgjigje për problemet me të cilat përballen në jetë. Ata thjesht vazhdojnë të peshkojnë jashtë mundësive të tyre dhe, pasi peshkojnë gjithë natën, kthehen vazhdimisht bosh ose pothuajse

bosh. Ata kurrë nuk e kanë dëgjuar se Fryma e Shenjtë është atje për t'i ndihmuar në çdo situatë. Edhe pse shumica e të krishterëve do të thonë: “Perëndia do të më ndihmojë të bëj këtë apo atë”, ata nuk e kuptojnë se si Ai i ndihmon ata, apo se si t'i dëgjojnë përgjigjet që u nevojiten. Shumë veta nuk e kuptojnë se duhet të punojnë me Perëndinë për të përmbushur përgjigjet që u nevojiten dhe ende presin që Perëndia të bëjë diçka për problemin e tyre kur përgjigja është tashmë aty brenda tyre.

Për sa i përket parave, për shembull, njerëzit do të thonë se Perëndia do të më begatojë. Unë them: “Shkëlqyeshëm! Si do të t'i sjellë Perëndia paratë?” Në fillim, ata sillen të ofenduar që bëra një pyetje të tillë sikur po sfidoj besimin e tyre. Por unë ngul këmbë. “Ku do të shfaqen paratë? Si do t'i sjellë Perëndia tek ti?” Kur këmbëngul për një përgjigje, ata nuk e kanë idenë. Nuk ka problem të mos e dish për njëfarë kohe, por në fund, duhet të kesh një përgjigje. Ti nuk mund ta korrësh atë që nuk e sheh. Ki parasysh, Jezusi u tregua shumë specifik kur i tha Pjetrit se ku ishin peshqit dhe madje i tha atij se si t'i kapte ata: “Hidh rrjetën”. Përfundimisht, do të të duhet ta dish se ku ta hedhësh rrjetën tënde nëse do që të kapësh peshk.

Për shkak se njerëzit zakonisht kanë atë që unë e quaj një mendësi kutie postare, duke menduar se Perëndia thjesht do ta bëjë këtë, jeta e tyre financiare mbetet i njëjti lëmsh jofunksional për 10 ose 20 vjet pa asnjë ndryshim. Është e trishtueshme. Dëshiron të dish pse mbeten të njëjtë? Kjo është për shkak se atyre nuk u është mësuar asnjëherë se si të peshkojnë sipas mënyrës së Frymës së Shenjtë, mënyrës së Mbretërisë. Ata nuk e dinë se si Fryma e Shenjtë vepron në mbretërinë e tokës për t'i ndihmuar që të kenë sukses. Ata nuk e dinë rolin që duhet të luajnë dhe çfarë roli luan Fryma e Shenjtë në arritjen e suksesit për të cilin kanë aq shumë nevojë.

Është si ai burri që pashë sot në drekë. Ai ishte trupmadh, ndoshta 170 kg. Ai kishte një protezë në njëren këmbë dhe kishte dy bastunë

me vete. Ai mezi lëvizte. Pasi e hëngri çizbugerin e tij, kërkoi një copë ëmbëlsirë me gjalpë kikiriku. Mbeta në vend i tronditur teksa e dëgjoja atë duke kërkuar atë ëmbëlsirë. Nuk jam i sigurt se çfarë po mendonte, por kishte ngrënë mjaft ëmbëlsira. Kjo ishte e qartë dhe po i shkaktonte vdekjen. Ai u përpoq të ngrihej nga tavolina dhe ngadalë

## **FRYMA E SHENJTË, VETË PERËNDIA, JETON NË TY PËR TË TË DHËNË ÇDO PËRGJIGJE QË MUND TË KESH NEVOJË TË DISH.**

dhe me dhimbje doli nga restoranti. Kështu i shoh të krishterët që jetojnë sot – duke dëgjuar premtimet, por duke vazhduar të hanë helmin dhe më pas të pyesin veten pse gjërat nuk po funksionojnë.

Mik, ti e ke përgjigjen! Fryma e Shenjtë, vetë Perëndia, jeton në ty për të të dhënë çdo përgjigje që mund të kesh nevojë të dish. Njerëzit më pyesin nëse duhet të martohen me Suzanën apo Sellin, nëse duhet të pranojnë këtë apo atë punë, nëse duhet të lëvizin ose të qëndrojnë aty ku janë, t'i shesin aksionet e tyre ose të blejnë aksione. Fryma e Shenjtë brenda teje i ka përgjigjet. E përsëris, ky është qëllimi i këtij libri, të mësojmë se si Fryma e Shenjtë na ndihmon dhe si funksionon Mbretëria në lidhje me dëgjimin e zërit të Frymës së Shenjtë.

Më lejo të bëj një përsëritje.

Çdokush mund të kapë peshk nëse Jezusi i tregon se ku janë peshqit dhe si t'i kapë ata, edhe ti madje!

***Karola e shpjegon në këtë email se si ndryshoi jeta e saj..***

*Si sot një vit më parë, po blija dhuratat e Krishtlindjes me karta krediti, duke i shpenzuar deri në limitin e tyre, sepse nuk kisha para për të blerë dhurata për vajzën time, e cila ende besonte te Babagjyshi. Jetoja në ankth dhe trishtim të vazhdueshëm dhe i shkrova pastor Gerit se kjo puna e mbjelljes nuk funksionoi, se asgjë nuk ndodhi; dhe ai me shumë durim*

*m'u përgjigj të prisja, se korrja kërkon pak kohë dhe zakonisht nuk ndodh të nesërmen.*

*Sot, një vit më vonë, po blej dhurata për të gjithë familjen time me para në dorë. Unë jam duke blerë dhurata që kushtojnë 300 ose 400 dollarë dhe po nderoj ata pak njerëz që më ndihmuan në ato momente të vështira. Vitin e kaluar kam banuar në një dhomë në një bodrum ku disa miq më kishin lejuar të qëndroja për disa muaj. Nuk kisha para as për ushqim, as për benzinë. Por tani jetoj në një apartament të bukur dhe luksoz, dhe frigoriferi im është plot me ushqime.*

*Në 3 dhjetor kisha ditëlindjen e vajzës dhe ne e çuam në parkun "Hershey" në Pensilvani. Ftua shoqen e saj të ngushtë dhe qëndruam në hotelin "Hershey" dhe paguam gjithçka me para në dorë. Dhe unë munda t'i blija asaj një dhuratë të mrekullueshme që më kushtoi më shumë se 400 dollarë ndërkohë që vitin e kaluar dikush më poshtëroi duke më dhënë 30 dollarë për të festuar ditëlindjen e saj.*

*Nuk mund ta shkruaj këtë postim pa u përlotur. I jam shumë mirënjohës pastor Gerit dhe gruas së tij, Drendës. Ky vit ka qenë viti më i mirë i jetës sime. Gjërat që Perëndia ka bërë në jetën time janë të mrekullueshme. Mund të shkruaj një libër me të gjitha historitë e mia. Faleminderit që më mësove se mund ta jetoj parajsën në tokë.*

Emaili i mëposhtëm është një nga historitë më mahnitëse të Mbretërisë që kam dëgjuar; është nga Sharoni në Miçigan.

*Pastor Geri, po e shkruaj këtë në emër të bashkëshortit tim dhe në emrin tim. Unë thjesht dua të them faleminderit sepse*

*ju dhe gruaja juaj keni qenë një frymëzim i madh për ne. Ne dëgjuam për ju në Sid Roth rreth tre ose katër vjet më parë. Po kalonim një kohë shumë të vështirë. Burrin tim e pushuan nga puna pas 18 vjetësh dhe ne sapo kishim ndërtuar një shtëpi 280 000 dollarë kur ndodhi kjo. Ishim deri në grykë në borxhe dhe stres.*

*Ne porositëm CD-të tuaja dhe ato na ndihmuan. Mësuam se si borxhi mund të jetë kaq paralizues dhe mund të ndikojë në shëndet dhe jetë në mënyrë kaq rrënjësore. Nuk shihnim rrugëdalje. Edhe pse nuk mund të paguanim për shtëpinë tonë të re, ne jetuam në të për dy vjet përpara se të largoheshim. Ky ishte një bekim në vetvete.*

*Por për t'i rënë shkurt një historie të gjatë, burri im mundi ta rifitonte punën e tij të vjetër pas katër vjetësh, sepse ai qëndroi në besim dhe i besoi premtimet e Perëndisë, dhe me ju dhe gruan tuaj që na ndihmoni duke dëgjuar CD-të tuaja. Burrin tim iu rikthye puna e vjetër plus të gjitha pagat e prapambetura për ato katër vjet! Nuk u përfshi asnjë avokat apo ndonjë gjë ligjore. Ai gjithashtu përfitoi të gjithë kohën e tij të pushimeve për ato katër vjet. Në fakt, kur e punësuan përsëri, gjëja e parë që i kërkuan të bënte ishte të shkonte me pushime! Epo, ne ishim në gjendje të paguanim me para në dorë për një shtëpi më të mirë se ajo që humbëm me pagesën e prapambetur që ai mori. Faleminderit për gjithçka që bëni.*

Nga Endrju në Misuri:

*Dy vjet më parë në maj, isha në një pozicion të vështirë. Nuk isha i lumtur në punën time të mëparshme dhe pranova një pozicion të ri në shitjet e jashtme. Kreditorët po telefononin, mezi më dilnin paratë për naftë apo ushqim, po vinte fundi*



*i muajit dhe pagesa e qirasë po afrome. Megjithatë, ajo që KISHA, ishte një pirg me CD nga Geri, nga seria Revolucionari 2.0. Isha ulur në shërbesë një ditë dhe doja të mbillja, por kisha vetëm 23 dollarë të mbetura dhe naftë që nuk më mjaftonte për të gjithë javën. Puna nuk po shkonte mirë dhe po i bëja të ditur Perëndisë se doja të mbillja, por thjesht nuk kisha para. Dëgjova një zë që doli nga brenda meje duke thënë se Unë (Perëndia) mund të bëj më shumë me ato 23 dollarë sesa ti. Perëndia foli me mua për të mbjellë 20 dollarë dhe për të besuar Atë për një korrje të mirë.*

*Atë të enjte, po ndihmoja me llogarinë e diku tjetër që po i bënim mirëmbajtjen. Unë isha i gatshëm ta ndihmoja edhe pse nuk do të merrja asgjë edhe nëse do të shisnim ndonjë produkt. Pasi mbaroi dita, mbikëqyrësi im tha se e vlerësonte ndihmën dhe se mund t'i mbaja të gjitha përqindjet e asaj dite (kjo nuk ndodh natyrshëm në shitjet me komision në rast se po pyet veten). E di çfarë? Fitimi total që do të merrja ishte... 2000 dollarë!!! FITIM 100-FISH në më pak se një javë!*

*Perëndia është vërtet besnik dhe pak është shumë kur përfshihet Perëndia. Që atëherë, unë kam qenë i zellshtëm për të dhënë të dhjetat dhe ofertat e mia me një qëndrim të gëzuar dhe duke pritur rritje.*

*Disa muaj pasi ndodhi kjo, u bekova me një pozicion të ri që ishte PIKËRISHT ajo për të cilën mbolla. Kalova nga vështirësia për të ecur përpara në katërfishimin e të ardhurave të mia në vetëm dy vjet. Lavdi Perëndisë dhe Atij i takon e gjithë Lavdia. Lavdërim dytësor: Banka nuk e zotëron më makinën time, dhe unë po ngas një makinë krejt të re të PAGUAR!!!*

Ja edhe një raport lavdërimi nga Koreja:

*I dashur Pastor Geri,*

*Unë jetoja një jetë pa qëllim dhe nuk mund të përballoja asgjë vetë. Dikur jetoja me lëmoshë dhe kur njerëzit lodheshin duke më ndihmuar, shpresa ime e vetme ishte të blija një pako biskota dhe një shishe koka-kola. Kjo ishte gjithçka që mund të përballoja për të ngrënë unë dhe dy fëmijët e mi. Nuk kisha mundësi të paguaja qiranë apo faturat tona. Ende më kujtohet kur pashë për herë të parë një shërbesë të transmetuar drejtpërdrejt të Faith Life Church (emri i kishës). I shpjegova pastorit tuaj në internet se sa e rëndë ishte situata ime dhe gjithçka që ai tha ishte se duhej t'i kërkoja Perëndisë të më tregonte se si dhe ku të peshkoja, siç i tregoi Pjetrit kur kishte taksa për të paguar. Për t'i rënë shkurt një historie të gjatë, tani zotëroj një restorant afrikan dhe një floktore për meshkuj, të gjitha për shkak se dëgjova mësimet e Pastor Gerit. Lavdërimi im i takon Perëndisë!*

Këto kanë qenë disa histori të mrekullueshme! Por mbase ti po thua: “Kjo është e mrekullueshme, Geri. Sigurisht, gjërat funksionuan për njerëzit e tjerë, por jo për mua.” Epo, historia jote nuk ka mbaruar! Më lejo të të pyes për këtë. Ndërsa je ulur aty duke e lexuar këtë kapitull, a je duke u mbajtur në mënyrë të dëshpëruar pas karriges sate me frikë të madhe se mund të fluturosh larg? Jo, nuk po e bën. Pse? Sepse ti e kupton ligjin e rëndesës dhe e di që ai funksionon njësoj për të gjithë. Epo, Mbretëria e Perëndisë funksionon në të njëjtën mënyrë. Ti mund t'i mësosh ligjet. Ti mund të mësosh të dëgjosh strategji unike që do ta kthejnë jetën tënde në një histori të fuqisë së Perëndisë. Ne e kemi vërtetuar tashmë faktin se është mprehtësia dhe ndihma e Frymës së Shenjtë që i bëri këto histori të ndodhin. Pra, le ta fillojmë udhëtimin tonë me një përmbledhje të disa gjërave bazë të Frymës së Shenjtë, më pas do të kalojmë në hollësi më të mëdha rreth të dëgjuarit të strategjive që na duhen.

## KAPITULLI 4

# BAZA: MOS DIL NGA SHTËPIA PA KËTË

Nëse do të bësh një jetë plot me strategji të Frymës së Shenjtë dhe fitore të udhëhequra nga Fryma e Shenjtë, së pari, ti duhet të rilindësh dhe më pas, së dyti, të pagëzohesh në Frymën e Shenjtë. Po, ato janë dy vepra krejtësisht të ndryshme të së njëjtës Frymë. Nëse kjo është diçka krejtësisht e panjohur për ty, nuk ka problem. Unë do të ta shpjegoj. Por më lejo të shkoj menjëherë te thelbi: Jezusi tha se ishte kaq e rëndësishme të kishim Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, saqë Ai tha se nuk duhet të dalësh nga shtëpia pa të! Kije parasysh, nuk e thashë unë këtë; Jezusi e tha te Veprat e Apostujve 1:4-5.

*Të mos largoheshin nga Jerusalemi, por të prisnin premtimin e Atit: “Që, tha ai, e keni dëgjuar nga unë, sepse Gjoni pagëzoi me ujë, por ju do të pagëzoheni me Frymën e Shenjtë, mbas jo shumë ditësh”.*

— Veprat e Apostujve 1:4b-5

*Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi.*

— Veprat e Apostujve 1:8

Vër re se Jezusi tha: “Mos dilni nga shtëpia pa këtë - kjo është thelbësore!” Në thelb, Ai po thoshte: “Ju keni nevojë për këtë fuqi për të bërë veprat e Perëndisë, për të qenë dëshmitarë të Mbretërisë.” Megjithatë sot, ka plot të krishterë që ende nuk kanë dëgjuar ose përjetuar Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, plot të krishterë që janë rritur në kishë, por ende nuk kanë dëgjuar kurrë për nevojën e Pagëzimit të Frymës së Shenjtë. Ose janë rritur në kishë dhe u është thënë se pagëzimi nuk vlen për sot, se mrekullitë kanë kaluar.

Jam rritur në një kishë të tillë dhe nuk kam dëgjuar kurrë për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë. Unë marr shumë emaile nga njerëz në mbarë botën që nuk kanë dëgjuar ende për këtë të vërtetë të fuqishme. Shumë nga emaillet që marr vënë në pikëpyetje vlefshmërinë e kësaj dhurate për sot, prandaj gjeta kohë për të shkruar të vërtetën në lidhje me Pagëzimin e Frymës së Shenjtë.

Unë besoj se Bibla është shumë e qartë në lidhje me këtë aspekt dhe dua ta lë Biblën të flasë vetë. Ajo do t’u përgjigjet të gjitha pyetjeve të tua. Por, së pari, dua të të jap disa informacione se si e zbulova të vërtetën rreth Pagëzimit të Frymës së Shenjtë.

Kur isha më i ri, kisha uri për Perëndinë (ende kam, megjithëse jam më i vjetër), dhe frekuentoja një kishë denominacionale. Çdo të diel në mëngjes kryenim rutinat fetare të zakonshme. Ndoshta edhe ti. Më kujtohen disa himne të pasuara nga një moment i heshtur meditimi. Ne gjithmonë citonim Lutjen e Zotit dhe më pas pastori mbante një predikim, një himn mbyllës dhe një bekim. Çdo shërbesë ishte e organizuar në të njëjtën mënyrë.

Njerëzit atje ishin të mrekullueshëm dhe, po, ata e donin vërtet Perëndinë. Por unë kurrë nuk e pashë vërtetë realitetin e Ungjillit. Nuk pashë jetët e njerëzve të ndryshonin në mënyrë thelbësore apo njerëz të shëruar nga fuqia e Perëndisë. Besoj se mund të them se nuk pashë shumë demonstrime të Mbretërisë së Perëndisë.

E pra, atje isha i uritur për Perëndinë, 18 vjeç, dhe menaxhoja

picerinë e babait tim. Një mbrëmje, në picerinë tonë erdhi një djalë dhe më ftoi në një takim ripërtëritjeje. Ai po mbahej në një kishë të vogël metodiste në qytetin tim dhe folësi i ftuar ishte një ungjilltar i cili foli për Jezusin duke bërë të njëjtat gjëra sot si Ai në Bibël.

Epo, kjo ma tërhoqi vëmendjen sepse doja ta shihja. Disa nga miqtë e mi e frekuentonin këtë kishë, kështu që vendosa të shkoj në takimin e ripërtëritjes. Megjithëse nuk dëgjova për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë atë natë, u preka thellë nga prania e Perëndisë në atë shërbesë. Miqtë e mi që po merrnin pjesë atje më inkurajuan të kthehesha të dielën, gjë që e bëra. Unë u dashurova me atë kishë dhe e bëra shtëpinë time të re.

Disa javë pas takimit të ripërtëritjes, takova një grup grash që frekuentonin kishën dhe gjithashtu zhvillonin një studim javor biblik. Ato po flisnin për diçka që quhet Pagëzimi i Frymës së Shenjtë, dhuratat e Frymës dhe gjëra të tjera për të cilat nuk kisha dëgjuar kurrë më parë. Isha aq i etur të dëgjoja për këtë fuqi për të cilën folën, sa që i pyeta nëse mund të vija në studimin biblik të grave. Studimi i tyre i Biblës zhvillohej në mëngjes dhe duke qenë se punoja natën në piceri, vendosa të merrja pjesë.

Kur arrita atje, kuptova se isha vërtet i vetmi djalë i pranishëm dhe i vetmi 18 vjeçar gjithashtu, por kjo nuk kishte rëndësi për mua. Shkova në studimin e Biblës sepse kisha uri për Perëndinë. U bëra *kaq* shumë pyetje.

Zonjat u treguan shumë të durueshme me mua dhe më shoqëruan nëpër Shkrimet e Shenjta dhe më treguan në Biblën *time* se Pagëzimi i Frymës së Shenjtë vlente për sot dhe se fuqia e Perëndisë është e disponueshme sot, ashtu siç ishte kur Jezusi ecte në tokë. Pjesa më e mirë ishte kur ato thanë se është për *të gjithë* besimtarët - është për këdo që e kërkon.

Pasi e kisha ndjekur studimin biblik për disa javë, më thanë se një shërbim kombëtar i quajtur “Women’s Aglow” do të zhvillonte një takim ku i ftuar ishte i gjithë qyteti. “Women’s Aglow” ishte dhe është

ende një organizatë që jep shumë mësim për Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë. Këto gra po planifikonin të merrnin pjesë dhe më ftuan të shkoja me to. Në ato ditë, njerëz nga të gjitha denominacionet mbledheshin për të dëgjuar dhe shijuar këtë pagëzim, për të cilin deri në atë moment flitej kryesisht vetëm në kishat Pentakostale. Ato ishin ditët që shumë njerëz i quajnë Ripërtëritja Karizmatike, ku ky mësim i Frymës së Shenjtë përshkoi të gjitha linjat denominacionale.

Kur mora pjesë në mbledhjen e “Women’s Aglow”, pashë që ishin mbledhur qindra zonja. Përsëri, unë isha në pakicë si burrë, por në atë dhomë kishte një prani të Perëndisë që ishte e prekshme.

U mrekullova kur njerëzit po flisnin për shërimin dhe pashë me habi teksa disa për të cilët luteshin ranë përtokë. Kjo ishte diçka që nuk e kisha parë kurrë më parë dhe u bëra kureshtar dhe u hutova prej saj. Mësova se njerëzit atje e quanin këtë gjë “të vritesh” në Frymë. Edhe pse vetvetiu m’u duk paksa e çuditshme, njerëzit që e përjetuan dukej se u ngritën të gëzuar dhe padyshim të prekur nga Perëndia. Më vonë, kuptova nga zonjat se mishi ynë nuk mund ta mbajë fuqinë e Perëndisë dhe ndonjëherë mund të pushtohet nga ajo që ato e quajtën “vajosje”.

Ato më treguan se ku ndodhi kjo në shërbimin e vetë Jezusit. Tek Gjoni 18:4b-6, kur ushtarët erdhën për ta arrestuar Jezusin, Jezusi pyeti:

*“Kë kërkoni?”. Ata iu përgjigjën: “Jezusin Nazareas”. Jezusi u tha atyre ... “Unë jam”, ata u zmbropsën dhe ranë për dhe.*

Gjatë adhurimit, zonjat përreth meje ishin të gjitha shumë të emocionuara dhe dëgjova shumë njerëz përreth meje që flisnin dhe lavdëronin Perëndinë në gjuhë të tjera. E gjithë përvoja ishte aq e re për mua, sa që gjatë pjesës më të madhe të takimit qëndrova i mahnitur. Edhe pse kishte shumë aspekte të takimit që ishin pak të çuditshme për mua, nuk mund ta mohoj praninë e pabesueshme dhe të prekshme të Perëndisë. Isha shumë i emocionuar kur zbulova se realiteti i ungjillit, fuqia e Perëndisë, po vepronte ende në tokë, ashtu si në Bibël.

Atë ditë, folësja i kërkoi kujtdo që dëshironte ta merrte këtë dhuratë të Frymës së Shenjtë, të dilte përpara për t'u lutur në fund të takimit. Kështu që unë shkova përpara që zonjat të luteshin me mua. Ndërsa ato luteshin, u trondita ndërsa prania e Perëndisë bëhej edhe më e fortë. Teksa iu nënshtrova pranisë së Tij, u mahnita kur dëgjova veten duke filluar të lutem në Frymën e Shenjtë dhe të flas fjalë që nuk i kuptoja. Unë u luta në gjuhë të huaja për një kohë të gjatë atë natë. Isha shumë i tronditur nga përvoja, sa që doja t'ua tregoja të gjithëve që takova për atë që më kishte ndodhur! Por kur ua tregova miqve të mi në kishë atë që kisha përjetuar, ata nuk u emocionuan shumë. Ata zakonisht thoshin se gjuhët ishin të djallit, ose se kishin kaluar. Ata më paralajmëruan të qëndroja larg atyre besimtarëve të shfrenuar!

Në ato ditë, kishat nuk ishin mikpritëse ndaj dhuratave të Frymës dhe doktrina mbizotëruese ishte se mrekullitë kishin vdekur me apostujt. Por tani e kuptova se fuqia e Perëndisë nuk kishte mbaruar aspak!

Pak përpara se të zhvillohej ky takim i “Women’s Aglow”, mua më kishin caktuar drejtues të të rinjve në atë kishë të vogël metodiste. Në të vërtetë nuk kërkohet aq shumë prej meje, përveç që të bënim një mbledhje me të rinjtë çdo të diel në mbrëmje në bodrumin e kishës. Zakonisht luanim disa lojëra, pinim pije freskuese dhe bënim një studim të shkurtër biblik. Unë vetë isha i ri, por pashë se kisha zell për gjërat e Perëndisë dhe isha i gatshëm të ndihmoja.

Zakonisht kishte rreth 15 të rinj në grup dhe pas përvojës sime atë ditë në takimin e “Women’s Aglow”, doja t'ua tregoja për këtë Pagëzim të Shpirtit të Shenjtë që kisha përjetuar. E kuptova se, si unë, shumica prej tyre as që kishin dëgjuar për këtë përvojë dhe e dija se nuk do të dëgjonin për të gjatë shërbesës së të dielës në mëngjes në atë kishë.

Përpara se të të tregoj se çfarë ndodhi më pas, mendoj se duhet të të jap një përditësim të shpejtë lidhur me mendësinë time në atë kohë. Nuk mora lejen e pastorit për të folur për këtë me të rinjtë. (Tani e kuptoj se duhet të

kisha marrë.) Gjithashtu, nuk i tregova se çfarë më kishte ndodhur.

Nuk po përpiqesha të veproja në rebelim kundër kishës sime dhe nuk po përpiqesha ta anashkaloja pastorin tim. Unë thjesht isha i emocionuar. Në atë kohë, unë vërtet nuk e kuptoja polemikën mbi këtë temë dhe sigurisht nuk mendoja se pastori do të ishte kundër saj.

Natën e së dielës pasi mora pagëzimin e Frymës së Shenjtë, planifikova t'u tregoja të rinjve për atë që më kishte ndodhur dhe t'u tregoja disa nga shkrimet e shenjta që flisnin për këtë në librin e Veprave të Apostujve. Ne ishim në bodrumin e kishës të ulur në dysheme në një rreth kur ndava përvojën time me ta dhe kalova nëpër disa nga shkrimet e shenjta që e vërtetojnë këtë përvojë.

Një mbrëmje të veçantë, pastori erdhi në mbledhje dhe ishte ulur në të majtën time ndërsa flisja. Nuk ishte problem prania e tij aty. Si pastori im, mendova se ai tashmë dinte gjithçka që unë do të ndaja gjithsesi.

Kështu, u tregova atyre për takimin në të cilin kisha shkuar dhe për gjërat që kisha parë. Nuk u futa në shumë detaje rreth të folurit në gjuhë. Në vend të kësaj, e përqendrova vëmendjen time tek Veprat e Apostujve 1:9 ku thotë se do të marrim *fuqi* kur Fryma e Shenjtë të vijë mbi ne për të qenë dëshmitar për Perëndinë. Në fund të takimit, vërtet nuk dija si ta mbyllja mësimin tim, kështu që thjesht u kërkova të rinjve të ngrinin dorën nëse dëshironin të merrnin Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë.

Në atë pikë nuk dija çfarë të bëja. Dua të them, nuk kisha parë kurrë dikë t'i fliste dikujt për Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë, përveç asaj që kisha parë në mbledhjen e "Women's Aglow". Unë mendoj se në atë kohë mund të kem ditur vetëm dy ose tre shkrime të shenjta që i referohen asaj.

Kështu, unë thjesht thashë: "Nëse dëshironi ta merrni këtë dhuratë falas të Frymës së Shenjtë, thjesht ngrini dorën dhe le të përkulim kokën dhe të lutemi." Kjo është me të vërtetë gjithçka që thashë. Unë



nuk i preka, as nuk i udhëzova se si ta merrnin Frymën e Shenjtë. Ulëm kokën dhe u lutëm. Natyrisht, ne mbyllëm sytë për t'u lutur siç kanë mësuar të gjithë të krishterët e dominacioneve “të mira”.

Ndërsa u ula atje pasi thashë “Amen”, fillova të dëgjoja një zhurmë mes të rinjve. Hapa sytë dhe pashë që disa nga të rinjtë po qanin, disa po dridheshin dhe shtatë të rinj kishin filluar të flisnin në gjuhë. Ndërsa filluan të flisnin në gjuhë, pashë shkëlqimin më të pazakontë në fytyrat e tyre. Ata u ndezën si llamba! Unë u trondita!

Pastori im, i cili nuk kishte thënë asgjë deri në këtë pikë, më preku me vrap në shpatull dhe më pyeti nëse mund të fliste me mua menjëherë. Shkuam në dhomën tjetër dhe ai më pa në sy dhe më tha: “Kjo është nga djalli. Ju nuk mund të jeni më drejtuesi i të rinjve këtu. Ne nuk do ta lejojmë këtë.”

Mendova: *Si mund të thuash se është prej djallit? Dua të them, shikojini këta të rinj! Ata shkëlqejnë!* Mund ta shihje vajosjen fizikisht mbi ta. Sigurisht, atëherë as që e dija se çfarë ishte fjala *vajosje*. Thjesht e dija që po shkëlqenin dhe nuk i kisha prekur, apo nuk u kisha thënë se si të vepronin. Ishte shumë shkurajuese dhe konfuze për mua që pastori im të më qortonte kështu dhe nuk dija çfarë të bëja.

Të dielën tjetër, u ktheva në kishë, por në vend që të ulesha afër fillimit të kishës ku rrija zakonisht, u ula prapa. E dija se pastori im ishte zemëruar me mua për shkak të takimit me të rinjtë dhe mendova se do të ishte më mirë të mos përfshihesha për pak kohë derisa t'i kuptoja gjërat.

Gjatë shërbesës së të dielës në mëngjes, ishte momenti i zakonshëm i heshtur i meditimit. Ky ishte një moment plot respekt dhe i qetë lutjeje në kishën time. Të gjithë e kishin kokën të ulur dhe nuk pipëtitin asnjë zë në kishë. Mund ta dëgjoje edhe një gjilpërë po të binte. Pikërisht në këtë çast ndjeva se dikush më preku mbi sup. Unë isha në fund të stolit, dhe me sa duket dikush po qëndronte në këmbë në korridor dhe po më godiste mbi shpatull.

Në fillim u trondita kur mendova se dikush ishte ngritur dhe po ecte gjatë çastit shumë të qetë dhe të rezervuar të lutjes. Kur ngrita sytë, u befasova që pashë një nga të rinjtë që kishte qenë në takimin e të rinjve një javë më parë. E dija gjithashtu se ai ishte një nga shtatë ata që kishin marrë Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë atë natë. Ai më shikoi dhe më tha: “Eja të shkojmë!» Mendova: *Eja të shkojmë? Eja të shkojmë ku?*

Çuditërisht, ai po shkëlqente ashtu si atë natë që kishte marrë Frymën e Shenjtë dhe e dija që Perëndia po bënte diçka. Por nuk isha i sigurt se ishte koha apo vendi për të bërë diçka, pasi tashmë isha në telashe me pastorin. E dija gjithashtu se nuk mund të bënim asgjë që dëshironim në shërbesën e të dielës në mëngjes. Atëherë ai tha: “Unë do të shkoj të lutem për nënën time.”

Tani po filloja të kuptoja se çfarë po ndodhte. E njihja nënën e tij. Ajo ishte një grua e imët, e dobët dhe kishte qenë e sëmurë për një kohë shumë të gjatë. Ajo kishte pesë rruaza në shtyllën kurrizore që kishin degraduar dhe shpresa e vetme e mjekut ishte t’i bashkonte ato. Ky operacion ishte shumë i rëndë dhe miku im ishte fëmija i saj i vetëm. Sigurisht, ai ishte i shqetësuar për nënën e tij.

Pasi mori Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, ai u ndje i sigurt se Jezusi do ta shëronte nënën e tij. Kështu, kur ai tha, “Eja të shkojmë», mendova se ai do të shkonte dhe do të vinte duart mbi nënën e tij dhe do të lutej për të në heshtje. Por ai nuk e bëri këtë gjë. Ai shkoi te nëna e tij, e ngriti atë menjëherë nga stoli dhe e çoi përpara kishës.

Ai e uli dhe filloi të lutej për të sa më shumë që mundej në gjuhë. Tani mos harro, e gjithë kjo ndodhi gjatë momentit “të heshtur” të meditimt, i cili nuk ishte më aq i heshtur. Unë u trondita! Pastaj ai u kthye nga unë dhe më tha: “Ti shpjego se çfarë po ndodh.”

Tani e kuptoj pse ai më kërkoi të vija. Ai mendoi se isha unë ai që i kisha thënë për Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë, kështu që mund t’i tregoja kongregacionit për këtë pasi ta dëgjonin duke u lutur në gjuhë

për nënën e tij.

Dhe unë po qëndroja përpara bashkësisë si zëdhënësi i tij dhe ai po lutej për nënën e tij në gjuhë. Vërtet nuk dija çfarë të thosha, sidomos pasi pastori im u ul aty duke më vështruar. Thjesht i thashë kongregacionit se nëna e tij kishte qenë e sëmurë dhe se ai po lutej për të në gjuhë të tjera, gjë që ishte në Bibël. Por e di çfarë? Ajo u shërua menjëherë atë mëngjes në kishë!

Ky ishte besimi i një djali, të cilit vërtet nuk i interesonte se çfarë mendonte dikush tjetër për të teksa lutej. Ai ishte i bindur se Fryma e Shenjtë ishte “shëndoshë e mirë” dhe mund ta shëronte nënën e tij.

Edhe pse ajo u shërua menjëherë, kisha nuk e pranoi atë. Në fakt, shumë prej tyre erdhën tek unë më pas dhe më thanë: “Epo, nuk e kisha problem që ai të lutej për nënën e tij, por në gjuhë, ne nuk mund ta zgjidhim atë gjë me të folurit në gjuhë.” Epo, mund të të garantoj se djalli e urren edhe çështjen e gjuhëve dhe shpresoj që, para se të përfundojë ky libër, të të ndihmoj ta kuptosh pse ai i urren gjuhët.

Ndoshta ti je rritur në një kishë ku gjuhët dhe dhuratat e Frymës nuk praktikoheshin. Ose ndoshta je rritur duke u mësuar se gjuhët nuk vlejnë për sot ose se kanë kaluar. Këto pyetje nuk janë të vështira për t’u dhënë përgjigje. Bibla është shumë e qartë rreth kësaj teme. Pra, le ta shohim mirë Fjalën dhe të zbulojmë të vërtetën mbi Pagëzimin e Frymës së Shenjtë. Le të kthehemi te vargjet që lexuam në fillim të këtij kapitulli.

*Të mos largoheshin nga Jerusalemi, por të prisnin premtimin e Atit: “Që, tha ai, e keni dëgjuar nga unë, sepse Gjoni pagëzoi me ujë, por ju do të pagëzoheni me Frymën e Shenjtë, mbas jo shumë ditësh”*

— Veprat e apostujve 1:4b-5

**“FJALËT QË PO JU THEM, NUK I THEM NGA VETJA. ATI QË QËNDRON NË MUA, ËSHTË AI QË I BËN VEPRAT.”**

—GJONI 14:10B

Ka disa pika të rëndësishme që mund të shohim në këtë varg:

1. Pagëzimi i Frymës së Shenjtë është i ndryshëm nga pagëzimi në ujë.
2. Jezusi tha se ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm. Në fakt, Ai e bëri të qartë se nuk do të mund të bëje asgjë pa të.

Mos harro, Jezusi sapo u kishte thënë dishepujve të shkonin dhe t’ia predikonin ungjillin çdo kombi, por ata nuk do të ishin në gjendje ta demonstironin ose verifikonin Mbretërinë e qiejve pa këtë pagëzim. Ndaj ai tha: “Qëndroni këtu derisa të merrni këtë fuqizim”

*Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jerusalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut..*

—Veprat e apostujve 1:8

*Fuqia!* Fjala në greqisht për *fuqi* këtu është *dunamis* dhe është ajo është fjala prej të cilës kemi marrë fjalën dinamit. Pra, ne shohim se fuqia e Perëndisë vjen mbi ne për të bërë veprat e Tij. Më herët në shërbimin e Jezusit, Ai kishte përmendur se fuqia, ose se vajosja nën të cilën po vepronte, ishte nga Ati i Tij.

*“Fjalët që po ju them, nuk i them nga vetja. Ati që qëndron në mua, është ai që i bën veprat”* (Gjoni 14:10b).

*Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes* (Gjoni 5:19).

Pra, Jezusi kishte nevojë për atë fuqizim të Frymës së Vetë Perëndisë. Fjala *vajosje* do të thotë të “aplikosh”. Jezusi e mori atë vajosje në lumin Jordan nga Ati i Tij kur Fryma e Shenjtë zbriti mbi Të në formën e një pëllumbi.

Vetëm pasi e mori atë vajosje, Jezusi që në gjendje të bënte veprat e Mbretërisë. Nëse *Jezusi* kishte nevojë për të, edhe ne kemi nevojë për të! Ajo fuqi do të dëshmojë (ose do të japë dëshmi) përmes demonstrimit se Perëndia është i vërtetë për ata që nuk e njohin Atë.

Bibla thotë gjithashtu se ti do të marrësh fuqi kur Fryma e Shenjtë të **VIJË MBI TY**, jo kur Ai të vijë *në* ty si në kohën e rilindjes.

Shumë ngatërrohen kur flasim për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, duke menduar se ata tashmë e kanë marrë Frymën e Shenjtë kur pranuan Krishtin. Dhe e vërteta është se ata e *morën* Frymën e Shenjtë kur morën Krishtin. Fryma e Shenjtë i bëri shpirtat e tyre të gjallë për Perëndinë dhe një me Perëndinë.

Ne jemi të gjallë për Perëndinë me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë brenda nesh kur lindim përsëri. Por vër re se ky shkrim i shenjtë thotë “kur Fryma e Shenjtë të vijë mbi ju”. Ky është një fakt i rëndësishëm që do ta trajtojmë më vonë në këtë libër: të lindësh përsëri dhe të vajosesh ose të pagëzohesh nga Fryma e Shenjtë janë dy ngjarje të ndryshme. Mund ta kuptojmë më mirë këtë nëse shikojmë te Gjoni 20:21-22.

*Pastaj Jezusi u tha atyre përsëri: “Paqja me ju! Sikurse më ka dërguar mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju”. Dhe, si tha këto fjalë, hukati mbi ta dhe tha: “Merrni Frymën e Shenjtë!”*

Ne e shohim Jezusin këtu pas ringjalljes së Tij, teksa Ai përshëndet dishepujt e Tij, hukat mbi ta dhe u thotë të marrin Frymën e Shenjtë. Ky është çasti që ata lindin përsëri dhe shpirtat e tyre gjallërohen te Perëndia përbrenda. Megjithatë, Jezusi u thotë atyre të presin për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, i cili do të vijë mbi ta më vonë.

Nëse ata e kishin marrë të gjithë Frymën e Shenjtë kur Jezusi hukati mbi ta, pse do t' u thoshte Ai që të prisnin në Jerusalem derisa të merrnin Frymën e Shenjtë që ishte premtuar se do të vinte mbi ta? E përsëris, këto janë dy ngjarje të ndryshme dhe dy funksione të ndryshme, por i njëjti Frymë. Gjithashtu, siç thashë, dua të theksoj se edhe Jezusi duhej të pagëzohej nga Fryma e Shenjtë që të fillonte dhe të ishte i efektshëm në shërbesën e Tij. Përpara se Jezusi të pagëzohej në Frymën e Shenjtë, nuk ka asnjë të dhënë që Ai të ketë bërë një mrekulli të vetme. A e shumëzonte Jezusi bukën në tryezën e darkës ndërsa rritej? A bëri Ai mrekulli kur ishte foshnjë? A e shumëfishoi Ai ushqimin e tij për fëmijë kur e mbaronte sepse ishte ende i uritur? Jo! Ai nuk e bëri. Pse nuk e bëri Ai? Përgjigja e thjeshtë dhe e sinqertë është: Ai *nuk mundej*.

Vetëm *pasi* mori Frymën e Shenjtë në lumin Jordan, Ai filloi të bënte mrekulli. Pra, Jezusi erdhi si njeri. Ai nuk erdhi si Biri i Perëndisë në fuqinë dhe lavdinë e Tij. Si njeri, Ai ishte i kufizuar siç është i kufizuar çdo njeri. Ai nuk mundi të shëronte apo të bënte ndonjë mrekulli, ashtu si unë dhe ti nuk mund të bëjmë asnjë mrekulli në vetvete dhe për vete.

Megjithatë, ndryshe nga ne, shpirti i Jezusit nuk ishte i vdekur për Perëndinë kur Ai lindi si foshnjë. Fryma e tij ishte gjithmonë e gjallë në Perëndinë; Ai nuk kishte nevojë të lindte përsëri si ne. Megjithatë, megjithëse fryma e Tij ishte e gjallë në Perëndinë si Bir, Ai gjithsesi duhej të pagëzohej nga Fryma e Shenjtë përpara se të fillonte shërbimin e Tij, ashtu si ne.

*Dhe Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji; dhe ja, qiejt iu hapën, dhe ai pa Frymën e Perëndisë duke zbritur si një pëllumb e duke ardhur mbi të; dhe ja një zë nga qielli që tha: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur”.*

—Mateu 3:16-17

Ki parasysh, ne e mendojmë Jezusin si Mbretin e Mbretërve dhe Zotin e Zotëve, por ky nuk është pozicioni nga i cili Ai shërbeu. Mrekullitë filluan vetëm pasi Fryma e Shenjtë erdhi mbi Të në lumin Jordan.

Shërbesa jote (për shkak se çdo besimtar është thirrur për të bërë veprat e Jezusit) nuk mund të fillojë derisa të pagëzohesh me Frymën e Shenjtë – ti ke nevojë për fuqinë e Frymës së Shenjtë për të bërë gjëra. Dhe të duhet aftësia për t’u lutur në Frymë për të ditur se si t’i bësh ato, siç do ta diskutojmë më vonë.

Sigurisht, ti mund ta ofrosh përvojën e të rilindurit duke u treguar të tjerëve se çfarë thotë Bibla për shpëtimin. Shumë të krishterë që nuk janë pagëzuar në Frymën e Shenjtë janë të efektshëm në ndarjen e lajmit të mirë të ungjillit, por nuk kanë fuqinë për ta demonstruar Mbretërinë siç bëri Jezusi. Kjo shkakton shumë predikime të dobëta.

Kur Jezusi u përball me farisenjtë në lidhje me mosbesimin e tyre, Ai iu referua mrekullive që po bënte. Ai tha

*Më besoni se unë jam në Atin dhe se Ati është në mua; në mos, më besoni për shkak të vet veprave (Gjoni 14:11).*

Në thelb, Jezusi po thoshte se ky demonstrim i Mbretërisë i jep fund çdo debati; çështja zgjidhet. E pra, sigurisht, çdo besimtar ka të drejta të plota ligjore për gjithçka që Jezusi pagoi, duke përfshirë shërimin. Çdo besimtar mund të marrë çdo premtim të Perëndisë me anë të besimit (marrëveshjes me qiellin), dhe ai nuk ka nevojë për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë për të marrë nga Perëndia.

Por që ajo fuqi të rrjedhë nga ti tek të tjerët dhe që në ty të rrjedhin dhuratat e Frymës dhe të gëzosh përfitimin e ecjes në misteret qiellore nëpërmjet lutjes në gjuhë, ti duhet të kesh fuqinë e asaj vajosjeje! E kuptoj se mund të mos e kuptosh se çfarë dua të them kur them të lutesh në gjuhë. Mos lejo që të të trembë; më vonë do ta shpjegoj plotësisht.

Vajza ime, Emi, drejton adhurimin në kishën tonë, “Faith Life Church”, në Nju Albani, Ohajo. Për disa vite, ajo kishte një gjendje shëndetësore që na shqetësonte të gjithëve: barku i saj po rritej ngadalë dhe po binte në sy. Edhe pse kishim qenë te shumë mjekë, askush nuk kishte mundur ta kuptonte pse po ndodhte kjo. Të gjithë thoshin se kjo ishte fizionomia e saj.

Epo, kjo vazhdoi derisa ajo me të vërtetë dukej sikur ishte rreth gjastë muajshe shtatzënë. Në atë kohë, Emi bëri një radiografi dhe në atë radiografi u pa qartë një masë e madhe që rritej në barkun e saj. Duke parë radiografinë, Emi e kuptoi se cili do të ishte hapi i ardhshëm mjekësor, dhe ai do të ishte operacioni. Meqë sapo ishte martuar, Emi e dinte se çdo lloj operacioni ndoshta do ta pengonte ose do ta bënte të pamundur që ajo të lindte fëmijë. Ky nuk ishte një opsion për Emin. Ajo kishte ëndërruar gjatë gjithë jetës së saj të bëhej nënë. Edhe ne mund ta shihnim në radiografi se masa e madhe i kishte zhvendosur organet e saj dhe kjo po i shkaktonte Emit probleme me tretjen, si dhe probleme serioze me veshkat. Ajo vendosi të merrej seriozisht me Fjalën e Perëndisë dhe të gjente kohë për t’u përqendruar ekskluzivisht në atë që Bibla jep mësim për shërimin. Gjatë po atyre javëve, unë isha duke dhënë mësim mbi shërimin në “Faith Life Church”. Në fund të asaj serie, Emi u kërkoi pleqve të vendosnin duart mbi të dhe të luteshin mbi të në lidhje me shërimin e saj sipas Jakobit 5:14–15, gjë që ne e bëmë.

*A është i sëmurë ndonjë nga ju? Le të thërrasë pleqtë e kishës dhe ata të lutën përmbi të, dhe le ta lyejnë me vaj në emër të Zotit, dhe lutja e besimit do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta mëkëmbë; dhe nëse ka bërë mëkate, ato do t’i falen..*

—Jakobi 5:14-15



Emi, e bindur për Fjalën e Perëndisë, e *shpalli* shërimin e saj kur ne vumë duart mbi të. Edhe pse nuk kishte asnjë manifestim fizik të shërimit të saj në momentin që u lutëm për të, ajo ishte e bindur se ishte shëruar.

Dy javë më vonë, ajo shkoi të shtrihej, ende pa asnjë provë fizike se ishte shëruar, por u zgjua në mëngjes e tronditur. Ajo kishte humbur 7 kilogramë dhe 20 cm nga beli i saj gjatë natës ndërsa flinte. Shpina e saj e përdredhur dhe me nyje tashmë ishte gjithashtu krejtësisht normale. Ajo u shërua në çast!


Këto foto tregojnë shërimin e mahnitshëm. Fotografia në të majtë është se si dukej Emi kur ra për të fjetur. Fotografia në të djathtë tregon se si dukej ajo kur u zgjua!



PËRPARA

PAS

Ti mund ta shohësh radiografinë e shpinës së saj në të majtë përpara se të shërohej dhe në të djathtë radiografinë e bërë javën pasi ajo u shërua. Vër re ndryshimin e madh në shtyllën kurrizore!



Emi ishte në atë kohë dhe ende është udhëheqësja jonë e adhurimit në “Faith Life Church”. Mund ta imagjinosh se çfarë ndodhi të dielën tjetër kur ajo shkoi në kishë—njerëzit ia ngulën sytë! Njerëzit ndaluan në sallë, të tronditur dhe thanë: “Çfarë ndodhi me ty? More një trup të ri?” E gjithë kisha ishte e tronditur atë të diel ndërsa Emi drejtonte adhurimin dhe ky demonstrim i Mbretërisë së Perëndisë solli shumë veta te Perëndia dhe shumë veta u shëruan.

Duhet ta pranosh që njerëzit kanë nevojë ta shohin Mbretërinë e Perëndisë në veprim. Te Veprat e Apostujve 1:8, ne shohim se vajosja, ky Pagëzim i Frymës së Shenjtë është jetësor

*Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jerusalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut.*

—Veprat e apostujve 1:8

Dhe për sa i përket Jezusit, ishte *thelbësore* për demonstrimin e Mbretërisë së Perëndisë.

*Dhe këto janë shenjat që do t'i përcjellin ata që do të besojnë: në emrin tim ata do t'i dëbojnë demonët, do të flasin gjuhë të reja; do t'i kapin me dorë gjarpërinjtë, edhe nëse do të pinë diçka që shkakton vdekjen, nuk do t'u bëjë asnjë të keq; do t'i vënë duart mbi të sëmurët dhe këta do të shërohen.*

—Marku 16:17-18

Kapja e gjarpërinjve me dorë dhe pirja e diçkaje vdekjeprurëse i referohet mbretërisë së Satanit dhe janë një referencë e drejtpërdrejtë e frikës. Mbretëria e Satanit është mposhtur. Jezusi nuk po sugjeron që të marrim realisht gjarpërinj të rrezikshëm ose të pimë helm, por Ai po e përdor këtë frazë si shembull të fuqisë që na është dhënë mbi armikun. Ne duhet ta marrim atë autoritet dhe fuqinë e Perëndisë në territorin e Satanit dhe t'i lirojmë njerëzit!

Vër re se Jezusi thotë se “**këto shenja**” do t'i përcjellin ata që besojnë. Ndërsa njerëzit i shohin këto *shenja* (demonstrime) të Mbretërisë, ata do të pyesin se si kanë ndodhur. Një shenjë tregon diçka. Në vetvete, nuk është përgjigja, por tregon Jezusin, i cili është përgjigja!

Këto shenja ndalojnë të gjitha debatet nëse Jezusi është apo jo Zot—AI ËSHTË! Dhe kur njerëzit të shohin se Ai është, ata do të pendohen dhe do të vijnë te Perëndia. Kjo është arsyeja pse ti dhe unë kemi nevojë për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë dhe ne nuk mund të jemi vërtet të efektshëm pa të!

Tani që kemi hedhur një themel të vogël se përse keni nevojë për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, le të shqyrtojmë shkrimet e shenjtja që i referohen kësaj vajosjeje.



## KAPITULLI 5

# PROVA E SHKRIMIT TË SHENJTË

Një nga mënyrat më të mira për të fituar një kuptueshmëri rreth Pagëzimit të Frymës së Shenjtë është të ndjekësh ata që e morën atë në Ditën e Rrëshajave, siç është regjistruar në librin e Veprave të Apostujve. Ndërsa shqyrtojmë çdo shkrim të shenjtë, besimi dhe siguria jote do të rritet se ky pagëzim është edhe për ty.

*Kur erdhi dita e Rrëshajave, ata ishin të gjithë bashkë, në një mendje të vetme, në të njëjtin vend. Dhe befaz nga qielli erdhi një ushtimë, si ajo e një ere që fryn furishëm, dhe e mbushi gjithë shtëpinë ku ata po rrinin. Dhe atyre u dukën gjuhë, si prej zjarri, të cilat ndaheshin dhe zinin vend mbi secilin prej tyre. Kështu të gjithë u mbushën me Frymën e Shenjtë dhe filluan të flasin në gjuhë të tjera, ashtu si Fryma e Shenjtë ua jepte të shpreheshin*

*Por në Jerusalem banonin disa Judenj, njerëz të perëndishëm, nga të gjitha kombet nën qiell. Kur u dëgjua ajo ushtimë, turma u mbledh dhe u hutua, sepse secili nga ata i dëgjonte të flisnin në gjuhën e vet.*

*Dhe të gjithë habiteshin dhe mrekulloheshin dhe i thoshin*

*njëri-tjetrit: “Ja, a nuk janë të gjithë Galileas këta që flasin? Si vallë secili nga ne i dëgjon të flasin në gjuhën e vet amtare? Ne Partët, Medët, Elamitët dhe banorët e Mesopotamisë, të Judesë dhe të Kapadokisë, të Pontit dhe të Azisë, të Frigjisë e të Pamfalisë, të Egjiptit dhe të pjesëve të Libisë përballë Kirenës, dhe ne të ardhur nga Roma, Judenj dhe prozelitë, Kretas dhe Arabë, i dëgjojmë të flasin për gjërat e mëdha të Perëndisë në gjuhët tona!”*

*Dhe të gjithë habiteshin dhe ishin hutuar dhe i thonin njëri-tjetrit: “Ç’do të thotë kjo?”. Kurse të tjerë i përqeshnin dhe thonin: “Janë plot me verë të ëmbël!”.*

—2:1-13

Gjëja e parë që dua të shohësh është se Bibla thotë se **të gjithë** ishin të mbushur me Frymën e Shenjtë! Së dyti, *të gjithë* folën në gjuhë. Ndoshta ke dëgjuar njerëz ta përshkruajnë ditën e Rrëshajave dhe të shpjegojnë pse ata të gjithë folën në gjuhë. Disa këmbëngulin se ishte një përvojë e njëhershme për kishën, sepse atje ishin mbledhur njerëz nga shumë kombe dhe për rrjedhojë, nevojiteshin gjuhët për t’ua predikuar ungjillin të gjithë njerëzve që flisnin gjuhë të ndryshme.

Por nëse e shikon shkrimin e shenjtë, do të shohësh që thotë se 120 veta që ishin në dhomën e sipërme po flisnin për veprat e mrekullueshme të Perëndisë. Ata nuk po predikonin ungjillin; ata thjesht lavdëronin Perëndinë.

*“I dëgjojmë të flasin për gjërat e mëdha të Perëndisë në gjuhët tona!”.*  
*Dhe të gjithë habiteshin dhe ishin hutuar dhe i thoshin njëri-tjetrit:*  
*“Ç’do të thotë kjo?”.*

—Veprat e apostujve 2:11b-12

Njerëzit që qëndronin përreth dhe i dëgjonin duke lavdëruar Perëndinë në gjuhët e tyre amtare ishin të gjithë të habitur dhe të hutuar. Pastaj Pjetri u ngrit në këmbë dhe predikoi mesazhin e shpëtimit dhe 3000 veta u shtuan në kishë atë ditë. Atëherë, nëse dishepujt do të kishin *predikuar* në gjuhë, Pjetrit nuk do t'i duhej të ngrihej në këmbë dhe të predikonte. Por para se Pjetri të ngrihej në këmbë për të predikuar, ata nuk e dinin se çfarë kuptimi kishte ajo që po dëgjonin. Gjuhët nuk u përdorën për të predikuar ungjillin në atë kohë dhe ato nuk përdoren për të predikuar ungjillin tani. Ne do t'i trajtojmë dobitë e gjuhëve për besimtarin në një kapitull të mëvonshëm, por tani për tani, unë po trajtoj vetëm një argument të zakonshëm që kam dëgjuar.

Përsëri, dua të theksoj se Bibla thotë se *të gjithë* morën dhe *të gjithë* folën në gjuhë. Pra, nëse Bibla do të na linte këtu, mund të kishim disa dyshime se të folurit në gjuhë është për të gjithë kishën. Por Bibla nuk e bën këtë. Në vend të kësaj, ne zbulojmë se ky fenomen vazhdon dhe ndodh për çdo person që merr Pagëzimin e Frymës së Shenjtë pas ditës së Rrëshajave.

Më lejo të të tregoj për një nga burrat që ishte i pranishëm në Ditën e Rrëshajave – ai quhej Filip.

*Ata, pra, që ishin shpërndarë shkonin rreth e përqark, duke shpallur fjalën. Dhe Filipi zbriti në qytetin e Samarisë dhe u predikoi atyre Krishtin. Dhe turmat, me një mendje të vetme, dëgjonin me vëmendje gjërat që thoshte Filip, duke dëgjuar dhe duke parë mrekullitë që ai bënte.*

—Veprat e apostujve 8:4-6

Këtu shohim Filipin që demonstroi Mbretërinë dhe njerëzit që dëgjojnë. Kështu duhet të jetë sot! Kur njerëzit *shohin* shenjat, kur *shohin provat* e Mbretërisë, ata do t'i kushtojnë vëmendje asaj që ti thua.

*Frymëra të ndyra, pra, dilnin nga shumë të idemonizuar, duke bërëtitur me zë të lartë; dhe shumë të paralizuar e të çalë shëroheshin. Dhe në atë qytet u bë gëzim i madh.*

—Veprat e apostujve 8:7-8

Vër re se Filipi po ecte me fuqinë që sapo kishte marrë ndërsa ishte në Jerusalem. Shenjat e ndiqnin, pasi fuqia e Perëndisë ishte e dukshme për të gjithë. Ai kishte marrë atë *dunamis* (fjala që në greqisht do të thotë *fuqi*); ai ishte tani në gjendje të ishte një dëshmitar i Mbretërisë së Perëndisë.

*Por kur apostujt dëgjuan në Jerusalem se Samaria kishte pranuar fjalën e Perëndisë, i dërguan atyre Pjetrin dhe Gjonin. Kur këta arritën, u lutën për ta, që të merrnin Frymën e Shenjtë, sepse ende nuk kishte zbritur mbi asnjë prej tyre, por ata vetëm ishin pagëzuar në emër të Zotit Jezus. Atëherë vunë duart mbi ta dhe ata morën Frymën e Shenjtë.*

—Veprat e apostujve 8:14-17

Kur apostujt në Jerusalem dëgjuan se Samaria e kishte pranuar Fjalën e Perëndisë, dërguan tek ata Pjetrin dhe Gjonin. Kur arritën, ata u lutën për ta që të merrnin Frymën e Shenjtë, sepse Fryma e Shenjtë nuk kishte zbritur ende mbi asnjë prej tyre. Megjithatë, Bibla pak më lart thotë se demonët u larguan, njerëzit u shëruan, veprat e fuqishme të Perëndisë sapo kishin ndodhur dhe njerëzit besuan në Jezusin dhe u pagëzuan në ujë. Por thotë gjithashtu se Fryma e Shenjtë nuk kishte ZBRITUR ende mbi asnjë prej tyre!

Pra, Filipi predikoi shpëtimin dhe ata e pranuan dhe e morën atë, por nuk e kishin marrë ende pagëzimin e Frymës së Shenjtë. Ata lindën përsëri, por shiko formulimin: Fryma e Shenjtë nuk kishte ZBRITUR ende mbi ASNJË PREJ TYRE. Shfaqet përsëri ai ndryshim - Fryma e Shenjtë *në* ne (si të rilindur) dhe Fryma e Shenjtë që vjen *mbi* ne me atë dhunti fuqie.



Bibla nuk thotë pse Filipi nuk u kishte predikuar atyre për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë. Ka mundësi që ai të jetë larguar nga Jerusalemi menjëherë pasi u pagëzua me Frymën e Shenjtë dhe në atë kohë nuk e dinte se ishte për të gjithë. Cilado qoftë arsyeja, ishte e qartë se njerëzit i kishin besuar ungjillit dhe ishin pagëzuar me ujë, kështu që ata kishin lindur përsëri. Por vër re se sa e rëndësishme ishte për apostujt që njerëzit në Samari të merrnin Pagëzimin e Shpirtit të Shenjtë ashtu siç e kishin marrë ata – menjëherë.

Mendimi i parë që patën nuk ishte t'u tregonin se si të visheshin. Ata nuk thanë: “Le t'u tregojmë se si të vishen me drejtësi ose kur të bëjnë shërbesë.” Ata nuk shqetësoheshin për rregullat e doktrinës. Cila ishte gjëja e parë për të cilën ata shqetësoheshin? Pagëzimi i Frymës së Shenjtë! Kështu ata bënë përpjekjen për të shkuar menjëherë atje dhe për t'u treguar këtyre njerëzve gjithçka për Pagëzimin në Frymën e Shenjtë.

Atëherë Pjetri dhe Gjoni vunë duart mbi ta dhe ata morën Frymën e Shenjtë. Pikërisht atëherë dhe aty ata morën Frymën e Shenjtë. Cilat ishin provat? Unë besoj se ishin të njëjtat si për gjithë të tjerët: lutja në gjuhë.

*Dhe Simoni, kur pa se me vënien e duarve të apostujve jepej Fryma e Shenjtë, u ofroi atyre para, duke thënë: “Ma jepni edhe mua këtë pushtet, që ai të cilit do t'i vë duart, të marrë Frymën e Shenjtë”.*

*Por Pjetri i tha: “Le të humbasë paraja jote dhe ti bashkë me të, sepse ti mendove se mund ta blesh me para dburatën e Perëndisë. Ti nuk ke as pjesë as short në këtë gjë, sepse zemra jote nuk është e drejtë përpara Perëndisë. Pendohu, pra, për këtë ligësi që ke dhe lutju Perëndisë që, po të jetë e mundur, të të falet mendimi i zemrës sate. Sepse unë të shoh se je në vrerin e hidhësisë dhe në prangat e paudhësisë”.*

*Dhe Simoni, duke u përgjigjur, tha: “Lutjuni ju Zotit për mua, që të mos më ndodhë asgjë nga ato që thatë”*

—Veprat e apostujve 8:18-24

Kur Simoni pa që Fryma u jepej me vënien e duarve, u ofroi apostujve para për t’i dhënë atij atë lloj pushteti. Simoni duhet të ketë parë diçka, disa dëshmi se diçka ka ndodhur kur ata morën Frymën e Shenjtë. Ai e donte atë pushtet.

Pra, nuk thotë se ata folën në gjuhë pikërisht atje, por diçka ndodhi në mënyrë të dukshme që ata mund ta shihnin. Simoni pa diçka që ishte e fuqishme dhe donte të kishte aftësinë për t’ua dhënë atë njerëzve. Unë besoj se komentet e tij tregojnë se ata e morën atë pagëzim ashtu si gjithë të tjerët dhe filluan të flasin në gjuhë. Përsëri, dua të theksoj se sa i rëndësishëm ishte për kishën në Jerusalem Pagëzimi i Frymës së Shenjtë—ishte jetik!

Kur Pali u kthye në besim në rrugën për në Damask, një burrë me emrin Anania u dërgua te Pali për t’u lutur për të.

*Anania ... tha: “Vëlla Saul, Zoti Jezus, që të është shfaqur në rrugën nëpër të cilën ti po vije, më ka dërguar që të kesh përsëri dritën e syve dhe të mbushesh me Frymën e Shenjtë”.*

—Veprat e apostujve 9:17b

Bibla nuk thotë se Pali foli në gjuhë të huaja kur mori Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, por ne e dimë se ai foli në gjuhë dhe unë besoj se ai e mori atë ashtu si gjithë të tjerët. Ti mund të pyesësh se pse do ta besoja këtë. Kjo është e lehtë. Është për shkak të asaj që vetë Pali shkroi te 1 Korintasve 14:18.

*Unë e falënderoj Perëndinë time, sepse flas më shumë në gjuhë se ju të gjithë (1 Korintasve 14:18).*

Pra, mund të arrijmë në përfundimin se Pali foli në gjuhë kur u pagëzua në Frymën e Shenjtë. Ndërsa lexon nëpër kapitujt e Veprave të Apostujve, do të zbulosh se ky pagëzim vazhdoi ditë pas dite në të gjithë kishën. Kjo nuk ndodhi vetëm në Ditën e Rrëshajave.

Më vonë, në Veprat e Apostujve 10, Pjetri dërgohet në shtëpinë e johebrenjve dhe udhëhiqet t'u predikojë ungjillin atyre. Ki parasysh, ishte shumë e pazakontë për Pjetrin, i cili ishte jude, të shkonte në shtëpinë e një johebriu. Ai shkoi vetëm sepse po e çonte atje një vegim nga Fryma e Shenjtë.

*Ndërsa Pjetri ende po i thoshte këto fjalë, Fryma e Shenjtë zbriti mbi të gjithë ata që po e dëgjonin fjalën. Dhe të gjithë besimtarët që ishin të rrethprerë, të cilët kishin ardhur me Pjetrin, u mrekulluan që dhurata e Frymës së Shenjtë u shpërnda edhe mbi johebrenjtë, sepse i dëgjonin duke folur gjuhë të tjera dhe duke madhëruar Perëndinë..*

*Atëherë Pjetri filloi të thotë: “A mund ta ndalojë dikush ujin, që të mos pagëzohen këta që kanë marrë Frymën e Shenjtë pikërisht si ne?”. Kështu ai urdhëroi që ata të pagëzoheshin në emër të Zotit Jezus. Ata pastaj iu lutën të qëndronte disa ditë me ta.*

—Veprat e apostujve 10:44-48

Ndërsa Pjetri po predikonte ungjillin e Krishtit në këtë shtëpi johebreje, Fryma e Shenjtë erdhi mbi të gjithë ata që e dëgjuan mesazhin. Fryma e Perëndisë nuk shihet, pra nga e dinin ata se Fryma e Shenjtë erdhi mbi ta? Teksti thotë se besimtarët e rrethprerë që kishin ardhur me Pjetrin u habitën që dhurata e Frymës së Shenjtë ishte derdhur edhe mbi johebrenjtë, sepse ata i dëgjuan duke folur në gjuhë dhe duke madhëruar Perëndinë.

Pra, cila ishte prova që Fryma e Shenjtë ishte atje? Pjetri duhej ta pranonte atë që ishte e dukshme për të, se Perëndia i kishte pranuar

këta njerëz. Fakti që ai i pa ata të flisnin në gjuhë kur nuk u kishte folur kurrë atyre për Pagëzimin e Frymës së Shenjtë, ishte e gjithë prova që i nevojitej. Pjetri e *kuptoi* se ata kishin marrë sepse morën Frymën e Shenjtë ashtu si ai – dhe ata po luteshin në gjuhë të tjera.

Do të vëresh një ndryshim të madh midis asaj që kisha bashkëkohore mendon se është e rëndësishme dhe asaj që kisha në kohët biblike mendonte se ishte e rëndësishme. Një nga shkrimet e mia të shenjta të parapëlqyera që thekson kaq qartë se të gjithë duhet të pagëzohen në Frymën e Shenjtë dhe që vërteton pa diskutim se është një vepër e Frymës së Shenjtë, përveç rilindjes, gjendet në Veprat e Apostujve 19:1-2.

*Dhe ndërsa Apollo ishte ende në Korint, Pali, mbasi shkoi në vendet më të larta, arriti në Efes dhe, si gjeti disa dishepuj, u tha atyre: “A e keni marrë Frymën e Shenjtë, kur besuat?”. Ata iu përgjigjën: “Ne as që kemi dëgjuar se paska Frymë të Shenjtë”.*

—Veprat e Apostujve 19:1-2

Kur Pali hyri në qytetin e Efesit, gjeti disa dishepuj dhe i pyeti ata: “A e morët Frymën e Shenjtë kur besuat?” Ky ishte shqetësimi i parë që pati Pali kur u ndesh me këta besimtarë.

Pali kuptoi se rilindja ishte dukshëm e ndryshme nga pagëzimi me Frymën e Shenjtë me dëshminë e të folurit në gjuhë.

Pse do të ishte kjo gjëja e parë që Pali u tha atyre? Sepse ishte e njëjta gjë që tha Jezusi te Veprat e Apostujve 1:4! Ai në thelb tha: “Mos u largoni nga qyteti pa të!” Çfarë bënë apostujt në Jerusalem kur morën vesh se njerëzit në Samari e kishin dëgjuar Fjalën? Ata thanë: “Djema, shkoni atje tani. Ne duhet të sigurohemi që kjo të bëhet siç duhet. Shkoni atje dhe sigurohuni që ata të kenë Pagëzimin e Frymës së Shenjtë.” Kur Pali, duke kaluar nëpër Efes, gjeti disa dishepuj, gjëja e

parë që ai i pyeti ishte: “A e keni marrë Frymën e Shenjtë kur besuat?”

Kur ata u përgjigjën: “Jo, as që kemi dëgjuar se paska Frymë të Shenjtë”, Pali i pyeti se çfarë pagëzimi kishin marrë. Ata u përgjigjën: “Pagëzimin e Gjonit”. Pali tha se pagëzimi i Gjonit ishte një pagëzim pendimi dhe u tha njerëzve të besonin në Atë që do të vinte pas tij. Kjo do të thotë, besoni në Jezusin.

Me të dëgjuar këtë, ata u pagëzuan në emrin e Zotit Jezus (u pagëzuan me ujë). Më pas, kur Pali vuri duart mbi ta, Fryma e Shenjtë zbriti mbi ta dhe ata folën në gjuhë të tjera. Vini re kur Pali bëri pyetjen, ai supozoi se ata ishin besimtarë në Jezusin. Për këtë arsye ai i pyeti: “A e keni marrë Frymën e Shenjtë kur besuat?” Ai e kuptoi se Pagëzimi i Frymës së Shenjtë ishte mjaft i ndryshëm nga rilindja.

Pra, besoj se kjo është një temë e diskutueshme në shumë kisha, jo sepse nuk është në Bibël, por sepse djalli e urren kaq shumë.

Sepse nëse kjo është fuqia, nëse kjo është porta drejt aftësisë për të ndryshuar jetë dhe për të qenë dëshmitar në botë, atëherë ti do të dilje kundër zotit të kësaj bote dhe ne e dimë se cili do të ishte mendimi i tij për këtë. Pagëzimi i Frymës së Shenjtë na jep një rezervuar fuqie, fuqinë e Perëndisë, për të bërë veprat e Jezusit në mënyrë që Perëndia të përlevdohet!

**PRA, BESOJ SE KJO  
ËSHTË NJË TEMË E  
DISKUTUESHME NË  
SHUMË KISHA, JO  
SEPSE NUK ËSHTË  
NË BIBËL, POR SEPSE  
DJALLI E URREN KAQ  
SHUMË.**



## KAPITULLI 6

# A LUTEN TË GJITHË NË GJUHË?

Mbase ke dëgjuar dikë të thotë se nuk flet në gjuhë dhe nuk beson se të gjithë mund ose duhet të flasin. Ai më pas citon 1 Korintasve 12:27-30 si arsyen që e beson këtë. Ai do të vërë në dukje se vetë Pali tha se jo të gjithë flasin në gjuhë. Epo, le t'i hedhim një sy tekstit dhe të shohim nëse kjo është me të vërtetë ajo që po thotë Pali.

*Dhe ju jeni trupi i Krishti dhe gjymtyrët e tij, veç e veç. Dhe Perëndia i vuri disa në kishë, së pari apostuj, së dyti profetë, së treti mësues; pastaj vepra të fuqishme; pastaj dhuntitë e shërimit, të ndihmës e të qeverisjes dhe të larmive të gjuhëve. A janë vallë të gjithë apostuj? Janë të gjithë profetë? Janë të gjithë mësues? A kanë të gjithë dhuntinë e veprave të fuqishme? A kanë të gjithë dhuntitë e shërimeve? A flasin të gjithë gjuhë të ndryshme? A interpretojnë të gjithë?*

—1 Korintasve 12:27-30

Në këtë letër, Pali po i thotë kishës në Korint se si të veprojnë në mënyrë të rregullt, në mënyrë që të gjithëve të mund t'u shërbehet në mbledhjet e tyre të kishës. Në atë kohë, ata të gjithë përpiqeshin t'ia kalonin njëri-tjetrit me dhuratat e tyre shpirtërore dhe predikuesit e tyre

të preferuar. Pali po i udhëzonte se si të vepronin si një trup në unitet dhe dashuri. Tani le të shohim më nga afër 1 Korintasve 12:27-28:

*Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e tij, veç e veç. Dhe Perëndia i vuri disa në kishë [rekomandoj ta nënvizosh atë frazë], së pari apostuj, së dyti profetë, së treti mësues; pastaj vepra të fuqishme; pastaj dhuntitë e shërimit, të ndihmës e të qeverisjes dhe të larmive të gjuhëve.*

Pali vazhdon më tutje, por unë do të ndalem sepse dua të flas pak për atë frazë: “në kishë”. Ai po flet për asamblenë aktuale të kishës. Ne mund ta verifikojmë këtë tek 1 Korintasve 14:18-19 ku Pali përdor të njëjtën frazë:

*Unë e falënderoj Perëndinë time, sepse flas më shumë në gjuhë se ju të gjithë. Por NË ASAMBLE parapëlqej të them pesë fjalë me mençurinë time për mësimin e të tjerëve se dhjetë mijë fjalë në gjuhë tjetër..*

—1 Korintasve 14:18-19

Pali thotë: “Falënderoj Perëndinë që flas në gjuhë më shumë se të gjithë ju, “**por në kishë**...”. Është përsëri ajo frazë dhe këtë herë është e qartë se Pali po flet për asamblenë aktuale të kishës dhe jo për trupin universal të Krishtit. Të gjithë do të binim dakord se Pali është pjesë e të gjithë trupit të Krishtit, “kishës”. Sigurisht që ai është. Dhe ai thotë se është i kënaqur që flet në gjuhë më shumë se të gjithë besimtarët në Korint. Ai e tha këtë sepse kisha atje ngazëllente në aftësinë e re për të folur në gjuhë, dhe ata e kishin humbur kontrollin dhe shkaktonin ngatërresë.

Ai në thelb thotë: “Ej djema, unë flas në gjuhë më shumë se të gjithë ju, por ka një mënyrë për ta kryer këtë “në kishë” në mënyrë të rregullt dhe që nuk shkakton ngatërresë.” Ai vazhdon duke thënë se,



në kishë (asambleja e besimtarëve), ai parapëlqente të fliste në mënyrë të kuptueshme (në gjuhën e tyre të përbashkët) në mënyrë që të tjerët të ndërtohen.

Në vetë shërbesën e kishës, disa njerëz do të veprojnë në dhuntinë e gjuhëve dhe interpretimit, siç shënohet te 1 Korintasve 12, por jo të gjithë do ta përdorin ose nuk duhet ta përdorin atë dhuratë për qëllimin e ndërtimit të gjithë trupit. Pali madje thotë që të kufizohet numri i njerëzve që duhet të flasin në gjuhë dhe të interpretojnë në një shërbesë në maksimumi tre persona.

*Nëse ndonjë flet në gjuhë tjetër, le të bëhet kjo nga dy a më të shumtën tre vetë dhe njeri pas tjetrit, dhe një le të interpretojë (1 Korintasve 14:27)*

Pra, kur Pali thotë se jo të gjithë flasin në gjuhë, ai e ka fjalën për “në kishë” ose në asamblenë e kishës.

Ti duhet të kuptosh se çdo besimtar do të ketë aftësinë për t’u lutur në gjuhë, por jo të gjithë do ta kenë vajosjen për të vepruar në dhuratën e gjuhëve dhe interpretimit në një shërbesë kishtare. Nëse e ke dëshirën për ta marrë atë dhuratë në një shërbesë, Bibla thotë që duhet të lutesh që të mund ta interpretosh

*Prandaj ai që flet një gjuhë tjetër, le të lutet që të mund ta interpretojë (1 Korintasve 14:13b).*

Unë besoj se personi që flet në gjuhë është kandidati më i mundshëm për të interpretuar në atë shërbesë, sepse mesazhi tashmë po vjen përmes tij.

Pse duhet të lutesh në gjuhë? Djalli i urren besimtarët që dinë të luten në Frymë (në gjuhë) dhe dua të jem i sigurt se ti e kupton arsyen përse.

Kur Pali tha se ishte i lumtur që lutej në gjuhë më shumë se kushdo tjetër, duhet të ketë një arsye që ai u ndje kështu. Pali bëri një koment te 1 Korintasve 14 që duhet ta lexojmë.

*Ai që flet një gjuhë tjetër **ndërton** veten e tij, por ai që profetizon, **ndërton** kishën* (1 Korintasve 14:4).

Le të gërmojmë pak më thellë. Çfarë do të thotë të jesh i ndërtuar? Fjala ndërtoj do të thotë “të udhëzosh ose të përfitosh, veçanërisht moralisht ose shpirtërisht; të lartësosh.”<sup>22</sup>

Duhet ta pranosh se ka shumë raste kur ke nevojë për udhëzim për të ditur se në cilën rrugë të kalosh, për të kuptuar një situatë ose për të marrë vendimin e duhur. Për këtë mund të të ndihmojë lutja në gjuhë: për të të ndërtuar dhe udhëzuar në jetën tënde. Pali e bën të qartë këtë pikë te Romakëve 8:26-27:

*Kështu, pra, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona, sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet; por vetë Fryma ndërhyr për ne me psherëtima të patregueshme. Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyr për shenjtorët, sipas Perëndisë.*

**“KËSHTU, PRA, EDHE FRYMA NA NDIHMON NË DOBËSITË TONA, SEPSE NE NUK DIMË ÇFARË TË KËRKOJMË NË LUTJET TONA.”**

—ROMAKËVE 8:26A

Pali na thotë se kemi një problem dhe një dobësi: “Nuk dimë për çfarë të lutemi”. Ti mund të pyesësh: “Pse është kjo një dobësi?” Ne mund ta kuptojmë pse kjo është një dobësi duke lexuar 1 Gjoni 5:14-15.

*Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson: Dhe nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij.*

Pa e ditur ose pa qenë të sigurt për vullnetin e Perëndisë, ne nuk mund të veprojmë me besim (në marrëveshje me Perëndinë), dhe nëse nuk mund të veprojmë me besim, atëherë sigurisht që jemi në një gjendje të dobët, sepse nuk do të jemi në gjendje të shfrytëzojmë hirin

ose fuqinë e Perëndisë në mungesë të besimit. Pra, Pali thotë se të mos dish të lutesh është një gjendje e dobët që mund ta rregullojë lutja në gjuhë. Le ta lexojmë edhe një herë tekstin tonë.

*Kështu, pra, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona, sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona.*

—Romakëve 8:26a

Dobësia jonë është se nuk dimë si të lutemi! Bibla nuk na thotë me kë të martohemi, ku të jetojmë ose çfarë pune të pranojmë. Pa e ditur vullnetin e Perëndisë, ne nuk mund ta dimë dhe të besojmë se marrim nga Perëndia kur lutemi. Përsëri, kjo është një dobësi e madhe! Ne nuk kemi besim te Perëndia kur nuk e dimë se cili është vullneti i Tij. Por ka një mënyrë që ne mund ta dallojmë vullnetin e Perëndisë në çdo situatë në jetë. Ka një mënyrë që ne mund të jemi të sigurt për vullnetin e Perëndisë, në mënyrë që të mund të veprojmë me besim dhe siguri.

Për këtë po flet Pali. Ky ndërtim për të cilin ai flet do të thotë të kesh qasje në këtë lloj njohurie - njohuria që vjen nga Fryma e Perëndisë. Ne mund të arrijmë ta dëgjojmë Frymën duke u lutur në Frymë ose në gjuhë. Nëse e ndjekim më tej këshillën e Palit te Romakëve 8:26b-27, lexojmë sa vijon:

*Por vetë Fryma ndërhyr për ne me psherëtima të patregueshme. Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyr për shenjtorët, sipas Perëndisë.*

Por Pali nuk po thotë se ne psherëtimë kur lutemi në Frymë, por, përkundrazi, Pali po i referohet vargjeve të mëparshme.

*Sepse e dimë se deri tani mbarë bota e krijuar rënkon dhe është në mundim. Dhe jo vetëm kaq, por edhe ne vetë që kemi frytet e para të Frymës, vajtojmë në veten tonë, duke pritur*

*flakët birërimin, shpengimin e trupit tonë. Sepse me shpresë ne shpëtuam; por shpresa që duket nuk është shpresë, sepse atë që dikush e sheh si mundet edhe ta shpresojë? Por në qoftë se ne shpresojmë atë që s'e shohim, atë gjë e presim me durim.*

*Kështu, pra, edhe Fryma na ndihmon në dobësitë tona, sepse ne nuk dimë çfarë të kërkojmë në lutjet tona, sikurse duhet; por vetë Fryma ndërhyr për ne me psherëtimë të patregueshme. Dhe ai që heton zemrat e di cila është mendja e Frymës, sepse ai ndërhyr për shenjtoret, sipas Perëndisë*

—Romakëve 8:22-27

Pali po përdor fjalën “psherëtimë” këtu si një ilustrim ose një analogji të asaj që po ndodh brenda nesh. Ne psherëtimë përbrenda, si një grua që po lind. Kjo do të thotë, ne po lindim diçka nga Fryma e Perëndisë brenda nesh, duke marrë diçka të re, diçka që nuk ka ekzistuar kurrë më parë; ose mund të thuash diçka jo nga vetja. Pra, ne “lindim” njohurinë e asaj që nuk dimë, diçka të re, nga vetë shpirtat tanë nëpërmjet procesit të lutjes në Frymë. Bibla na thotë se Fryma e Perëndisë lutet për vullnetin e përsosur të Perëndisë për çdo situatë nëpërmjet vetë shpirtave tanë. Ajo thotë se Vetë Perëndia lutet për ne, nëpërmjet shpirtave tanë njerëzorë, me rënkime që nuk mund të shqiptohen (të artikulojnë në gjuhë të kuptueshme).

Pra, ajo që zbulojmë këtu është se Fryma e Shenjtë do të ndërmeretësojë për ne me psherëtimë (si të lindjes) duke përdorur fjalë të paartikuluara, fjalë (ose gjuhë) që nuk i kuptojmë. Dhe ai që heton zemrat tona e njeh mendjen e Frymës, sepse Fryma (Fryma e Perëndisë) ndërmeretëson për shenjtoret në përputhje me vullnetin e përsosur të Perëndisë. Fryma e Perëndisë lutet për vullnetin e përsosur të Perëndisë për çdo situatë **nëpërmjet shpirtit tënd kur lutesh në gjuhë.**

Pra, ne jemi në një pozitë të dobët kur nuk e njohim vullnetin e

Perëndisë. Besimi nuk mund të çlirohet derisa të njohim vullnetin e Perëndisë. Pali po thotë se nëse do të lutemi në Frymë, vetë Fryma e Perëndisë do të lutet nëpërmjet nesh për vullnetin e Tij të përsosur për jetën tonë në çdo situatë.

Ndërsa Fryma e Perëndisë lutet nëpërmjet nesh në gjuhë, si ndërtohem, pra, meqë nuk e dimë se çfarë po themi? Përgjigja gjendet në një letër tjetër që shkroi Pali.

*Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë. Po Perëndia na i ka zbuluar me anë të Frymës së tij.*

*Sepse Fryma heton çdo gjë, edhe të thellat e Perëndisë. Sepse cili nga njerëzit, pra, njih gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të? Po kështu asnjëri s'i njih gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë. Dhe ne nuk kemi marrë frymën e botës, por Frymën që vjen nga Perëndia, që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia. Për këto edhe flasim, por jo me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shenjtë, duke i krahasuar gjërat frymërore me fjalë frymërore*

—1 Korintasve 2:9b-13

Pikë së pari, Pali po thotë se ne kemi qasje në gjërat që nuk i kemi dëgjuar, parë ose menduar kurrë, ashtu siç të kam treguar. Por ai vazhdon dhe na tregon se si funksionon kjo.

*Sepse cili nga njerëzit, pra, njih gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të? Po kështu asnjëri s'i njih gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë*

—1 Korintasve 2:11

Përpara se të trajtoj këtë aspekt të Shkrimit, së pari duhet të kemi një mësim bazë lidhur me mënyrën se si jemi të ndërtuar. Sipas 1 Thesalonikasve 5:23, ne jemi tri pjesë: fryma, shpirti dhe trupi.

*Dhe Perëndia i paqes ju shenjtëroftë ai vetë tërësisht; dhe gjithë fryma juaj, shpirt e trup, të ruhet pa të metë për ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht*

— 1 Thesalonikasve 5:23

Fryma jonë është pjesa jonë nga Perëndia; shpirti ynë është mendja, vullneti dhe emocionet tona; dhe trupi ynë është trupi ynë. Pali po thotë se shpirti ynë (mendja, vullneti dhe emocionet) dhe fryma janë të lidhur aq ngushtë, sa që fryma jonë e di se cilat janë mendimet tona.

E kundërta është gjithashtu e vërtetë. Mendja jonë mund të perceptojë mendime nga fryma jonë. Pali thotë se Fryma e Perëndisë i njeh mendimet e Perëndisë dhe se ne kemi marrë Frymën e Perëndisë në mënyrë që të **mund të dimë** atë që Perëndia na ka dhënë falas.

*Dhe ne nuk kemi marrë frymën e botës, por Frymën që vjen nga Perëndia, që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia. Për këto edhe flasim, por jo me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shenjtë, duke i krabasuar gjërat frymërore me fjalë frymërore.*

—1 Korintasve 2:12-13

Pali vazhdon duke thënë se kjo njohuri e panjohur, njohuri që ne nuk e dinim, por na është zbuluar nga Fryma e Perëndisë, është ajo që ne e shprehim me fjalë që na mësohen nga Fryma, jo fjalë që do t'i thoshim në gjuhën apo kuptueshmërinë tonë natyrore, por fjalë shpirtërore. Ne e dimë se Pali po flet për lutje në gjuhë kur thotë se lutemi me fjalë shpirtërore, sepse ai përdori të njëjtin përkufizim për të përshkruar të folurit në gjuhë te 1 Korintasve 14:14-15:

*Sepse, në qoftë se unë lutem në një gjuhë tjetër, fryma im lutet, por mendja ime është e pafrytshme. Po atëherë? Do të lutem me frymën, por do ta bëj edhe me mendjen; do të këndoj me frymën, por do të këndoj edhe me mendjen.*

Pali po përdor frazën “lutu në frymë” ndërsa i referohet të folurit në gjuhë. Mund të supozojmë se Pali i referohet të njëjtës të folur në gjuhë kur thotë se ne flasim me fjalë të mësuara nga Fryma.

*Sepse ai që flet një gjuhë tjetër nuk u flet njerëzve, por Perëndisë; sepse askush nuk e kupton, por ai në frymë flet mistere.*

—1Korintasve 14:2

Përsëri, Pali flet për frymën tonë se ka aftësinë për të shprehur gjëra që nuk i kemi parë, dëgjuar ose ditur kurrë, ose siç thotë Pali, “mistere”. Gjithashtu, vër re se në këtë varg Pali thotë se ne po flasim mistere në frymën tonë, jo në Frymën e Perëndisë. Si hyn në frymën tonë diçka që nuk e dinim? Kjo është e lehtë! Nga Fryma e Perëndisë, i cili tani është një me frymën tonë.

*Sepse cili nga njerëzit, pra, njih gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të? Po kështu asnjëri s'i njih gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë*

—1 Korintasve 2:11

Kur fryma jonë percepton mendimet e Perëndisë, edhe mendja jonë i percepton këto mendime. Kur mendjet tona i perceptojnë mendimet e Perëndisë, ne e quajmë këtë “zbulesë”, të qenit “të ndriçuar” ose, siç thotë Pali, “të ndërtuar”. Tani e kuptove pse Pali tha se ishte i lumtur që lutej në gjuhë më shumë se kushdo tjetër; ai mori përfitimin e njohjes së vullnetit të Perëndisë në çdo situatë.

Kjo është ajo së cilës Pali i referohet te 1 Korintasve 2:15-16.

**PAGËZIMI I FRYMËS  
SË SHENJTË ËSHTË  
ARMA E FSHEHTË E  
PERËNDISË! AI MUND  
TA SHKARKOJË  
VULLNETIN E TIJ NË  
TOKË PA E DITUR  
DJALLI SE ÇFARË PO  
NDODH.**

*Por njeriu që është frymëror gjykon çdo gjë dhe vetë nuk është i gjykuar nga asnjëri. Sepse kush e ka njohur mendjen e Zotit që mund të mësojë atë? Por ne kemi mendjen e Krishtit.*

Ne nuk jemi të kufizuar në gjykimin e thjeshtë njerëzor, por mund t'i gjykojmë të gjitha gjërat me ndihmën e Perëndisë. Ky është një lajm i mrekullueshëm! Ne kemi aftësinë, duke u lutur në Frymë (gjuhë), të marrim mistere, gjëra që nuk i dinim; dhe me këtë njohuri, ne jemi në gjendje të japim gjykime ose vendime të drejta për të gjitha gjërat!

Pagëzimi i Frymës së Shenjtë është arma e fshehtë e Perëndisë! Ai mund ta shkarkojë vullnetin e Tij në tokë pa e ditur djalli se çfarë po ndodh. Në fakt, lutja në Frymë renditet si pjesë e armaturës sonë shpirtërore tek Efesianëve 6:18a.

*Duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje dhe përgjërimit në Frymën.*

Lutja në Frymë na lejon të kuptojmë strategji që do të na lejojnë të anashkalojmë armikun ose të përparojmë me taktika unike dhe të pazakonta.

Përfitimi i nënkuptuar është se ne mund të marrim vendime të drejta në jetë duke prekur mendjen e Krishtit. Unë mendoj se ti duhet të biesh dakord se kjo është jetike! Unë e kam zbuluar se është kështu!

Si shembull, më kujtohet se duhej të merrja një vendim të madh në lidhje me biznesin tim. Një përfaqësues shitjesh me të cilin punoja, i cili përfaqësonte një nga shitësit e mi, po kërcënonte se do ta çonte kompaninë time në gjykatë sepse nuk po e ndiqja në një kompani të re. Ai donte që unë të vazhdoja të bëja biznes me të edhe kur e la



klientin me të cilin bëja gjithmonë biznes. Më pëlqente përfaqësuesi im i shitjeve, por ndjeva se besnikëria ime i takonte kompanisë për të cilën punonte, jo atij. Megjithatë, kompania për të cilën ai punonte, në fakt i kishte thënë se të gjithë klientët e tij mund të transferoheshin me të në kompaninë e tij të re. Kështu që nuk do të bëja asgjë të keqe të shkoja me të, por megjithatë nuk u ndjeva mirë që isha i detyruar të shkoja me të. Kompania e tij aktuale ka qenë gjithmonë korrekte me mua.

Ai po më kërcënonte se do të më padiste sepse disa muaj më parë kishte përmendur vajtjen me një kompani të re dhe më kishte pyetur nëse do të shkoja me të. Pa e menduar mirë, kisha thënë se do ta bëja. Ai tha se parashikonte të mbështetej në biznesin tim kur mori vendimin për të ndryshuar kompaninë. Por tani, ndërsa ai në fakt i afrohej datës që do të largohej, pata një ndjenjë shqetësimi lidhur me këtë. Kështu u luta në Frymë për disa ditë. Por ende nuk e dëgjoja përgjigjen që më duhej.

Drenda dhe unë i çojmë shpesh fëmijët tanë në një park të madh argëtimi që është disa orë larg, i quajtur “Cedar Point”. Është në fakt parku më i madh me tren fluturues në Shtetet e Bashkuara dhe ne zakonisht shkojmë atje disa herë në vit. Ishte një e premte mbrëma dhe më duhej ta kisha gati përgjigjen deri të hënën në mëngjes lidhur me atë që do të bëja. Vendosa se do të ishte mirë që ta humbja pak mendjen me diçka tjetër dhe vendosa ta çoj Drendën te parku argëtues atë mbrëmje. Ndërsa prisja në radhë, as që më shkonte ndër mend vendimi që duhej ta merrja deri të hënën në mëngjes; krejt papritur, e kuptova saktësisht se çfarë të bëja. Ishte e lehtë për t’u kuptuar. Fryma e Shenjtë më foli dhe unë qëndrova me kompaninë mëmë. Kompania e re e përfaqësuesit të shitjeve falimentoj brenda pak muajsh.

Pra, këtu është një çelës kryesor i suksesit - lutu! Dhe lutu në Frymë shpesh, në mënyrë që gjithçka të shkojë mirë për ty dhe të marrësh vendime të drejta, si dhe të kuptosh misteret e strategjisë që të nevojitet për të fituar .

*“Lutuni pa pushim.”* (1 Thesalonikasve 5:17)



## KAPITULLI 7

# SËNDUKU I THESARIT

Më kujtohet dita kur e takova Danin për herë të parë. Ai qëndronte në këmbë në fund të kishës, në rreshtin e fundit, me kushërirën time Xheniferin. Më vonë mora vesh se ata po dilnin bashkë. Megjithatë, mund të kuptoja nga fytyra e Danit se ai vend nuk i përkiste. Në fakt, ai dukej në siklet të madh. Më vonë kuptova se kisha jonë ishte pak më ndryshe nga kisha denominacionale që ai e frekuentonte. Por, ndërsa filloi të dëgjonte për Mbretërinë, nisi të qetësohej dhe, më në fund, u martua me kushërirën time.

Në atë kohë, Dani kultivonte rreth 566 hektarë në Ohajon Qendrore dhe puna nuk po shkonte mirë. Në fakt, ai nuk po fitonte dhe ishte shumë i shqetësuar. Por, ndërsa dëgjonte vazhdimisht për Mbretërinë dhe se si Fryma e Shenjtë mund të ndihmojë, ai erdhi te Xheniferi një ditë dhe i tha: “Dua të dyfishoj ofertën tonë”. Xheniferi u trondit, por u emocionua shumë. Dhe ata e bënë këtë gjë.

Atë vit, rendimenti i tyre për po ato 566 hektarë ishte 128% më i lartë se një vit më parë. Në fakt, ishte shumë më i lartë, sa që ata ishin në gjendje të paguanin me para në dorë për një makinë të re dhe të blinin, me para, një fermë tjetër, që do të thoshte më shumë sipërfaqe për të mbjellë vitin e ardhshëm. Dani ishte shumë i emocionuar! Ai tha se babait të tij do t'i ishin dashur 10 vjet për ta paguar atë fermë të re dhe ai sapo kishte paguar me para në dorë për të. Kështu që e pyeta Danin se si ndodhi kjo dhe të më tregonte historinë.

Me sa duket, pasi Dani dhe Xheniferi filluan ta dyfishonin ofertën e tyre, ata gjithashtu i luteshin dhe i kërkonin Perëndisë t'u tregonte se çfarë të bënin. Dani tha se një ditë, teksa po kontrollonte tufën e zakonshme të letrave që merrte çdo ditë me postën, në shumicën e të cilave kishte reklama marketingu për fermerët, sapo kishte hedhur në koshin e plehrave një kartë pesë me dhjetë centimetra të vogël kur ndjeu vajosjen për ta nxjerrë atë nga plehrat. Karta e vogël nuk kishte asgjë të veçantë, një tjetër reklamë për një lloj pajisjeje për ferma. Ishte një ftesë për fermerët në një takim për të diskutuar për pajisjen.

Dani ndjeu një nxitje të çuditshme për të shkuar dhe, pasi shkoi në mbledhje, e bleu pajisjen që ishte reklamuar. Mjeti ishte një produkt i ri në treg, i cili ishte një mjet që ndihmonte në mbjelljen, diçka që kishte të bënte me hedhjen e farës dhe përgatitjen e tokës. Dani u përpoq të më shpjegonte arsyet shkencore përse ishte efektive në rritjen e rendimentit të të korrave, por e humba fillin aty nga gjysma e shpjegimit të tij. Por ai për vete e kuptonte dhe kjo ishte e rëndësishme. Dani më tha se ai ishte fermeri i dytë që e bleu mjetin në Ohajo në atë kohë. Epo, ai mjet i vogël e bëri punën dhe rezultati ishte një rritje e rendimentit prej 128%. Dani vazhdoi të blejë më shumë tokë dhe sot, ai mbjell mijëra hektarë. Tanimë ai ka shumë histori se si Fryma e Shenjtë e ndihmoi të merrte vendime që e shtynë përpara më shpejt sesa mund ta imagjinonte ndonjëherë.

Pra, si e shndërroi Dani fermën e tij me rendiment të dobët në një fermë që po sillte një fitim të madh? Ai ndoqi këshillën e Këshilltarit të tij, të Frymës së Shenjtë. Gjëja e trishtueshme është se shumica e të krishterëve e dëgjojnë atë histori dhe nuk e kanë idenë se si ndodhi, prandaj e ndjeva se ishte kaq e rëndësishme ta shkruaja këtë libër. Jo, shumica e të krishterëve festojnë se sa i madh është Perëndia, e pranojnë se e ka bërë Perëndia, por nuk kanë asnjë ide se si ta kopjojnë atë. Dhe si përfundim kemi një grup të krishterësh të zhgënjyer me Perëndinë dhe që e fajësojnë Perëndinë për problemet e tyre. “Ku është Perëndia?

Nuk e di pse Perëndia nuk më ka ndihmuar”, janë shprehjet që i dëgjoj shpesh.

Shpresoj ta kesh kuptuar tashmë, por Mbretëria funksionon me ligje, jo me favore. Perëndia nuk zgjedh kë do të bekojë dhe nuk zgjedh atë që nuk do të bekojë. Dani nuk është një nga të zgjedhurit e Perëndisë dhe nuk është më i veçantë për Perëndinë se ti. Ti ke të njëjtat të drejta ligjore si Dani në Mbretëri. Ashtu si çdokush ka të drejtë të mbjellë farë dhe të kultivojë një kulturë, Mbretëria e Perëndisë do të funksionojë për këdo që di t’i përdorë ligjet e Mbretërisë. Ti je një anëtar i shtëpisë së Perëndisë dhe një qytetar i Mbretërisë së Tij të madhe dhe ke qasje në gjithçka që Ai ka.

**Pra, më lejo të të them pse kaq shumë nga njerëzit e Perëndisë po dështojnë në jetë. Ata nuk e dinë se si funksionon Mbretëria e Perëndisë dhe nuk dinë se si ta dëgjojnë Frymën e Shenjtë.**

*Kështu thotë Zoti, Çliruesi yt, i Shenjti i Izraelit: “Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të mëson për të mirën tënde, që të udhëheq nëpër rrugën që duhet të ndjekësh”*

—Isaia 48:17

Suksesi i Danit nuk ishte diçka që Dani e mendoi. Ishte një strategji unike e Frymës së Shenjtë që u dallua sepse Dani ndërmori hapa për ta zbatuar ligjin e Mbretërisë dhe ai dhe gruaja e tij po dëgjonin që Fryma e Shenjtë të fliste dhe t’i ndihmonte me një plan. Unë dua që ti ta mbash shënim këtë.

## **FRYMA E SHENJTË E KA PLANIN!**

**Nuk ka asgjë më të fuqishme sesa të kesh një plan. Pa një plan, fotografia është një ëndërr, por me një plan, ëndrra mund të ndërtohet.**

Një familje mund të përfytyrojë sikur ka një shtëpi të mrekullueshme, me shumë dhoma gjumi, hapësira të bollshme ndenjeje, një kuzhinë të

madhe moderne dhe zbukurime të bukura. Por në atë pikë, nuk është gjë tjetër veçse një ëndërr, një fotografi. Ajo foto duhet të skicohet dhe më pas të kthehet në një projekt, një plan. Pasi ndërtuesi e merr projektin, shtëpia mund të ndërtohet. Për disa arsye, shumica e të krishterëve kanë atë që unë e quaj mentaliteti i një kutie postare. Kur luten dhe i kërkojnë Perëndisë paratë që u nevojiten, siç bëri Dani, ata thjesht presin që ato të shfaqen në kutinë e tyre postare, ose më keq, presin që dikush t'ua japë. Ata nuk kanë asnjë ide për procesin.

Po, së pari, duhet të keni foton. Por ka një proces për ta sjellë atë foto në realitet, ku ta shijosh atë. Përgjigja është një plan ose strategjia e nevojshme për ta realizuar atë. Më lejo të të jap një shembull. Nëse do të të thosha se mund t'i rregulloja problemet e tua financiare shumë shpejt dhe që të përgatisje stilolapsin dhe letrën, ndërsa do të të tregoja se çfarë duhet të bësh, ti do të nxjerrësh letrën dhe stilolapsin dhe do të përgatitesh për të dëgjuar përgjigjen. Unë do të vazhdoj të them se për shumicën e njerëzve që lexojnë këtë libër, ajo që do të tregoj ndoshta do të eliminonte stresin financiar, si dhe do t'i çlironte nga borxhet para se të mbaronte viti. Tani, dora jote e shtrëngon stilolapsin pak më fort dhe ti sforcohesh për t'u siguruar që të mos humbasësh atë që do të them.

Përgjigja është vërtet shumë e thjeshtë, shpjegoj unë. Thjesht nxirr një fitim neto këtë vit prej 10 milionë dollarësh. Ti ndoshta do të më shikoje për një moment dhe do të filloje të qeshje. Më pas supozoj nga qeshja jote se 10 milionë dollarët nuk do të mjaftonin, kështu që shtoj: "Epo, nëse kjo nuk mjafton, atëherë fito vetëm 25 milionë dollarë." Me këtë, ti jo vetëm qesh, por madje qesh me të madhe. Pse? Më lejo të të tregoj se çfarë ndodhi. Për shumicën e njerëzve, 10 milionë dollarë me të vërtetë do t'i çlironin nga borxhi, por ata qeshin sepse thjesht nuk mund ta shohin veten duke fituar ndonjëherë 10 milionë dollarë në një vit. Opsioni prej 25 milionë dollarësh sjell vetëm të qeshura, sepse është aq larg nga perspektiva e tyre e mundshme, saqë është për të qeshur.

Por le ta zëmë se unë zotëroj një kompani eksporti dhe të ofrova të paguaj 1000 dollarë për çdo top që ti e vendos në një kuti dhe më pas e mbyll me shirit ngjitës gati për transport. Le të supozojmë gjithashtu se ti mund të bësh rreth 500 kuti të tilla në ditë dhe që unë përfshij një kontratë 12-mujore për të njëjtën pagesë. Kjo është jashtëzakonisht e ekzagjeruar për qëllime ilustruese, por do të ta qartësojë idenë time.

Atëherë, duke supozuar që ti e ke në dorë këtë kontratë dhe që unë i përmbahem deklaratës së mëparshme se zgjidhja jote financiare është të fitosh 10 milionë dollarë të ardhura neto gjatë vitit të ardhshëm, cila do të ishte përgjigja jote? Këtu të qeshurat do të pushonin. Në vend të tyre do të kishte britma gëzimi dhe emocion të madh. Pse? Sepse do të ishte e lehtë të fitosh 10 milionë dollarë me atë kontratë. Në fakt, fitimi i 25 milionë dollarëve do të ishte i lehtë dhe fitimi i 100 milionë dollarëve do të ishte gjithashtu i mundur. Çfarë ndryshoi? Vetëm një gjë – ti ke një plan. Ashtu si deklarata që bëra më parë, se kushdo mund të kapë peshk nëse Jezusi i tregon se ku dhe si të peshkojë, kështu është për ty tani. Pasi të kesh një plan, një plan të mundshëm për ty, problemi yt zgjidhet.

*Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju”, thotë Zoti, “mendime paqeje dhe jo të së keqes, për t’ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë (Jeremiaas 29:11)*

Më lejo ta them përsëri - mendoj se duhet ta dëgjosh përsëri – Perëndia e ka planin **TËND!**

Disa muaj më parë, pata privilegjin të takoja një nga partnerët e mi në një kishë ku jepja mësim. Ajo erdhi në fund të shërbesës me një

**MË LEJO TA THEM  
PËRSËRI - MENDOJ SE  
DUHET TA DËGJOSH  
PËRSËRI – PERËNDIA  
E KA PLANIN TËND!**

pyetje, ose duhet të them një deklaratë. “Nuk funksionoi! E mbolla farën time, rashë dakord me burrin tim për të marrë drerin tim dhe nuk e mora një të tillë.” Ajo më tregoi se si kishte mbjellë për një dre të veçantë, një mashkull brilopatë, për një dre që do të ishte shënjestra e përsosur. Kështu fillova të bëja më shumë pyetje dhe më në fund e pyeta nëse rastësisht kishte parë ndonjë dre ditën që kishte shkuar për gjueti. Ajo tha: “Po, pikërisht lloji i drerit mashkull për të cilin kisha mbjellë hyri dhe më qëndroi pranë në distancën e përsosur për gjuajtjen time.»

Atëherë, u trondita pak nga kjo, kështu që pyeta se çfarë ndodhi më pas. Ajo tha se kishte shënjestrën e përsosur, por i kishte kërkuar një shoqeje t’ia drejtonte çiftin dhe, duke supozuar se shoqja e kishte bërë këtë, ajo nuk e kontrolloi vetë dhe goditja nuk pati sukses. Epo, për mua ishte shumë e qartë, por çuditërisht, nuk ishte për të.

Mendoj se ky është niveli i shumë besimtarëve. Për disa arsye, ata nuk e kuptojnë procesin, rolin që duhet të luajnë në korrje. M’u desh t’i shpjegoja asaj se Perëndia e kishte bërë pjesën e Tij, por ajo sapo kishte humbur pjesën e saj. Pra, Perëndia mund të ta japë planin, por ti duhet të bësh pjesën tënde të planit që ai të funksionojë. Je ti dhe Perëndia!

*Përsëri, mbretëria e qiejve i ngjan një thesari **TË FSHEHUR** në një arë, që një njeri që e ka gjetur e fsheh; dhe, nga gëzimi që ka, shkon, shet gjithçka që ka dhe e blen atë arë.*

—Mateu 13:44

Ka kaç shumë të vërteta të Mbretërisë në këtë shkrim të shenjtë! Para së gjithash, le të përkufizojmë thesarin. Sipas fjalorit, thesari është një pasuri e vlefshme ose e çmuar e çfarëdo lloji. Pra, thesari nuk duhet të jetë një send ari; mund të jetë çdo gjë që të nevojitet për momentin. Pra, ky shkrim i shenjtë thotë se Mbretëria e qiejve është si thesari, ose



mund të thuash se gjithçka që të nevojitet në jetë është në atë Mbretëri. Por, ku është Mbretëria? Në këtë shkrim të shenjtë, Jezusi thotë se ai është i fshehur në një arë. Eh, nuk do të të pëlqente ta dije se ku është ajo arë? Epo, lajmi i mirë është se Jezusi na tregon se ku është ajo arë dhe gjithashtu si ta gjejmë thesarin e fshehur në të.

Nëse shkojmë te shëmbëlltyra e mbjellësit te Marku 4, gjejmë Jezusin duke dhënë mësimin se si prodhohet besimi në zemrën e njeriut. Atje Ai përdor një analogji që e krahason shpirtin e njeriut me tokën dhe Fjalën e Perëndisë me farën e mbjellë në tokë. Duke përdorur të njëjtën analogji, mund të supozoj se toka e përmendur këtu te Mateu 13 do të kishte të njëjtin përkufizim, d.m.th, shpirti i njeriut. Dua që për një sekondë të të kujtoj atë që mësuam në kapitullin 6, se kur lindim përsëri, shpirti ynë njerëzor bëhet një me Frymën e Perëndisë, duke na lejuar të lidhemi me mendimet e Perëndisë. Pra, thesari që ndodhet në arë nuk është aspak i kufizuar vetëm për ne, por do të përfshijë gjithçka që Perëndia është pasi ne jemi një me Të në Frymë.

*Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë. Po Perëndia na i ka zbuluar me anë të Frymës së tij, sepse Fryma heton çdo gjë, edhe të thellat e Perëndisë. Sepse cili nga njerëzit, pra, njeh gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të? Po kështu asnjëri si njeh gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë. Dhe ne nuk kemi marrë frymën e botës, por Frymën që vjen nga Perëndia, që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia.*

—1 Korintasve 2:9-12

Dhe më pas 1 Korintasve 2:16 shton se *ne kemi mendjen e Krishtit!* Te Lluka 17:20-21, Jezusi verifikon se ku ndodhet ky thesar

*Mbretëria e Perëndisë nuk vjen në mënyrë të dukshme ...  
sepse ja, mbretëria e Perëndisë është përbrenda jush*

—Lluka 17:20-21

*A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkitni vetvetes? Sepse u bletë me një çmim! Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tua.*

—1 Korintasve 6:19-20

Pra, më lejo ta përmbledh atë që po përpiqem të them

## **BRENDA TEJE ËSHTË NJË THESAR!**

Sa thesar? Thesar që i tejkalon ëndrrat e tua më absurde! Thesar i pamatshëm!

*Tani atij që, sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë.*

—Efesianëve 3:20

**TASHMË ËSHTË  
E GJITHA JOTJA,  
MIKU IM, E GJITHË  
MBRETËRIA.  
PERËNDIA NUK  
MUND T'I SHTOJË  
ASGJË ASAJ QË  
TA KA DHËNË  
TASHMË. TASHMË  
I KE TË GJITHA!**

Pra, këtu do të duhet të stërvitemi ndryshe. Ky thesar është më shumë sesa mund ta imagjinojmë! Zakonisht, kur kemi nevojë për diçka ose kemi nevojë për ndihmë, ne e kemi trajnuar veten që ta kërkojmë përgjigjen jashtë vetes. Por tani, Fryma e Shenjtë, vetë Perëndia, jeton në ne dhe është ndihma jonë. Ne e kemi diskutuar tashmë se si lutja në Frymë ose në gjuhë sjell mësim dhe zbulon mistere. Por kaq shumë njerëz e kanë të vështirë të kuptojnë se sa e paçmueshme mund të jetë kjo lloj ndihme ose që Perëndia me të vërtetë

dëshiron të jetë përgjigja e tyre në çdo fushë të jetës.

Por kur u rilinde, ti u bërë një anëtar i shtëpisë së Perëndisë dhe një qytetar i Mbretërisë së Tij të madhe. Ai tashmë ta ka dhënë gjithçka që ka! Në fakt, Lluka 12:32 thotë se nuk ka asnjë arsye për të qenë i trembur ose i frikësuar pasi për Atin tënd ishte kënaqësi të ta jepte Mbretërinë. Çfarë mbretërie? Mbretërinë e Tij!

*“Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t’ju japë mbretërinë.”*  
(Lluka 12:32).

Tashmë është e gjitha jotja, miku im, e gjithë Mbretëria. Perëndia nuk mund t’i shtojë asgjë asaj që ta ka dhënë tashmë. Tashmë i ke të gjitha! Shumë njerëz sillen sikur po e shqetësojnë Perëndinë nëse e përfshijnë Atë në jetën e tyre të përditshme. Por kjo është thjesht padituri. Nëse të them se je shtetas i Shteteve të Bashkuara dhe më thua: “Po, ku ta di unë. Nëse do të hapja biznesin këtu, do të kisha frikë se do të shqetësoja dikë po do të doja të përfitoja nga disa prej ligjeve të vendit që do të më lejonin të hapja biznesin tim këtu.” Si qytetar, ti tashmë ke të gjitha ligjet dhe privilegjet që i gjithë vendi mund të të ofrojë. Ato janë të gjitha të tuat! Mos u ndal. Merri të gjitha përfitimet që tashmë janë të tuat ligjërisht!

### **Pse Mbretëria e Perëndisë krahasohet me një thesar?**

Sepse nëse ke akses në njohuritë e qiellit, mund të dish se çfarë të bësh në çdo situatë me strategji unike dhe të pazakonta që t’i ka dhënë Perëndia. Më lejo të të jap një shembull tjetër se si funksionon kjo.

Kur Drenda dhe unë filluam të mësojmë për Mbretërinë, jeta jonë ndryshoi shumë. Të largoheshe plotësisht nga borxhi ishte si të thithje ajër të pastër dhe jeta mori një aromë krejtësisht të re. Çudia e pagimit me para në dorë për 22 hektarët tanë ishte si një ëndërr, ishte e mahnitshme, por ne ende kishim nevojë për një shtëpi në atë truall. Nuk dinim asgjë lidhur me ndërtimin e një shtëpie dhe nuk dinim

vërtet nga t'ia fillonim. Por ne filluam të lutemi rreth MËNYRËS si ta merrnim shtëpinë që na duhej në atë tokë. Ne patëm besim tek Fryma e Shenjtë për të na ndihmuar.

Duke dashur të jetonim pa asnjë borxh, filluam të eksplorojmë mënyra të pazakonta për të ndërtuar një shtëpi. Një nga metodat që ofronte një shtëpi të përsosur me një çmim të reduktuar ishte ngritja e një shtëpie modulare. Një shtëpi modulare nuk është një rimorkio, por, përkundrazi, një shtëpi që është ndërtuar me pjesë në fabrikë dhe më pas montohet në tokën tënde. Këto shtëpi janë të së njëjtës cilësi si një shtëpi e ndërtuar me dërrasa, por janë me një çmim të reduktuar për shkak të metodave efikase të ndërtimit të përdorura në fabrikë. Kështu, ne pamë dy ose tre kompani të ndërtimeve modulare dhe modelet që ato ofronin. Pasi hulumtuam dhe pamë shtëpitë modulare, menduam se kjo ishte rruga që duhej ndjekur dhe zgjodhëm një kompani dhe model që menduam se do të ishte një shtëpi e shkëlqyer në pronën tonë. Ne ishim gati të nënshkruanim kontratën pasi u kthyem në shtëpi nga një kongres në Virxhinia ku ishim ftuar të flisnim rreth temës së shkollimit në shtëpi. Ne vendosëm t'i merrnim projektet me vete, në mënyrë që të mund të diskutonim çdo detaj që mund të na kishte shpëtuar dhe për t'u siguruar se kjo ishte mënyra që duhej ndjekur përpara se të nënshkruanim kontratën kur të ktheheshim.

Nuk e mbaj mend se si ndodhi që na ftuam të flisnim në konferencën në Virxhinia, por, ndërsa ishim atje, na ftuam të qëndronim me një nga familjet që e zhvillonin shkollën në shtëpi. Pasi arritëm në shtëpinë e tyre të bukur të stilit jugor dhe takuam miqtë tanë të rinj, filluam të komentonim se sa e mrekullueshme ishte shtëpia e tyre. Në atë bisedë morëm vesh se e kishin ndërtuar vetë. Në fillim u trondita. “A jeni kontraktorë?”, i pyeta. “Jo”, thanë ata. Burri i shtëpisë na informoi se ishte kontabilist në një kompani të madhe lokale. “Epo, si e mësuat se si ta ndërtoni shtëpinë tuaj?”, i pyeta.

Ata filluan të flisnin për gjëra të ndryshme dhe, gjatë bisedës, u

treguam se edhe ne po ndërtonim një shtëpi dhe do ta nënshkruanim kontratën sapo të ktheheshim në qytet. Ata u emocionuan kur e dëgjuan këtë dhe filluan të na pyesnin për shtëpinë tonë të re. Filluam t'u tregonim për Mbretërinë dhe se si jeta jonë kishte ndryshuar. U treguam se si kishim paguar para në dorë për 22 hektarët dhe sa të emocionuar ishim që do të transferoheshim nga ajo shtëpi ferme.

Ne përmendëm se projektet aktuale i kishim me vete dhe ata na pyetën nëse mund t'i shihnin, gjë për të cilën, natyrisht, do të na pëlqente të dëgjonim mendimin e tyre. Kështu që ne morëm planet dhe u ulëm në tryezën e kuzhinës së tyre dhe ua vendosëm përpara. Nuk kaloi shumë kohë dhe gruaja filloi të thoshte gjëra të tilla si: “Jo, kjo zonë është shumë e vogël” ose “keni nevojë për një kuzhinë më të madhe” ose “a keni menduar si do të jetë shtëpia ndërsa fëmijët tuaj rriten? Si pastorë, ju duhet vërtet një zonë më e madhe argëtimi”. Në thelb, ata na treguan pse kjo shtëpi nuk ishte ajo që duhej të ndërtonim dhe ne u detyruam të pajtoheshim me çdo mendim që shprehën. “Epo, si mund të ndërtojmë një shtëpi më të madhe me paratë që duhen shpenzuar?” “Kjo është e lehtë”, thanë ata. “Ndërtojeni vetë!” Kur i dëgjova ato fjalë, gati qesha. “Të ndërtoj shtëpinë time?” Siç thashë, nuk dija asgjë rreth shtëpive! Por ata filluan të na inkurajojnë, duke thënë se nuk ishte aq e vështirë. Ata na treguan për një libër të quajtur, *Kurseni deri në 50 000 dollarë ose më shumë si kontraktori i përgjithshëm i vetes suaj: Si të planifikoni, nënkontraktoni dhe ndërtoni shtëpinë tuaj të ëndrrave* nga Warren V. Jaeger.

Andaj, kur u kthyem në shtëpi, ne zgjodhëm të mos e nënshkruanim kontratën për të ndërtuar shtëpinë modulare. E porositëm librin dhe e lexuam, duke u thelluar në çdo kapitull. Filluam të shikonim edhe planet e shtëpive me porosi. Më në fund, gjetëm një plan shtëpie që na pëlqeu dhe filluam ta zbërthejmë hap pas hapi. Ne folëm me miq dhe njerëz që i njihnim, që kishin ndërtuar shtëpi gjithashtu. Më në fund, vendosëm se mund ta bënim këtë! Ne pamë planet e ndërtimit dhe pyetëm veten:

“Çfarë mund të bëjmë vetë që kjo shtëpi të mbetet brenda buxhetit tonë?” Në mënyrë të pabesueshme, vendosa se mund t’i bëja vetë instalimet në të gjithë shtëpinë, edhe pse nuk kisha mbajtur kurrë një fije përcjellësi 12/2 në jetën time. Një mik që e kuptonte instalimin e kabllave më tha se ishte e lehtë dhe ai do të më tregonte se si.

Duke qenë se isha i zënë me biznesin tim, Drenda vendosi të ishte kontraktorja e përgjithshme që punonte me nënkontraktorët. Ne morëm një kontraktor për të ndërtuar skeletin e shtëpisë dhe pjesa tjetër varej nga ne. Ajo që erdhi më pas ishin disa nga ditët më intensive, por emocionuese të jetës sonë. Për t’i rënë shkurt, ne e përfunduam shtëpinë tonë me dyfishin e sipërfaqes që ofron modulari. Kishim dyer prej druri të forta; dysheme druri; tavan të fortë prej druri; dhe dollapë të bukur

e të personalizuar në një kuzhinë të mbushur me pajisje të reja çeliku inoks. Kuptuam se kemi kursyer mbi 200 000 dollarë duke e ndërtuar vetë!

Sot, jam kaq i lumtur që i kërkuam Frymës së Shenjtë të na ndihmonte me një plan. Rezultatet ishin dhe janë deri tani përtej çdo gjëje që mund të kishim ëndërruar si të mundshme. Unë jam ende i mahnitur se si Zoti e orkestroi atë udhëtim në Virxhinia dhe na vendosi

## **UNË GJITHMONË THEM SE SEKRETET E PERËNDISË JANË TË FSHEHURA PËR TY, JO NGA TI! SATANI BANON NË ERRËSIRË DHE NUK I NJEH PLANET E PERËNDISË.**

me çiftin që sapo kishte përfunduar ndërtimin e shtëpisë. Jam i bindur se nëse kjo nuk do të kishte ndodhur, ndoshta do të kishim ndërtuar shtëpinë modulare. Nuk po them se shtëpia modulare nuk do të kishte funksionuar për njëfarë kohe, por shumë shpejt nuk do të na mjaftonte. Shtëpia që ndërtuam është ende një dëshmi për mua e një shembulli se si Fryma e Shenjtë do të të ndihmojë në çdo situatë, duke të dhënë planin dhe drejtimin që do t’i tejkalojë pritshmëritë e tua!

Atëherë, ma lejo ta them edhe një herë ...

## Perëndia e ka planin **TËND!**

Por ti mund të thuash: “Geri, kjo është gjë e mirë, por Mateu 13:44 thotë se plani është i fshehur!” Po, po, dhe kjo është në avantazhin tënd. Shiko se çfarë thotë Jezusi te Mateu 13:10-11.

*Atëherë dishepujt iu afruan dhe i thanë: “Pse po u flet atyre me shëmbëlltjrë?”. Dhe ai duke u përgjigjur u tha atyre: “Sepse juve ju është dhënë mundësia të njihni të fshehtat e mbretërisë së qiejve, ndërsa atyre nuk **u është dhënë.**”*

—Mateu 13:10-11

Kjo njohuri e fshehtë është për ty dhe jo për djallin ose njerëzit e këqij që do ta keqpërdornin atë ose do të pengonin planet e Perëndisë. Bibla thotë se Satani do të ndryshojë taktikat nëse mund të kuptojë atë që po bën Perëndia.

*Por flasim diturinë e Perëndisë të fshehur në mister, që Perëndia e kishte paracaktuar përpara kohërash për lavdinë tonë, të cilën asnjë nga pushtetarët e kësaj kohe nuk e ka njohur; sepse, po ta kishin njohur, nuk do të kishin kryqëzuar Zotin e laudisë.*

—1 Korintasve 2:7-8

Unë gjithmonë them se sekretet e Perëndisë janë të fshehura për ty, jo nga ti! Satani banon në errësirë dhe nuk i njeh planet e Perëndisë. Ai mund të reagojë vetëm ndaj asaj që Perëndia po bën. Në momentin që ai merr vesh se çfarë po ndodh, është shumë vonë! Kështu që herën tjetër që do të nervozohesh pak ndërsa afrohet ora e mesnatës dhe nuk e ke marrë ende përgjigjen, dije se Zoti nuk është kurrë vonë dhe ajo që mund ta shohësh si vonësë punon për të mirën tënde duke e mbajtur përgjigjen të fshehur derisa të vijë koha që ajo të zbulohet.

*Përsëri, mbretëria e qiejve i ngjan një thesari TË FSHEHUR në një arë, që një njeri që e ka gjetur **e fsheh**: dhe, nga gëzimi që ka, shkon, shet gjithçka që ka dhe e blen atë arë.*

—Mateu 13:44

Ne kemi diskutuar se çfarë dhe ku është ara dhe pse thesari është i fshehur. Ne kemi diskutuar gjithashtu se si t'i dëgjojmë ato gjëra të fshehura nga Mbretëria e Perëndisë duke u lutur në Frymë dhe duke dëgjuar zërin e Frymës së Shenjtë. Por ka një parim tjetër jetik në këtë proces të renditur në Shkrimin tonë që duhet ta dish. Mosdëgjimi i tij ka shkaktuar rrëzimin e shumë planeve të mira e fisnike dhe ka shkaktuar shkatërrime rrënuese në jetët e njerëzve. Mbase e vure re se në shkrimin tonë të shenjtë thuhet se sapo njeriu dëgjon për thesarin, idenë, drejtimin ose planin e Perëndisë, ai e fsheh përsëri. AI NUK VEPRON BAZUAR NË TË menjëherë! Ai nuk fillon t'u tregojë të gjithë miqve dhe fqinjëve të tij për atë që ka dëgjuar nga Zoti ose për planet e tij të reja dhe emocionuese, të paktën ende jo. Bibla thotë se ai e fsheh përsëri, shkon dhe shet gjithçka që ka dhe pastaj blen arën. Me fjalë të thjeshta, ai nuk dëshiron t'ia zbulojë vendndodhjen e thesarit askujt tjetër derisa ta zotërojë atë. Duke pritur derisa ta zotërojë, ai sigurohet që askush nuk mund t'ia vjedhë.

Shkrimi i shenjtë zbulon gjithashtu se në kohën kur e gjen për herë të parë thesarin, ai në fakt nuk është në gjendje të paguajë për thesarin dhe duhet të kalojë një proces përgatitjeje që i mundëson blerjen. Ky parim shkon përtej parave dhe thjesht blerjes së diçkaje. Po na mëson një parim të rëndësishëm të jetës dhe se si duhet të veprosh sipas asaj që të tregon Fryma e Shenjtë nëse dëshiron të kesh sukses.

Shkrimi i shenjtë thotë se pasi ta dëgjosh idenë ose drejtimin, nuk duhet të veprosh bazuar në të pa pasur aftësinë për ta bërë. Mendoj se të gjithë mund ta shohim lehtësisht se si funksionon kjo me paratë. Nëse nuk



ke para të mjaftueshme për të blerë tokën, sigurisht që nuk do t'i thuash dikujt se kishte një thesar në të. Nëse do të mësohej se kishte një thesar në të, të jesh i sigurt se dikush tjetër do ta blinte i pari. Në vend të kësaj, do të shkoje dhe do të bëje gjithçka që duhej për të gjetur paratë për të blerë tokën, duke e mbajtur për vete të vërtetën për thesarin e fshehur.

I njëjti parim është i vërtetë për çdo drejtim ose udhëzim që mund të të japë Perëndia. Shumë herë të krishterët humbasin fillimin për fundin. Shumë herë, Fryma e Shenjtë do të na zbulojë një ide, duke mos e zbuluar atë që ne të veprojmë bazuar në të në atë moment, por për të na mundësuar të përgatitemi në mënyrë që të mund të kapim mundësinë. Faza përgatitore e çdo përpjekjeje është pjesa më e rëndësishme e procesit. Në sport, ndeshjet fitohen ose humben bazuar në përgatitjen e skuadrave gjatë stërvitjes, kur askush nuk i shikon. Por ti duhet të biesh dakord se praktika nuk është argëtuese; është rraskapitëse dhe e lodhshme. Në krahasim me këtë, të gjithë e duan emocionin e lojës, turmat, dritat dhe drithërimën e fitores.

Fatkeqësisht, ato ëndrra kthehen në dhimbje dhe pikëllim kur përgatitja nuk merret parasysh. Nuk mund ta imagjinosh se sa njerëz kam parë të shkatërrojnë jetën e tyre duke mos e ditur këtë parim. Kam parë njerëz që u thirrën me të vërtetë nga Perëndia, njerëz që u vajosën, nisën një kishë kur nuk ishin të përgatitur emocionalisht apo financiarisht dhe përfunduan me një fatkeqësi në vend të ëndrrës që përfytyruan. Kam parë njerëz që e kanë dëgjuar Perëndinë t'u japë atyre një ide për biznes dhe, të bindur për suksesin, janë larguar nga puna e tyre me kohë të plotë pa u kujdesur sa duhet ose përgatitur sa duhet dhe kanë përfunduar në falimentim. Pjesa e trishtueshme e këtyre historive është se faji i mbetet Perëndisë dhe njerëzit e përfshirë zhgënjehen jo vetëm me veten, por edhe me Perëndinë. Nuk jam i sigurt pse kaq shumë njerëz mendojnë se sukcesi vjen brenda natës. Por njerëzve duhet t'u mësohen proceset e suksesit që gjenden në këtë shkrim të shenjtë të thjeshtë.

Njerëzit vijnë tek unë dhe thonë: “Hej, Pastor, Perëndia më tha që kjo është kisha ime.» Pastaj nuk i sheh më kurrë. «Hej, Pastor, Perëndia më dha këtë ide të shkëlqyer biznesi.” Gjëja tjetër që dëgjon është se shtëpia e tyre është pjesë e ankandit publik të ardhshëm dhe makina ua kanë marrë. Kjo NUK është ajo që Perëndia ka për ty.

Kur dëgjojmë një ide nga Fryma e Shenjtë, kjo nuk do të thotë që ne duhet të veprojmë në atë moment. Shumicën e kohës, Fryma po na shtyn ta fshehim atë ëndërr dhe të përgatitemi për ta arritur atë. Zakonisht, ne nuk kemi gjithçka që na nevojitet për ta arritur atë vizion me sukses. Përgatitja mund të zgjasë një javë apo edhe vite në varësi të asaj që Perëndia të ka treguar të bësh. Duhet të kuptosh se përgatitja dhe koha janë po aq të rëndësishme ose më të rëndësishme se vetë ideja!

E di që në rastin tim, unë u thirra për të predikuar Ungjillin kur isha 19 vjeç. Pata një vegim të qartë ku pashë veten duke mbajtur një Bibël dhe Zotin duke thënë: “Unë po të thërras të predikosh Fjalën time” tri herë. Ishte një përvojë shumë reale dhe e fuqishme. Por Zoti nuk më tha të shkoja dhe të filloja të predikoj në atë moment. Në vend të kësaj, Ai më tha të shkoja në universitet. Por unë për pak sa nuk ngela në shkollë të mesme me një mesatare 1,3. Unë isha gjithashtu jashtëzakonisht i turpshëm dhe shmangia shoqërimin me njerëz. Më lejo të jem shumë i qartë. As nuk i afrohesha pjekurisë së nevojshme për të drejtuar njerëzit! Kështu që shkova në universitet dhe ishte e vështirë, shumë e vështirë - por ngulmova dhe kreu katërvjeçarin tim universitar.

Pasi e mbarova universitetin, pyesja veten nëse kishte ardhur koha për të predikuar. Por Zoti më tha se donte që unë të pranoja një punë në një firmë financiare lokale që shet sigurime dhe letra me vlerë. Edhe pse kjo nuk kishte kuptim për mua, e dija se po dëgjoja zërin e Zotit dhe e pranova pozicionin. Ajo punë ishte edhe më e vështirë se universiteti. Më duhej të bëja telefonata të ftohta çdo ditë dhe të

mësoja të kapërceja frikën time nga njerëzit. Të jetosh me komisione ishte gjithashtu e vështirë dhe, të jem i sinqertë, doja të largohesha çdo ditë, por e dija se nuk mundja. Më në fund, pas disa vitesh, u bëra i zoti në atë që po bëja. Në fakt, unë dhe Drenda krijuam zyrën numër një nga 5000 zyra në mbarë vendin me firmën me të cilën ishim.

Ishte në atë moment që Perëndia më tha se kishte ardhur koha për të nisur një kishë. Në atë kohë unë isha 40 vjeç. U deshën 21 vjet që Perëndia të më përgatiste për vegimin që më kishte dhënë kur isha 19 vjeç. Sapo fillova të drejtoj si pastor, kuptova pse nevojitej kaq shumë përgatitje. Puna e pastorit ishte më e vështirë nga sa mendoja se do të ishte. Por për shkak të stërvitjes sime me njerëzit dhe përballjes me refuzimin në biznes, unë munda të jem besnik ndaj thirrjes së Perëndisë në jetën time. Jo çdo detyrë do të kërkojë 21 vite përgatitjeje, por parimi i përgatitjes do të jetë i njëjtë.

Për shkak të këtij parimi të përgatitjes, më pëlqen të parafrazoj kështu vargun te 13:44:

*Mbretëria e qiellit brenda teje të jep njohurinë ose të drejtën për të përdorur njohurinë e të fshehtave, ose gjërave të fshehura që Perëndia i di. Kjo njohuri mundësohet nëpërmjet Vetë Frymës së Perëndisë, që është brenda teje. Kur një njeri e gjen ose dëgjon për atë njohuri të fshehtë që është thesar për të, përgjigje për të, ai e fsheh përsëri në zemrën dhe mendjen e tij. Më pas, në gëzimin e tij nisat me gjithë forcën të ndjekë, me përgatitje të kujdesshme, drejtimin dhe udhëzimin që i është zbuluar, duke mbërthyer dhe kapur kështu përgjigjen e tij..*



## KAPITULLI 8

# POZITA E VËSHTIRË E PROMOVIMIT

Miku im pastor Piteri dhe gruaja e tij, Bev, që drejtojnë një kishë të madhe në Zelandën e Re, po vinin në Shtetet e Bashkuara për një vizitë të shpejtë. Ishte sezoni i Krishtlindjes dhe ata do të ndalonin në Colorado Springs në hotelin “Broadmoor” për disa ditë për tu çlodhur dhe për të shijuar peizazhin e Krishtlindjes. Nëse nuk ke qenë në “Broadmoor”, ai është një nga vendpushimet më të mira të Amerikës dhe ndodhet përballë Maleve Shkëmbore; dhe ata njihen për dekorimet e tyre të mrekullueshme të Krishtlindjes. Pastori Piter na thirri për të na njoftuar se do të qëndronin atje dhe pyeti nëse donim të bashkoheshim me ta. Ne përfituam nga rasti dhe kaluam atje tri nga ditët më të mrekullueshme.

Kur jam me pastor Piterin, zakonisht kalojmë shumë kohë duke folur për shërbimin, pasi ai është në bordin tim, gjë që ndodhi edhe në këtë udhëtim. Ne të dy po flisnim për planet tona për vitin e ardhshëm dhe thjesht po ndanim ide. Më në fund, erdhi koha për të thënë lamtumirë, gjë që është gjithmonë e trishtueshme pasi ata janë miq shumë të shtrenjtë. Unë dhe Drenda zakonisht i vizitojmë në Zelandën e Re një herë në vit, ose të paktën një herë në dy vjet, por këtë vit, unë tashmë isha shumë i zënë dhe nuk kisha plane ta bëja këtë.

Kështu u kthyem në shtëpi gati për t'u përballuar me vitin e ri me padurim. Megjithatë, është interesante që më 9 janar pata një ëndërr në të cilën m'u tha se pastor Piteri do të më ftonte të predikoja në kishën e tij në shkurt. Mbjaj mend që mendova se ishte shumë e pazakontë pasi sapo kisha kaluar tri ditë me të; ai nuk ma kishte përmendur këtë dhe shkurti ishte vetëm disa javë larg. I thashë Drendës atë që më kishte thënë Zoti ndërsa po shkoja në kuzhinë për mëngjes.

Kompjuteri im qëndronte mbi tavolinën e kuzhinës dhe e ndeza rastësisht. Ndërsa u ula atje duke pirë një filxhan kafe, pashë që kishte ardhur një email nga pastor Piteri. Teksa hapja emailin, u habita kur pashë se pastor Piteri po më ftonte të vija dhe të predikoja në konferencën e tij financiare vjetore, e cila ishte pas vetëm tri javësh. U habita, sigurisht, por për shkak të ëndrrës nuk u trondita. I hodha një vështrim të shpejtë agjendës sime për të parë nëse kjo ishte e mundur pasi kisha shumë udhëtime gjatë atij muaji në të njëjtën kohë që Piteri më kishte ftuar të isha në Zelandën e Re. Drenda dhe unë ishim planifikuar të fluturonim për në Buenos Aires, Argjentinë, disa ditë para se të shkoja në Oklend. E vetmja mënyrë për të arritur atje në kohë ishte të largohesha pas konferencës së Buenos Airesit dhe të fluturoja direkt për në Sidnej, Australi, dhe më pas të kapja fluturimin për në Oklend. Nuk do ta kisha bërë kurrë një udhëtim të tillë, por meqë Zoti më kishte folur, e dija se duhej të shkonim.

Udhëtimi ynë në Argjentinë ishte një udhëtim biznesi i sponsorizuar nga një prej klientëve të mi me të cilin kompania ime bën biznes. Ishte një udhëtim i mirë dhe ishte një kohë e shkëlqyeshme për t'u njohur me disa miq që zakonisht i takoj pak a shumë një herë në vit. Argjentina në atë kohë po përballej me disa probleme mjaft serioze financiare dhe pati disa trazira në qytet, por në përgjithësi, ishte një udhëtim i mrekullueshëm pasi nuk kisha qenë kurrë më parë atje. Fluturimi ynë për në Sidnej zgjaste 16 orë, fluturimi më i gjatë që do të kisha bërë ndonjëherë. Duhej të kaloja mbi majën e polit të jugut, gjë që mendova

se ishte e mrekullueshme pasi shpresoja ta shihja atë pjesë të botës nga ajri.

Gjatë fluturimit tonë, duke parë nga dritarja asgjë tjetër përveç akullit dhe borës poshtë meje, papritur kuptova se po fluturoja me një linjë ajrore argjentinase, një linjë ajrore që gjithashtu kishte probleme financiare në një vend që po luftonte për të qëndruar financiarisht në këmbë. Për një sekondë më kaloi nëpër mendje mendimi se nëse kjo kompani kishte zgjedhur rrugë të shkurtra për mirëmbajtjen e avionëve të saj dhe ne do të rrëzoheshim në këtë pjesë të botës, nuk do të ishte një tablo e bukur. Por e dija se isha në duar shumë të sigurta pasi Zoti Vetë më kishte udhëzuar ta bëja atë udhëtim.

Me të mbërritur në Sidnej, ne i bëmë një telefonatë të shpejtë pastor Piterit dhe Bevit dhe u tronditëm kur dëgjuam se pastor Piteri ishte në spital dhe sapo kishte pësuar një atak kardiak të rëndë. Ai nuk do të mund të predikonte fare gjatë fundjavës së tij të madhe financiare dhe më pyeti nëse mund të jepja mësim gjatë gjithë aktivitetit. Tani e dija pse Zoti më kishte drejtuar të vija në Zelandën e Re dhe isha i mahnitur se si Fryma e Shenjtë i drejton hapat tanë. Ky është një kujtues i madh i asaj që thotë Romakëve 8:14.

**“SEPSE TË GJITHË  
ATA QË UDHËHIQEN  
NGA FRYMA E  
PERËNDISË JANË  
BIJ TË PERËNDISË.”**

**—ROMAKËVE 8:14**

*“Sepse të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë janë bij të Perëndisë.” (Romakëve 8.14).*

Edhe një herë, ne po flasim për aftësinë për të dëgjuar drejtimin, idetë dhe konceptet nga Fryma e Shenjtë. Nuk ka histori më të mirë në Bibël sesa historia e Danielit për të ilustruar mësimin tim të ardhshëm se si të dëgjuarit e Frymës së Shenjtë mund të të japë përgjigjet që të nevojiten. Le ta ndjekim historinë duke filluar te Danieli 2:1–6.

*Në vitin e dytë të mbretërimit të Nebukadnetsarit, ai pa disa ëndrra; fryma e tij u turbullua dhe i iku gjumi. Atëherë mbreti dha urdhër të thërrisnin magjistarët, astrologët, shtriganët dhe Kaldeasit, që t'i tregonin mbretit ëndrrat e tij. Mbreti u tha atyre: “Pashë një ëndërr dhe fryma ime është turbulluar, deri sa t'ia dal të shpjegoj ëndrrën time”.*

*Atëherë Kaldeasit iu përgjigjën mbretit në gjuhën aramaike: “O mbret, jetofsh përjetë. Trego ëndrrën tënde shërbëtorëve të tu dhe ne do ta interpretojmë”.*

*Mbreti u përgjigj dhe u tha Kaldeasve: “Vendimin tim e kam marrë: po të mos ma bëni të njohur përmbajtjen e ëndrrës sime dhe interpretimin e saj, do të priteni copa-copa dhe shtëpitë tuaja do të katandisen në plehërishte. Por në rast se do të më tregoni ëndrrën dhe interpretimin e saj, do të merrni nga unë dhurata, shpërblime dhe nderime të mëdha; më tregoni, pra, ëndrrën dhe interpretimin e saj”.*

—Danieli 2:1-6

*Kaldeasit u përgjigjën para mbretit dhe thanë: “Nuk ka njeri mbi tokë që mund të dijë atë që mbreti kërkon. Në fakt asnjë mbret, sundimtar o sovran nuk i ka kërkuar një gjë të tillë ndonjë magjistari, astrologu ose Kaldeasi. Gjëja që kërkon mbreti është tepër e vështirë dhe nuk ka njeri që mund t'ia bëjë të ditur mbretit, përveç perëndive, banesa e të cilëve nuk është ndër të gjallët*

*Me këtë mbreti u zemërua, i hipi inati dhe urdhëroi që të shfaroseshin tërë të diturit e Babilonisë. Kështu u shpall*



*dekreti në bazë të të cilit duhet të vriteshin të diturit, dhe kërkonin Danielin dhe shokët e tij për t'i vrarë edhe ata.*

—Danieli 2:10-13

*Atëherë Danieli shkoi në shtëpinë e vet dhe ua bëri të ditur këtë gjë shokëve të tij Hananiah, Mishael dhe Azaria, me qëllim që t'i kërkonin mëshirë Perëndisë të qiellit lidhur me këtë sekret, me qëllim që Danieli dhe shokët e tij të mos vriteshin bashkë me kusurin e njerëzve të ditur të Babilonisë. Atëherë sekreti iu zbulua Danielit në një vegim nate. Kështu Danieli bekoi Perëndinë e qiellit. Danieli filloi të thotë: “Qoftë i bekuar emri i Perëndisë përjetë, sepse atij i përkasin dituria dhe forca. Ai ndryshon kohërat dhe stinët, i ul mbretërit dhe i larton, u jep dituri të urtëve dhe dije atyre që kanë mend. **Ai tregon gjërat e thella dhe të fshehta, njeh atë që është në terr dhe drita qëndron me të.***

—Danieli 2:17-22

Danieli është në një situatë jete a vdekjeje, një pozitë vdekjeprurëse. Por këtu është një çelës kryesor për promovimin tënd të ardhshëm. Perëndia e përdori atë për të përgatitur promovimin e tij, jo rënien e tij. Danieli është në gjendje, me njohurinë e fshehtë të Frymës së Shenjtë, t'i japë mbretit Nabukadnetsar ëndrrën dhe interpretimin. Mbreti është i emocionuar, siç e shohim në fragmentin e mëposhtëm.

*Atëherë mbreti Nebukadnetsar ra me fytyrë dhe ra përmbys para Danielit; pastaj urdhëroi që t'i paraqitnin një ofertë dhe temjan. Mbreti i foli Danielit dhe tha: “Në të vërtetë Perëndia juaj është Perëndia i perëndive, Zoti i mbretërve dhe zbuluesi i sekreteve, sepse ti ke mundur të zbulosh këtë sekret”.*

***Atëherë mbreti e bëri Danielin të madh, i dha dhurata të shumta dhe të mëdha, e bëri qeveritar të gjithë krabinës së Babilonisë dhe kreun më të lartë të gjithë të diturve të Babilonisë.*** Përveç kësaj, me kërkesë të Danielit, mbreti vuri në krye të administratës së krabinës së Babilonisë Shadrakun, Meshakun dhe Abed-negon. Danieli përkundrazi mbeti në oborrin e mbretit.

—Danieli 2:46-49

Cili ishte rezultati i dëgjimit të zërit të Perëndisë prej Danielit? Promovimi dhe pasuria!

Të njëjtin rezultat mund ta gjejmë në një histori tjetër në Bibël, historia e Jozefit. Përballë një situatë të ngjashme, Jozefit iu dha shansi të interpretonte ëndrrën e Faraonit. Pasi që në gjendje të interpretonte me sukses ëndrrën dhe pasi siguroi edhe një plan administrimi për të shpëtuar Egjiptin nga thatësira e ardhshme që iu zbulua në ëndërr, ne gjejmë përgjigjen e Faraonit te Zanafilla 41:39–40..

*Atëherë Faraoni i tha Jozefit: “Meqenëse Perëndia të bëri të dish të gjitha këto gjëra, nuk ka asnjëri të zgjuar dhe të ditur sa ti. Ti do të jesh mbi shtëpinë time dhe i tërë populli im do t’u bindet urdhrave të tua; vetëm për fronin unë do të jem më i madh se ti”*

—Zanafilla 41:39-40

Në të dyja këto histori, dëshpërimi ishte një tundim i vërtetë në fillim, por promovimi dhe pasuria ishin rezultati. E thënë thjesht, bota do t’u paguajë para të mëdha njerëzve që zgjidhin probleme të mëdha. Frymës së Shenjtë në ty i pëlqen të të vendosë në mes të problemeve të mëdha! Mos fillo të kesh frikë kur kjo të ndodhë, por fillo të lavdërosh Zotin, pasi Ai do të të ndihmojë ashtu siç ndihmoi Danielin dhe Jozefin! Unë gjithmonë them se Perëndia e merr lavdinë, dhe unë marr

rrogën! Më pëlqen ajo që tha Danieli për Zotin: **“Ai tregon gjërat e thella dhe të fshehta, njeh atë që është në terr dhe drita qëndron me të.”** Danieli thotë se drita banon me Të. Kjo është si të dalësh jashtë në një natë të errët: kur ndez dritën, mund të shohësh se ku po shkon! Frika pushtohet nga drita dhe ti e di ku të ecësh. Pali nënkupton në këtë varg se Perëndia flet dhe na ndihmon në kohën tonë të telasheve.

*Ju e dini se, kur ishit paganë, tërhiqeshit pas idhujve të **pagojë**, nën shtytje të çastit.*(1 Korintasve 12:2)

Pali thotë se idhujt nuk flasin, por Perëndia flet!

Mbase mund të pyesësh veten pse e titullova këtë kapitull “Pozita e vështirë e promovimit”. Për shkak se është në pozitën e vështirë që Fryma e Shenjtë në ty ka përgjigjet. Është pozita e vështirë që të jep mundësinë e përsosur për të sjellë zgjidhjen. Pozita e vështirë është konfigurimi i përsosur për promovimin tënd të ardhshëm! Fatkeqësisht, shumë besimtarë i shmangen pozitave të vështira. Në fakt, shumë mendojnë se nëse e gjejnë veten në një pozitë të vështirë, e kanë humbur Perëndinë.

Më kujtohet kur filluam të bënim televizion për herë të parë dhe faturat ishin rreth 9000 dollarë në muaj. Eh, mendova se ishin shumë para për t’i bërë gati çdo muaj, pastaj faturat arritën në mbi 20 000 dollarë në muaj dhe më pas në 50 000 dollarë në muaj. Një ditë, ndërsa të gjithë ishim në lutje, Emi, vajza ime, filloi të fliste përmes dhuratës së profecisë:

“Të korrat janë shumë të mëdha për ty. Po të bëj të rritesh. Vetëm me anë të Shpirtit Tim mund të kuptosh se çfarë do të ndodhë! A do të dalësh? Më lër të të çoj drejt gjërave të vështira përtej të kuptuarit tënd, drejt të pamundurave.”

Përpara se të ta tregoj historinë, bazuar në atë që di tani, a mund të më thuash se si duhet ta interpretojmë atë? PROMOVIM! Më pëlqen që Perëndia më dha një zgjedhje. Ai po më pyeste nëse isha i gatshëm të

ecja me Të. Ai po merrte miratimin tim. Nëse do të kisha thënë jo, Ai do të kishte shkuar te dikush tjetër, jam i sigurt. Por unë do të preferoja ta merrja promovimin, apo jo?

Epo, unë thashë: “Po, Zot, ti e di që do ta bëj”. Disa javë pas kësaj, rrjeti Daystar na ofroi një orar televiziv ditor, ndërsa më parë bënim vetëm një transmetim javor. Nëse do ta merrnim, faturat tona televizive do të rriteshin në rreth 200 000 dollarë në muaj. E pra, bazuar në atë fjalë profetike dhe vajosjen e Frymës së Shenjtë nga brenda, thashë po. Të gjithë më thanë se për disa muaj mund të ngeleni prapa me faturat e kohës së transmetimit derisa njerëzit të ndjekin programin tuaj. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi, por ndoshta pak më e rëndë nga sa prisnim të gjithë. Në pesë muaj, isha 500 000 dollarë prapa me faturat e kohës së transmetimit televiziv. Në fakt, blerësi ynë i kohës së transmetimit më dërgoi një email ku thuhej se avokatët e tij po nervozoheshin pak për vonesat e pagesave.

Fillova të luftoj vërtet me Perëndinë për këtë pasi transmetimi im quhet *Fixing the Money Thing (Rregullimi i çështjes së parave)*! Fillova të shkurajohesha pak dhe i thashë Drendës se mund të më duhej të shkurtoja kohën televizive. Por ajo u përgjigj: “Çfarë tha Perëndia? Ai tha se do të paguante për të, apo jo? Për disa ditë, kjo ishte gjithçka që ajo më thoshte kur flisja me të për këtë. Epo, ne u lutëm dhe megjithëse nuk kisha asnjë përgjigje në atë kohë, ndjeva paqen e Perëndisë. Atë javë, pata një ëndërr ku pashë pirgje me çeqe. Gjëja e çuditshme e kësaj ëndrre ishte se unë jo vetëm që pashë një pirg me çeqe, por pashë edhe shumat në çeqe dhe kush i plotësonte ato. Kur u zgjova e kuptova që ishin paguar faturat e kohës televizive dhe pata qetësi. Epo, atë fundjavë, një fundjavë normale mund të shtoja, 500 000 dollarë erdhën ashtu siç më zbuloi ëndrra. Shumat që pashë dhe kush i kishte plotësuar çeqet ishin të gjitha aty.

Shiko, pozitat e vështira nuk janë gjë e keqe! Janë vendi i promovimit, miku im. Njerëzit më thonë se kanë frikë të shkelin në

vende të vështira, sepse kanë frikë të bëjnë një gabim. Por Fryma e Shenjtë është në gjendje të të paralajmërojë për një gabim të mundshëm nëse e dëgjon Atë.

Më kujtohet, kur drejtoja kompaninë time hipotekore disa vite më parë, që një klient donte të merrte hua kapitalin e shtëpisë së tij për ta investuar në një kompani për të cilën unë nuk ndihesha mirë. Më kujtohet, ndërsa po ngjisja shkallët në zyrën e hipotekës, që një nga përfaqësuesit e mi

më foli për këtë. Papritur, ndjeva Frymën e Shenjtë të më thoshte se çfarë të bëja për këtë rast. Unë i thashë përfaqësuesit tim: “Mund ta bësh marrëveshjen, por lëre klientin të nënshkruajë një dokument që do të ishte pjesë e paketës së kredisë, ku thuhet se ne nuk jemi pjesë e kompanisë së investimit, por e japim kredinë vetëm me kërkesën e klientit.” Më tej ne deklarua se nuk kemi marrë asnjë përgjegjësi në lidhje me sigurinë ose performancën e investimit në fjalë, dhe as nuk kemi sugjeruar që klienti të investojë në atë kompani. Epo, rreth gjashtë muaj më vonë, e gjithë gjëja u shkatërrua. Kompania e investimeve humbi të gjitha paratë e atij klienti. U ngrit një padi kundër kompanisë së investimeve dhe kompanisë sime gjithashtu. Megjithatë, kur avokati i tyre pa letrën që e detyrova klientin tonë ta firmoste, ne u përjashtuam nga padia.

Ishte Fryma e Shenjtë që më ndaloi atë ditë në atë shkallë dhe më bëri t’i them përfaqësuesit tim ta vendoste atë dokument në paketën e marrëveshjes. Ti mund t’i besosh Frymës së Shenjtë që të të ndihmojë dhe të të udhëheqë në të gjitha llojet e situatave. Siç tha Jezusi: “Mos kini frikë”.

Unë e kam treguar këtë histori në një nga librat e mi të tjerë, por ia vlen të përsëritet në këtë diskutim. Një ditë, familja jonë po

## **MUND TË KESH BESIM TE FRYMA E SHENJTË PËR TË TË NDIHMUAR DHE UDHËHEQUR NËPËR GJITHËFARËSOJ SITUATASH.**

nisej për një fundjavë tre ditore. Të gjithë kishin hipur në furgon dhe ndërsa unë shkova për të ndezur motorin, papritmas, Fryma e Shenjtë më tha të lëvizja makinën. Unë kisha një makinë tjetër të parkuar pranë furgonit. Fryma e Shenjtë tha ta zhvendosja makinën mbi bar. Ishte shumë e çuditshme. Mendova: “Pse Fryma e Shenjtë më tha ta zhvendos makinën nga rruga mbi bar?” Nuk e kisha idenë. Por mbresa ishte e fortë! Kështu që i thashë Drendës se çfarë po bëja dhe dola dhe e zhvendosa makinën nga rruga në oborr mbi bar. Nuk e mendova shumë derisa u kthyem në shtëpi të dielën në mbrëmje. Aty ku kishte qenë makina ime tani ishte një pemë e madhe panje që kishte rënë në vendin e parkimit, pikërisht aty ku kishte qenë makina. Makina që tani qëndronte mbi bar ishte shumë mirë pasi pema nuk e kapi fare. Po të ishte atje, do të ishte shkatërruar.

Unë dhe Drenda, natyrisht, ishim shembujt tipikë se çfarë nuk duhet bërë me paratë. Por gjithçka që na duhej ishin disa strategji sekrete dhe pak mençuri sekrete për t’i kapërcyer rrethanat tona. Tani, më duhet të buzëqesh pasi programi ynë televiziv, i cili shihet në të gjithë botën titullohet *Fixing the Money Thing (Rregullimi i çështjes së parave)*!

Miku im, ja ku është fati yt sot.

*“Nga të dobët u bënë të fuqishëm, u bënë të fortë në betejë, thyen ushtritë e huaja.”* (Hebrenjve 11:34b).

Pozitat e vështira dhe të pamundura nuk janë të vështira dhe të pamundura kur e di përgjigjen!

## KAPITULLI 9

# ZËRI I QETË, I VOGËL

Kur filloj të jap mësim për zërin e Frymës së Shenjtë, shumë njerëz më thonë se nuk e kanë dëgjuar kurrë zërin e Perëndisë. Por unë gjithmonë u them atyre: «Po, e keni dëgjuar!» Nëse ndihesh njësoj si shumë njerëz, pra, që nuk e ke dëgjuar kurrë zërin e Perëndisë, atëherë të lutem kthehu te 1 Mbretërve 19:11–12.

*Perëndia i tha: “Dil dhe ndalu mbi malin përpara Zotit”.  
Dhe ja, po kalonte Zoti.”*

*Një erë e fortë dhe e furishme çante malet dhe thyente shkëmbinjtë përpara Zotit, por Zoti nuk ishte në erë. Mbas erës ra një tërmet, por Zoti nuk ishte në tërmet. Mbas tërmetit ra një zjarr, por Zoti nuk ishte në zjarr. Mbas zjarrit u dëgjua një zë, si një shushuritje e ëmbël.*

—1 Mbretërve 19:11-12

Megjithëse e kam dëgjuar zërin e Frymës së Shenjtë me shkallë të ndryshme intensiteti, zëri i zakonshëm i Frymës së Shenjtë është kjo pëshpëritje e butë. Është një zë i vogël, i qetë. Siç e kam thënë më herët në libër, zakonisht zëri i Perëndisë tingëllon si një mendim me

një tingull të ndryshëm. Ashtu siç mund ta identifikosh zërin e fëmijës tënd në një turmë, mund të fillosh ta njohësh Frymën e Shenjtë aq mirë sa të njohësh edhe zërin e Tij kur Ai flet. Por në këtë kapitull dua të flas për zërin e Perëndisë për të cilin nuk mendon askush, por që të gjithë e kanë dëgjuar.

Ndërsa isha në universitetin “Oral Roberts”, ndoqa disa kurse teologjie pasi drejtimi im ishte Dhiata e Vjetër. Kishte shumë informacione që nuk i kisha mësuar kurrë më parë; në fakt, pjesën më të madhe nuk e kisha mësuar kurrë më parë. Meqë më mungonin zakonet e studimit për shkak të braktisjes së shkollës së mesme, pata një presion të madh në përpjekje për të vazhduar, veçanërisht rreth javës së provime përfundimtare. Pikërisht në këtë lëndë duhet të shkruaja një ese mbi një temë të Dhiatës së Vjetër, që në këtë pikë nuk më kujtohet. Por shkrimi i eseve më trembte. Në fakt, në vitin e parë të universiteti, m’u desh të shkruaja detyrën time të parë dhe kur ma kthyen, në pjesën e përparme të letrës ishte një F (nota 4) e madhe me bojë të kuqe me fjalët: “Si është e mundur që ke mbaruar shkollën e mesme?” shkruar nën të. Në anglisht dhe matematikë isha aq keq, sa mësuesja u habit që kisha hyrë në ORU. Duhej të më ndihmonin në anglisht që të kaloja atë vit të parë.

E pra, me presionin e javës së provimeve përfundimtare, duhet të dorëzoja një detyrë tjetër. Oh, sa e kisha frikë atë projekt! Do të ulesha të shkruaja një detyrë, por nuk më kishin mësuar kurrë se si të shkruaja një të tillë; dhe kështu, thjesht do t’i kërkoja gjërat dhe do t’i kopjoja fjalët vetëm me pak rregullime, në mënyrë që askush të mos thoshte se e kisha kopjuar pjesën më të madhe të detyrës sime nga burime të ndryshme. Zemra ime ishte e pastër, pasi nuk e shikoja këtë si diçka të gabuar ndaj dhe e rishkrova atë që po lexoja me fjalët e mia; por çështja është se unë vërtet nuk dija si të shkruaja.

Epo, këtë herë nuk pata kohë. Një miku im në fund të korridorit bënte të njëjtën lëndë që bëja unë, përveçse në orare të ndryshme të



ditës. Të gjithë në klasë duhej të shkruanin për të njëjtën temë, kështu që e pyeta shokun tim nëse mund të shihja se si e strukturoi detyrën e tij. Por, në njëfarë mënyre, pasi mora detyrën e tij, e kuptova që nuk mund të shkruaja një punim aq të mirë sa ai dhe vendosa ta kopjoj. E di, e di, u trondite. Ki parasysh, isha vërtet një i krishterë foshnjë në këtë pikë. Epo, nuk e kopjova të gjithë detyrën e tij, por kopjova rreth gjysmën e saj drejt e në letrën time. Në fund të asaj jave të provimeve përfundimtare, ia dorëzova atë detyrë profesorit tim, i lehtësuar që shkrimi kishte mbaruar. Por më pas ndodhi diçka që më dha një mësim të vlefshëm rreth dëgjimit të zërit të Perëndisë.

Kur u shtriva në shtrat atë natë, nuk më zinte gjumi. Ndërgjegjja ime fliste aq fort sa nuk mund të flija. E kuptova se ajo që kisha bërë ishte e gabuar dhe se kisha vjedhur dhe më pas gënjyer. Gjithashtu, nuk e kisha respektuar mikun tim dhe e kisha çnderuar. Isha i dëshpëruar! Në orën 3:00 të mëngjesit zbrita në korridor në dhomën e mikut tim dhe e zgjova, i tregova se çfarë kisha bërë dhe i kërkova falje. Ai më pa me sy të përgjumur dhe më tha: “Kthehu në shtrat, Geri.” Më pas ai u rrotullua dhe vazhdoi të flinte.

Të nesërmen shkova te profesori im dhe e pranova atë që kisha bërë. Sigurisht, ishte i detyruar të më vinte një F (ekuivalent i notës 4) për detyrën, por më buzëqeshi dhe më tha se e vlerësonte që kisha shkuar për t’ia treguar. Më pas tha se, meqë kisha shkuar tek ai, do të më vinte gjithsesi një notë vjetore B për lëndën. Çfarë lehtësimi, dhe sa më mirë u ndjeva që e heshta atë zë të dënimit dhe që u çlirova dhe gjeta paqen.

Pra, më lejo të të bëj një pyetje: “Si mundej shoku im të rrotullohej në shtrat dhe të vazhdonte të flinte ndërsa isha në një agoni të tillë emocionale? Pse nuk ishte edhe ai në një agoni të tillë? Pse nuk mund të flija dhe pse isha kaq i mjerë?” Një zë më fliste sa herë që përpiqesha të flija. Po më dënonte - ishte ndërgjegjja ime! Përkufizimi i ndërgjegjes është: një njohje instinktive e së drejtës dhe të gabuarës. Fjalë për fjalë do të thotë «të dish» ose «të kesh njohuri».

Si një qiri, drita e tij shkëlqen për të ekspozuar errësirën. Ai mban një regjistër të përsosur të çdo mendimi dhe çdo vepre që ke kryer ndonjëherë. Ashtu si një dëshmitar në sallën e gjyqit, ai dëshmon për atë që është më e fshehur. Ai flet dhe të kujton të bësh atë që është e drejtë dhe të shmangësh atë që është e gabuar. Ndërgjegjja është zëri i brendshëm i Perëndisë brenda çdo personi. Ndërgjegjja thërret çdo burrë apo grua të japë llogari për veprimet e veta. Ndërgjegjja thërret çdo person, si në një sallë gjyqi, të japë llogari përpara Perëndisë. Ashtu si një dëshmitar thirret për të dhënë dëshmi, kështu ndërgjegjja jonë ose flet në emrin tonë (mbron), ose na dënon (akuzon).

Një studim i bërë nga Medical Xpress konfirmon këto fakte:

“Teoria aktuale mbizotëruese mbi zhvillimin njerëzor është se qeniet njerëzore e fillojnë jetën e tyre me një ‘gjendje morale boshe’, por hulumtimet e reja e kundërshtojnë këtë pikëpamje. Studiuesit kanë zbuluar se foshnjat e moshës gjashtë muaj bëjnë gjykime morale dhe ata mendojnë se ne mbase lindim me një kod moral të ngulitur fort në trurin tonë.”<sup>3</sup>

**NDËRGJEGJJA ËSHTË  
ZËRI I PERËNDISË NË  
ÇDO BURRË DHE GRUA,  
NJË GJURMË E KRIJUESIT  
DHE KËRKESAVE TË TIJ  
PËR TË JETUAR JETËN  
QË JEMI KRIJUAR TË  
JETOJMË.**

*Dhe nga kjo ne dimë se jemi në të vërtetën dhe do t'i bindim zemrat tona para atij; sepse, po të na dënojë zemra jonë, Perëndia është më i madh se zemra jonë dhe njeh çdo gjë. Shumë të dashur, nëse zemra jonë nuk na dënon, kemi siguri para Perëndisë; dhe ç'të kërkojmë, e marrim nga ai, sepse zbatojmë urdhërimet e tij dhe bëjmë gjërat që janë të pëlqyera prej tij..*

—1 Gjonit 3:19-22

Ndërgjegjja është zëri i Perëndisë në çdo burrë dhe grua, një gjurmë e Krijuesit dhe kërkesave të Tij për të jetuar jetën që jemi

krijuar të jetojmë. Askush nuk mund t'i shpëtojë ndërgjegjes së vet. Dikur habitësia që dikush që vriste dikë ose grabiste një bankë dhe shpëtonte, dorëzohej papritmas. Por tani e di që nuk ka mundim më të madh se një ndërgjegje që po e dënon personin si fajtor! Pali thotë te 2 Korintasve 1:12 se ndërgjegjia dëshmon, ajo flet.

*Mburrja jonë, në fakt, është kjo: dëshmimi i ndërgjegjes sonë se ne jemi sjellë me thjeshtësinë dhe sinqeritetin e Perëndisë në botë dhe sidomos përpara jush, jo me dituri mishi, por me hirin e Perëndisë.*

—2 Korintasve 1:12

Ti mund të thuash: “Me çfarë autoriteti flet ndërgjegjia? Pse do të vrente dëshmia e saj në një gjykatë shpirtërore?” Sepse është zëri i Perëndisë. Pali, përsëri, te Romakëve 2:14-15, na thotë se ndërgjegjia na flet në mënyrë aktive.

*(Në fakt kur johebrenjtë, që s'kanë ligjin, nga natyra bëjnë punët e ligjit, ata, megjithëse s'kanë ligjin, janë ligj për vetveten; këta tregojnë veprën e ligjit të shkruar në zemrat e tyre për dëshminë që jep ndërgjegjia e tyre, dhe sepse mendimet e tyre shfaqësojnë ose edhe akuzojnë njëri-tjetrin.).*

— Romakëve 2:14-15

Të gjithë kanë një ndërgjegje. Ti mund të mos jesh dakord. Mund të njohësh njerëz që duket se nuk kanë ndjenja. Por të garantoj se nuk kanë qenë kështu në fillim. Nëse një person vazhdon t'i rezistojë zërit të ndërgjegjes së tij, ai zë do të bëhet gjithnjë e më i qetë.

*“Që flasin gënjeshtër me hipokrizi, të damkosur në ndërgjegjen e tyre”*  
(1 Timoteut 4:2)

Pali po thotë se këta njerëz e kanë ngurtësuar ndërgjegjen e tyre

ose e kanë bërë veten të paaftë të ndiejnë ose dëgjojnë ndërgjegjen e tyre duke ngurtësuar zemrat e tyre kundër saj. Mendo për lëkurën tënde. Nëse e skuq, që do të thotë ta djegësh, e humbet ndjesinë derisa lëkura e re të rritet dhe lëkura e vjetër dhe e fortë të bjerë. E njëjta gjë vlen edhe për ndërgjegjen tonë. Ndërgjegjja nuk mund të të shtyjë të bësh asgjë - ajo flet. Mund ta injorosh atë ose të dalësh kundër saj. Por Pali paralajmëron se nëse e shpërfill ndërgjegjen tënde, kjo mund të të shkaktojë telashe të mëdha; ose, siç thotë Pali, të shkatërrojë jetën tënde.

*Po ta besoj këtë detyrë, o Timote bir, sipas profecive që u bënë më parë për ty, që sipas tyre të bësh luftimin e mirë, duke pasur besim dhe ndërgjegje të mirë, sepse disa, duke e hedhur poshtë, u bënë **lundërthyerje** në besim.*

—1 Timoteut 1:18-19

Në thelb, njerëzit që ngurtësohen kundër zërit të ndërgjegjes së tyre kanë humbur aftësinë e tyre për të drejtuar jetën e tyre. Busulla e tyre është dëmtuar dhe nuk funksionon më. Ata nuk e dinë se në ç'drejtim po shkojnë. Pali thotë se duhet të mbështetemi te një ndërgjegje e mirë, e pastër, për t'u siguruar që po lundrojmë në rrugën e duhur. Për shkak se mund të ngurtësojmë zemrat tona dhe të dëmtojmë aftësinë tonë për të ndjerë të drejtën dhe të gabuarën, Pali thotë se është e rëndësishme të ndjekim ligjin dhe të bëjmë atë që është e drejtë.

*“Prandaj është e nevojshme t'i nënshtroheni, jo vetëm nga druajtje e zemërimit, por edhe për arsye të ndërgjegjes” (Romakëve 13:5).*

Nëse nuk i bindesh ligjit, ndërgjegjja jote do të të dënojë. Pra, Pali po thotë t'i bindesh ligjit, të bësh atë që është e drejtë, në mënyrë që ndërgjegjja jote të mbetet e butë dhe e ndjeshme dhe të mund të veprojë ashtu siç e ka krijuar Perëndia që të veprojë, për të të mbrojtur

nga rreziku.

Në lidhje me ndërgjegjen, mund të kujtoj një tjetër marrëzi që bëra që do të ilustronjë këtë parim. Kjo ngjarje ndodhi para se të bëhesha pastor. Pasi ta dëgjosh historinë, do ta kuptosh se Perëndia nuk më kishte bërë ende pastor. Historia përfshin një makinë që dikur e kisha në pronësi. Ishte një Peugeot 505 coupe që e doja shumë. Por një ditë një djalosh më goditi nga prapa në një semafor. Trupi i bagazhit u shtyp dhe skeleti u përthye, si dhe kishte disa dëmtime të tjera në trup si pasojë e aksidentit. Agjenti i sigurimit për djalin që më goditi erdhi në fermë për të parë makinën dhe për të më dhënë një vlerësim.

Para se të të tregoj se çfarë ndodhi sapo ai mbërriti, më duhet të të them se disa javë para se të ndodhte ky aksident, marmita kishte rënë. Edhe mekanizmi i tavanit që hapet, i cili ishte në bagazh, kishte disa javë që nuk punonte përpara se agjenti të vinte për të përpunuar kërkesën. Kur agjenti i sigurimeve erdhi për të inspektuar makinën, më pyeti nëse marmita, të cilën mund ta shihnte në tokë pranë makinës (e vendosa atje që ai ta shihnte) ishte pjesë e atij aksidenti. Ndjeva një brejtje faji ndërsa thashë: “Po, zotëri”. Më pas më pyeti nëse pjesë e aksidentit ishte edhe mekanizmi i tavanit që hapet, për të cilin i thashë se nuk punonte. Përsëri, thashë: “Po”.

Në shpirtin tim, dëgjova ndërgjegjen time duke bërë titur: “Geri, çfarë po bën? Ti po gënjen!” Tani, dëgjo se si e mashtrova veten. Në fakt, më kujtohet se mendova me vete që thjesht ta injoroj atë zë, duke i thënë vetes se do të largohesha. Sot, nuk më besohet se kam menduar kështu atëherë. Ua, a nuk je i kënaqur që nuk isha bërë ende pastor kishe? Unë jam i sigurt se Perëndia ishte!

Gjithsesi, makina shkoi në oficinë dhe pas rreth një jave më thirrën të shkoja të merrja makinën. Ndërsa pashë makinën time në servis, u lumturova shumë. Ishte e përkryer! U ktheva me të në shtëpi, aq i lumtur që gjithçka ishte riparuar. Rreth një javë më vonë vendosa të kthehesha në shtëpi dhe të haja drekë me Drendën dhe fëmijët.

Shtëpia në fermë ishte vetëm rreth dy milje larg zyrës që kisha marrë me qira për kompaninë time financiare. U futa në rrugicë dhe parkova makinën pranë derës së përparme, hyra brenda dhe hëngra një drekë të mrekullueshme.

Tëksa po dilja nga shtëpia nga dera e përparme, vura re se makina ime nuk ishte aty. U hutova. Ku shkoi makina ime? Shikova përreth dhe më pas e pashë. Shtëpia jonë ishte në majë të një kodre dhe, me sa duket, kisha harruar të vendos frenën. Ndonëse nuk e kisha bërë kurrë më parë, duhet ta kem bërë në atë rast sepse ishte kthyer mbrapsht në rrugën e gjatë dhe ishte përplasur me një pemë. Kur zbrita te makina u trondita. Bagazhi ishte shtypur dhe dëmi përputhej me dëmin që ishte bërë në përplasjen nga mbrapa përpara se ta riparoja. Skeleti ishte përthyer si më parë, marmita kishte rënë dhe as mekanizmi i tavanit me hapje nuk funksiononte. Gjithçka ishte ashtu siç ishte përpara se makina të shkonte për riparim pas aksidentit.

Ndërsa qëndroja aty, krejt papritur, e kuptova dhe thjesht fillova të qesh. Perëndia po më jepte një mësim, një mësim që ky djalë predikues duhej ta mësonte përpara se të mund të drejtonte njerëzit. Nuk e riparova më makinën. Në vend të kësaj, e shita ashtu siç ishte për pjesë. Mbjaj mend vetëm një herë tjetër në jetën time kur ndërjegjija ime më kishte bërtitur shumë fort që të ndaloja. Unë e quaj historia e biçikletave.

Shpresoj se kjo po të ndihmon. E di, nuk e kishe menduar kurrë se mund të katandisesha të bëja gjëra të tilla, por gabohesh. Thjesht jam i lumtur që u shpëtova sepse kam ndjesinë që jeta ime do të kishte shkuar shumë ndryshe nëse nuk do ta kisha bërë.

Historia e biçikletës ndodhi disa vjet më vonë pas historisë që sapo tregova, dhe po, sapo kisha filluar të drejtoj si pastor kishën tonë krejt të re. Kisha shkuar me makinë në shtëpinë e babait tim një të shtunë pasdite dhe tani po largohesha, duke e nxjerrë Dodge Caravan-in e argjendtë në rrugën kryesore me dy korsi ku jetonte babai im. Shtëpia

e babait tim ishte në fund të një kodre jo shumë të përpjetë në të dy anët e rrugicës së tij të hyrjes. Për njëfarë arsye, nuk e pashë personin me biçikletë që tani po zbriste nga kodra. Unë kisha dalë ngadalë, dhe ai nuk ishte pas meje, por me vrullin e tij në të tatëpjetën, më arriti ndërkohë që po bëhesha gati të lëvizja.

Gjatë gjithë kësaj kohe nuk e kisha vënë re, por, krejt papritur, dëgjova një BAM, BAM, BAM të fortë në anë të furgonit. Pashë në pasqyrën e pasme dhe vura re një çiklist pas furgonit që kishte hequr duart nga timoni dhe më shante me gisht dhe me fjalë të rënda. Unë u befasova dhe u ofendova plotësisht që ky djalë me biçikletë po vepronte në atë mënyrë. E dija se ai mund ta kishte ngadalësuar lehtësisht shpejtësinë kur zbriti nga kodra teksa më pa që po ecja mbrapsht. E dija gjithashtu se po të kishte dashur, ai thjesht mund të kishte kaluar rreth meje me shpejtësinë e tij të plotë të zbritjes. Por në vend të kësaj, ai zgjodhi të më sfidonte.

U habita shumë që ai mendonte se mund të përballej me një makinë. Epo, mendova se dikush duhet t'i jepte një mësim këtij garipi, kështu që ngadalësova shpejtësinë dhe prita që ai t'i afrohej furgonit, pastaj shkela frenat. Ndjeva njëfarë kënaqësie duke e parë atë të kapte levat e frenave papritmas, duke u përpjekur të shmangte përplasjen me pjesën e pasme të furgonit tim. Epo, kjo e bëri të shpërthente në mallkime që nuk i kisha parë apo dëgjuar kurrë më parë. Ai thjesht po vazhdonte, dhe vazhdonte dhe vazhdonte.

Zbrita ngadalë dhe u ktheva në mënyrë që furgoni im të ishte përballë rrugës. Furgoni qëndronte në kënd, përballë çiklistit që po pedalonte në drejtimin tim. Teksa më pa duke e pritur, përballë tij me furgonin tim, ai papritmas u qetësua. Mendoj se më në fund e kuptoi se ishte me biçikletë dhe makinat janë më të mëdha se biçikletat. Ula dritaren dhe prita që ai t'i afrohej furgonit tim. Ndërsa më afrohej aty ku po rrija pa lëvizur, i bërtita që nëse do ta shihja përsëri në këtë rrugë, do ta përplasia. Me ta thënë këtë, furgoni lëvizi, tanimë që isha përballë

tij në një distancë prej rreth 4,5 metrash. Ndjeva furgonin që gërvishiti biçikletën dhe vetëm kaq. U ndjeva i shfajësuar. *Me siguri ia tregova qejfin*, mendova, por jo për shumë kohë.

Nga shpirti im, dëgjova Frymën e Shenjtë të thoshte me një zë të fortë dhe autoritar: “Geri, çfarë po bën?” Edhe të shtypura këto fjalë nuk krahasohen kurrë me mënyrën se si tingëlluan në atë moment. Papritur, kuptova se mund ta kisha vrarë atë njeri. Shikova prapa në pasqyrën time të pasme dhe ai ishte aty, duke lëvizur shumë ngadalë, me kokë poshtë dhe dukej ose i plagosur, ose thjesht i befasuar që ishte ende gjallë. Nuk jam i sigurt. Dola me makinë në rrugë, por ndërgjegjja ime nuk më la të qetë. Si pastor i ri, kuptova se çfarë mund të kishte ndodhur. Imagjinoja gazetën, “Pastori i “Faith Life Church” shkakton aksidentimin e një çiklisti për shkak të zemërimit.” Fryma e Shenjtë më kujtoi se ishte për njerëz si ai që më kishte thirrur për të hapur një kishë në atë komunitet. Në fakt u trondita nga veprimet e mia dhe u pendova para Zotit me lot.

Pra, le të biem dakord që vërtet e ke dëgjuar zërin e Perëndisë më parë. Por ti dëshiron ta mbash ndërgjegjen të butë dhe të mos lejosh që ajo të ngurtësohet, në mënyrë që të mund ta dëgjosh gjithmonë Perëndinë. Bibla thotë se populli i Izraelit e ngurtësoi zemrën kundër Perëndisë dhe nuk mundi të hynte kurrë në tokën e premtuar. Autori i Hebrenjve na paralajmëron ne, besimtarëve të Dhiatës së Re, që të mos ndjekim shembullin e tyre.

*Prandaj, sikurse thotë Fryma e Shenjtë: “Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos i ngurtësoni zemrat tuaja si në provokim, në ditën e tundimit në shkretëtirë”.*

—Hebrenjve 3:7-8

Ky paralajmërim përsëritet të paktën tri herë në kapitujt tre dhe katër. Pse ky paralajmërim? Sepse Perëndia dëshiron të të bekojë dhe dëshiron që të kesh gjithçka për të cilën pagoi Jezusi.



Të qenit zemërgur më kujton ponin e vogël që kisha kur isha djalë. Ai ishte kafsha më e egër që kisha parë ndonjëherë, dhe gjithashtu i zgjuar. Unë isha i vetmi që mund t'i hipja, ose duhet të them që guxoja t'i hipja. Mbjaj mend që një ditë më erdhi një shok që thoshte se i donte kuajt dhe mund të stërviste çdo kalë. Ai këmbënguli t'i hipte Tonit, ponit (ky ishte emri i tij). Pas njëfarë kohe, ai mundi të më bindte që ta lija ta provonte, kështu që i vura shalën Tonit. Xheki ishte emri i djalit dhe nuk do ta harroj kurrë atë që ndodhi kur ai u ul mbi atë shalë. Kur ai u ul mbi Tonin, ata ia mbathën. Toni u nis në një drejtim pa krye drejt pellgut që ishte rreth 45 metra larg shtëpisë.

**PRANDAJ, SIKURSE  
THOTË FRYMA E  
SHENJTË: “SOT, NË  
QOFTË SE E DËGJONI  
ZËRIN E TIJ, MOS I  
NGURTËSONI ZEMRAT  
TUAJA SI NË PROVOKIM,  
NË DITËN E TUNDIMIT NË  
SHKRETËTIRË.”**

—HEBRENJVE 3:7-8A

Xheki po i tërhiqte fort frerët dhe po bërtiste që poni të ndalonte, por Toni nuk i kushtoi vëmendje. Në vend të kësaj, Toni vrapoi drejt e në atë pellg dhe më pas papritur shtypi frenat me kokën ulur në buzë të ujit. Epo, sigurisht Xheki fluturoi mbi ponin e vogël drejt e në pellg. Më pas Toni u kthye mbrapsht dhe thjesht filloi të përtypte bar sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Pra, Tonit ia kishin tërhequr aq shumë frerët, saqë kjo nuk ia vriste më gojën. Atij i ishte krijuar kallo dhe ishte bërë i pandjeshëm. Si poni, Toni nuk i vlente askujt tjetër përveç meje. Pse? Sepse, siç thashë, ishte i zgjuar. Unë isha ai që e ushqente. Dhe ai mësoi se e vetmja mënyrë se si mund të dilte nga stalla në ajrin e pastër dhe barin e gjelbër që i pëlqente ta përtypte ishte të më linte ta kalëroja. Por duhet të bëja kujdes me të. Ai ecte me kokën përkulur në njëren anë, në mënyrë që të më shikonte teksa e kalëroja. Ai priste që unë ta ktheja kokën në drejtim të kundërt. Në atë moment ai do të kthehej shpejt mbrapa dhe

do të më kapte këmbën. Dhe më lejo të të them se më dhembte, kështu që bëja gjithmonë kujdes me të. Por për të qenë i dobishëm nuk ishte.

Dhe nëse lejojmë që zemrat tona të ngurtësohen, ne bëhemi të padobishëm për Perëndinë, ashtu siç ishte Toni. Një herë, e kishim Tonin të lidhur jashtë me një zinxhir. Babai im po mbushte një kovë me ujë për Tonin. Kur babai im u kthye për t'u larguar, Toni u zgjat dhe e kafshoi në të pasme. Epo, babai im nuk ishte i shpëtuar dhe ishte gjaknxehtë. Pranë kovës së ujit ishte një bllok kripe, dhe babai im e mori atë dhe e goditi ponin e vogël me të me sa fuqi që kishte. Por Toni mbijetoi. A i besova Tonit? Kurrë!

Kështu është edhe në jetën e njerëzve. Ata mendojnë se thjesht nuk do të binden, të kundërshtojnë ndërgjegjen e tyre vetëm një herë, por ajo që ata nuk e kuptojnë është se po krijojnë cikatrice sa herë që e bëjnë këtë. Një ditë, ata do të bëhen njësoj si Toni dhe nuk do të ndjejnë asnjë dhimbje apo pendim nëse zgjedhin të mos i binden Perëndisë ose të bëjnë atë që Ai thotë. Kura është të pendohesh shpejt kur kupton se ke dalë kundër ndërgjegjes sate.

Psalmi 51 u shkrua nga mbreti David pasi kishte mëkatuar me Bathshebën. Është një psalm pendimi.

*Ki mëshirë për mua, o Perëndi, sipas mirësisë sate; për dhembshurinë e madhe që ke fshiji të ligat që kam bërë. Më pastro tërësisht nga paudhësia ime dhe më pastro nga mëkati im, sepse i pranoj të ligat që kam bërë, dhe mëkati im më rri gjithnjë përpara. Kam mëkatuar kundër teje, vetëm kundër teje, dhe kam bërë atë që është e keqe për sytë e tu, me qëllim që ti të njihesh i drejtë kur flet dhe i ndershëm kur gjykon. Ja, unë jam mbrujtur në paudhësi, dhe nëna ime më ka lindur në mëkat. Por ty të pëlqen e vërteta që qëndron në thelb, dhe më mëson diturinë në sekretin e zemrës. Më pastro me hisop dhe do të jem i pastruar; më laj dhe do të jem më i bardhë*

*se bora. Bëj që të ndjej gëzim dhe ngazëllim; bëj që kokcat që ke thyer të kremtojnë edhe ato. Fshih fytyrën tënde nga mëkatet e mia dhe fshi të tëra paudhësitë e mia. O Perëndi, **krijë tek unë një zemër të pastër** dhe përtëri tek unë një frymë të patundur. Mos më largo nga prania jote dhe mos më hiq Frymën tënde të shenjtë. Kthemë gëzimin e shpëtimit dhe përkrahmë me frymë dashamirës.*

—Psalmet 51:1-12

*Ti në fakt nuk ndjen ndonjë kënaqësi në flijim, përndryshe do ta ofroja, nuk të pëlqen as holokausti. Flijimet e Perëndisë janë frymë e thyer; o Perëndi, ti nuk e përçmon zemrën e thyer dhe të penduar.*

—Psalmet 51:16-17

Davidi po i thërret Perëndisë që të krijojë tek ai një zemër të pastër, një shpirt të thyer, një zemër të penduar. Në thelb, Davidi thotë se dëshiron një zemër që mund të ndiejë përsëri. Por Davidi nuk do të kishte hyrë kurrë në ato telashe nëse do të kishte dëgjuar ndërgjegjen e tij. Pra, mbaj mend, nëse e anashkalon ndërgjegjen tënde, do ta ngurtësosh zemrën tënde dhe do të jetë më e lehtë ta bësh këtë herën tjetër, herën tjetër dhe herën tjetër derisa të mos e dëgjosh fare Perëndinë.

Ndërgjegjja është vetëm një nga mënyrat se si e dëgjojmë Perëndinë. Natyrisht, Fryma e Shenjtë na flet drejtpërdrejt me udhëzim dhe drejtim. Dhe siç thashë, kam dëgjuar Frymën e Shenjtë të më korrigjojë me një zë të lartë, autoritar, si dhe me zë të qetë e të vogël. E kam dëgjuar të flasë edhe përmes ëndrrave dhe vegimeve, të cilat do t'i trajtoj në kapitullin vijues. Por në këtë kapitull, ne kemi mësuar se nëse duam të dëgjojmë Perëndinë, duhet ta mbajmë ndërgjegjen tonë të pastër nga akuzat dhe të jemi të shpejtë në pendim për ta mbajtur atë të butë që të mund të dëgjojmë.



## KAPITULLI 10

# VEGIMET DHE ËNDRRAT

Papritmas qëndrova ulur në shtrat dhe i thashë Drendës: “Ti je shtatzënë me një vajzë!”

Nga të pesë fëmijët që kemi, vetëm një herë Perëndia na tregoi gjininë e fëmijës—Poli, e katërta. Besoj se ndodhi kështu që ta kujtonim pasi familja jonë u përfshi në një aksident me makinë kur Drenda ishte rreth gjashtë muajsh shtatzënë me Polin. Ndërsa udhëtonim me 90 km në orë në një rrugë me dy korsi, një i ri na preu rrugën. Nuk kishte kohë për të ndaluar dhe ne u përplasëm në makinën e tij. Askush nuk u lëndua rëndë, por të gjithë shkuam në spital. Drenda, duke qenë shtatzënë, u mavijos nga rripi i sigurisht dhe kjo i ndikoi në stomak. Ajo ishte e shqetësuar për Polin. Për shkak se Perëndia na kishte folur për Polin, ne ndjemë një ndjenjë paqeje dhe e dinim që Poli ishte mirë, dhe ashtu ndodhi.

Meqë ra fjala te Poli, më kujtohet kur ishte shtatzënë me fëmijën e saj të parë. Unë dhe Drenda duhej të dilnim jashtë vendit për një udhëtim pune. Fatkeqësisht, data që Poli do të lindte qëllloi pikërisht në mes të atij udhëtimi pune. Por kush e njeh gruan time, Drendën, e di se nuk do të mungojë në lindjen e një prej vajzave të saj. Kështu që ne po interesoheshim nëse duhet ta anulonim udhëtimin. Kalova pak kohë në lutje për këtë dhe Fryma e Shenjtë më foli se data e lindjes ishte gabim, se foshnja do të lindte një ditë pas kthimit tonë. I thashë Drendës atë që Zoti kishte thënë në lidhje me datën dhe e vazhduam

udhëtimin. Kur u kthyem në shtëpi, Polit i filluan dhimbjet e lindjes në datën e saktë që Zoti kishte thënë se do të ndodhte. Ajvëri, mbesa jonë e re, lindi në kohën e duhur.

Këta janë shembuj të Frymës së Shenjtë që na flet për çështjet e jetës, me fjalët e Frymës së Shenjtë që dalin nga vetë shpirtrat tanë. Por ka mënyra të tjera se si Fryma e Shenjtë na flet për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm.

*Mbas kësaj do të ndodhë që unë do të përhap Frymën tim mbi çdo mish; bijtë tuaj dhe bijat tuaja do të profetizojnë, pleqtë tuaj do të shohin ëndrra, të rinjtë tuaj do të kenë vegime. Në ato ditë do të përhap Frymën time edhe mbi shërbëtorët dhe shërbëtoret*

—Joeli 2:28-29

Profeti Joel tha se po vinte një ditë kur Perëndia do të derdhte Frymën e Tij mbi të gjithë njerëzimin. Ne jetojmë në atë kohë tani. Në ditën e Rrëshajave, Fryma e Shenjtë zbriti mbi ata që prisnin në dhomën e sipërme. Turma, pasi pa të gjithë ata që kishin qenë në dhomën e sipërme duke folur në gjuhë dhe duke lavdëruar Perëndinë, mendoi se mund të ishin të dehur dhe pyeti: «Çfarë është kjo?» Pjetri u ngrit në këmbë për t'iu drejtuar turmës.

*Por Pjetri u çua në këmbë bashkë me të njëmbëdhjetët dhe u foli atyre me zë të lartë: "Judenj dhe ju të gjithë që banoni në Jerusalem, merrni njoftim për këtë dhe dëgjoni me vëmendje fjalët e mia. Këta nuk janë të dehur, siç po mendoni ju, sepse është vetëm ora e tretë e ditës. Por kjo është ajo që ishte thënë nëpërmjet profetit Joel: "Dhe në ditët e fundit do të ndodhë, thotë Perëndia, që unë do të përhap nga Fryma ime mbi çdo mish; dhe bijtë tuaj e bijat tuaja do të profetizojnë, të rinjtë tuaj do të shohin vegime dhe të moshuarit tuaj do*

*të shohin ëndrra. Në ato ditë do të përhap nga Fryma im mbi shërbëtorët e mi dhe mbi shërbëtorët e mia, dhe do të profetizojnë.*

—Veprat e Apostujve 2:14-18

Ëndrrat dhe vegimet janë një pjesë shumë e rëndësishme e mënyrës se si na flet Fryma e Shenjtë. Nuk jam i sigurt pse Fryma e Shenjtë ndonjëherë flet me një zë të qetë e të vogël, ndërkohë që herë të tjera flet në ëndërr. Unë mendoj se pjesërisht përgjigjja është se ne të gjithë jemi shumë të zënë. Kur ne jemi të qetë, Ai është në gjendje të tërheqë vëmendjen tonë. Apo mbase për shkak se jemi në një gjendje të tillë konfuzioni ose rrethanat janë të tilla që është e vështirë të dëgjosh atë zë të qetë dhe të vogël. Fryma e Shenjtë thjesht dëshiron të sigurohet që ne do ta marrim mesazhin. Në fund të fundit, një fotografi vlen sa një mijë fjalë. Cilado qoftë arsyeja, falënderoj Perëndinë për ëndrrat dhe vegimet. Ëndrrat dhe vegimet janë të ngjashme. Të dyja janë fotografi që shohim, me ndryshimin që shohim vegime kur jemi zgjuar, dhe ëndrrat janë pamje që shohim kur jemi në gjumë.

Në lidhje me vegimet, unë kam pasur vetëm disa që do t'i quaja vegime të hapura, të cilat janë vegime ku je zgjuar dhe e sheh vegimin sikur të ishte i vërtetë. Vegimi më kuptimplotë që kam pasur ndonjëherë ishte kur u thirra për të predikuar në moshën 19-vjeçare. Isha pagëzuar në Frymën e Shenjtë rreth një muaj përpara se të ndodhte kjo. Natyrisht, kjo ishte e gjitha e re për mua pasi kisha denominacionale që frekuentoja nuk mësonte shumë mbi Frymën e Shenjtë.

Por ishte ditëlindja ime dhe më kishin ftuar të haja një darkë të këndshme me disa miq. Ndërsa u ulëm për të ngrënë, thamë faleminderit për ushqimin dhe papritmas ndjeva se Fryma e Shenjtë erdhi mbi mua shumë fuqishëm. Përsëri, unë isha i ri në këto gjëra, por nga pagëzimi në Frymën e Shenjtë e dija se si ishte kur Fryma e Shenjtë vinte mbi ty. Nuk dija çfarë të bëja në atë moment, kështu që

pyeta nëse mund të ngrihesha nga tavolina dhe dola jashtë pasi kishte një derë të jashtme menjëherë pas meje.

Ndërsa dola jashtë, prania e Perëndisë u bë edhe më e fortë dhe pashë një vegim të hapur, që do të thotë se në fakt i pashë këto gjëra njësoj sikur të shikoja diçka sot në natyrë. Pashë që po qëndroja në këmbë pas një podiumi të vogël dhe po flisja në një dhomë me njerëz. Dhoma kishte rreth 35 deri në 40 njerëz në të, të gjithë të ulur në karrige të palosshme. Mund të dalloja se ishte natë pasi jashtë ishte errësirë. Pastaj foli një zë dhe tha: “Unë po të thërras të predikosh Fjalën Time.” Kjo u përsërit tri herë, pastaj pamja u zhduk dhe vajosja u hoq. Ndërsa u ktheva në shtëpi, miqtë e mi më pyetën se çfarë nuk shkante dhe unë thashë: “Mendoj se sapo u thirra për të predikuar!”

Mbaj mend që shkova në shtëpi atë natë dhe i tregova babait tim atë që kishte ndodhur. Ai tha se predikuesit nuk fitonin shumë para. Kjo është e gjitha që ai tha. Ai nuk ishte i krishterë në atë moment, por, lavdi Zoti, ia dha zemrën Jezusit kur ishte 80 vjeç dhe tani është në parajsë.

Në këtë rast, besoj se Fryma e Shenjtë më foli në një vegim të hapur, sepse, para së gjithash, isha i ri. Ai e dinte se do të përballesha me shumë përndjekje në familjen time për shërbimin ndaj Atij dhe se kisha nevojë për atë spirancë për udhëtimin që më priste. Dhe me të vërtetë ai vegim ka vazhduar të më flasë gjatë gjithë këtyre viteve.

Një tjetër vegim i hapur që pata ndodhi në shtëpinë e vjetër në fermë ku kishim jetuar. Ne kishim jetuar në atë shtëpi ferme të vjetër e të shkatërruar për gati nëntë vjet, shumicën e asaj kohe në varfëri të tmerrshme. Por, ndërsa filluam të mësojmë se si funksiononte Mbretëria e Perëndisë, filluam të kishim mbarësi dhe shpëtuam plotësisht nga borxhi.

Ishte gjatë kësaj kohe që Perëndia e përmbushi në të vërtetë atë vegim që pata kur isha 19 vjeç kur më thirri për të predikuar. Dhe në këtë pikë, 21 vjet pasi mora atë thirrje për të predikuar, Perëndia më



tha të hapja një kishë. Deri në këtë kohë, kisha bërë universitetin dhe kisha punuar në fushën financiare për ato 21 vjet. Por tani në moshën 40-vjeçare, Perëndia më foli që të hapja kishën time.

E hapëm kishën tonë në bodrumin e një radiostacioni të krishterë dhe natën e parë që u takuam atje, ndodhi pikërisht si në vegimin që më kishte dhënë Perëndia 21 vjet më parë. Atje në shërbesën e parë, pashë të njëjtët njerëz të ulur në karrige të palosshme dhe të njëjtat dritare që ishin të errëta për shkak të kohës së mbrëmjes. Unë pashë të njëjtin podium të vogël gjithashtu.

Drenda dhe unë hapëm kishën tonë dhe ishim aq të emocionuar për Mbretërinë, saqë vërtet nuk na interesonte shumë se ku jetonim. Ne e dinim se duhej të largoheshim nga shtëpia në fermë pasi familja jonë tani ishte zgjeruar me pesë fëmijë dhe nuk kishim vend. Megjithatë, ishim aq të zënë me biznesin tonë të begatë dhe kishën, saqë ishim të lumtur.

Por një ditë kur u ktheva nga kisha, hyra në dhomën e ndenjes dhe u ula në divan. Ndërsa u ula, papritmas, dhoma rreth meje u zhduk dhe pashë të njëjtën dhomë ku sapo isha ulur, por tani pa asnjë mobilie në të. Dera nga e cila sapo kisha kaluar të nxirrte në dhomës së ngrënies dhe divani ku isha ulur ishte përballë asaj dere. Mund të shihja dhomën e ngrënies nga ku isha në dhomën e ndenjes. Pra, jo vetëm dhoma e ndenjes ishte plotësisht e zbrazët, por edhe dhoma e ngrënies ishte plotësisht e zbrazët. Vegimi zgjati vetëm rreth pesë sekonda, dhe ndërsa e shikoja, e kuptova se ishte koha të largoheshim nga ferma. Kur përfundoi vegimi, i tregova menjëherë Drendës se çfarë kishte ndodhur dhe i thashë se ishte koha për t'u larguar.

Përsëri, unë besoj se në këtë rast u përdor një vegim për të komunikuar planin e Perëndisë në mënyrë të qartë. Ne ishim të zënë dhe do të kishte qenë e lehtë të vonoheshim. Por vegimi ishte urgjent: «Është koha për t'u larguar!!!» Vetëm më vonë e kuptuam urgjencën. Ne e kishim marrë me qira shtëpinë në fermë për ato nëntë vjet dhe e

dinim se do të duhej të largoheshim kur të fillonte ndërtimi i banesave që ishte planifikuar atje, por askush nuk e dinte saktësisht se kur do të ndodhte.

Pra, për t'i rënë shkurt, Perëndia na drejtoi në një tokë të bukur ku do të ndërtonim shtëpinë tonë të re. Planet tona ishin të ndërtonim ngadalë shtëpinë pasi kishim kohë për të punuar në të, ndoshta një ose dy vjet. Megjithatë, pasi filluam të punonim në shtëpinë tonë për rreth gjashtë muaj, më telefonoi pronari ynë, i cili tha se duhej të dilnim nga shtëpia e vogël në fermë brenda një muaji. Ne i thamë se po ndërtonim një shtëpi të re dhe e pyetëm nëse mund ta zgjatnin atë për dy ose tre muaj, gjë për të cilën ai ra dakord, por pa asnjë lëshim pas kësaj.

Epo, vepruam me shumë shpejtësi dhe arritëm në shtëpinë tonë të re në fund të periudhës së shtyrjes së afatit. Nëse Perëndia nuk do të na kishte thënë të lëviznim kur na e tha, do të na duhej të lëviznim edhe disa herë gjatë asaj periudhe kohore; dhe meqë ishim shumë të zënë, do të kishte qenë problem.

Sigurisht, historia e mjegullës blu që rrëfeva në fillim të këtij libri, dhe që ishte një ngjarje që të ndryshonte jetën, ishte gjithashtu një vegim i hapur. Ishte pak më ndryshe në kuptimin që në fakt nuk po shihja një pamje të së ardhmes sime, por isha ulur atje në atë mjegull blu duke dëgjuar qartë fjalët e Frymës së Shenjtë që më thërriste të shkoja te kombet.

Jam i sigurt se kam pasur disa vegime të tjera të hapura, por ëndrrat dukej se ishin shumë më të zakonshme për mua. Kur do të shkoja në Shqipëri, rreth një javë para se të shkoja, pata një ëndërr për udhëtimin e ardhshëm. Në atë kohë të jetës sime, nuk kisha udhëtuar fare si tani; dhe përpara se Perëndia të më fliste atë ditë, nuk kam pasur kurrë interes për ta bërë këtë.

Por një javë para se të nisësja, pata këtë ëndërr. Në ëndërr, isha në zyrën e një mjeku, i shtrirë në shtratin e ekzaminimit dhe një infermiere hyri në dhomë dhe më tha se duhej të merrte pak gjak. Kështu ajo më mori dorën, dhe më mori gjak në gishtin e mesit, gjë që m'u duk e çuditshme. Por ti e di se si janë ëndrrat; ka gjëra që thjesht të dalin në ëndërr.

Dhe nga kjo ëndërr e kuptova se përpara se të largohesha nga planeti, çdo gisht do të më shpohej për të marrë gjak. Kjo më bëri përshtypje, sepse në shkollën biblike më mësuam se dora mund të përdoret për të kujtuar pesë postet në kishë: gishti i madh është apostulli, gishti tregues është profeti, gishti i mesit është ungjilltari, gishti i unazës është pastori dhe gishti i vogël është mësuesi që punon së bashku me pasturin.

Kështu e kuptova se çfarë po më thoshte infermierja. E dija që gjatë jetës sime, të paktën në një moment të jetës sime, do të mbaja secilin prej këtyre posteve në kishë. Unë jam pastor dhe mësues, sigurisht, por e di gjithashtu se mbaj një fjalë profetike për kishën në lidhje me Mbretërinë dhe financat. Për këtë më thirri Jezusi kur isha në Shqipëri. Në ëndërr shfaqej infermierja duke më shpuar gishtin e mesit, ndaj e dija se po më dërgonin ungjilltar në kombin shqiptar me Lajmin e Mirë të Ungjillit. Unë sapo kam filluar të veproj dhe të hyj në pjesën apostolike të jetës sime.

Gjithsesi, në atë ëndërr pasi shpoi gishtin e mesit, ajo m'i mori duart dhe i bashkoi si të një fëmije kur lutet, më shikoi dhe formoi me gojë fjalën "lutu". Ajo nuk e tha fjalën "lutu" me zë të lartë; thjesht e formoi atë fjalë me buzë në mënyrë të padëgjueshme. Nga ëndrra kuptova se po më dërgonin ungjilltar në kombin shqiptar dhe duhet të lutesha për atë udhëtim.

Unë kam pasur shumë ëndrra, aq shumë sa nuk mund t'i përmend këtu, por ëndrrat janë zëri i Frymës së Shenjtë. E pra, kam takuar njerëz që shohin ëndrra çdo natë dhe gjithçka është shumë "shpirtërore". Unë besoj se duhet t'i dallosh ëndrrat, sigurisht, dhe disa njerëz që janë të etur për t'u parë nga të tjerët si shpirtërorë e lejojnë veten të fryhen nga krenaria shpirtërore dhe të shohin gjëra që nuk janë nga Perëndia. Megjithatë, unë nuk shoh aq shpesh ëndrra. Çdo vit mund të shoh nga katër deri në një duzinë ëndrrash që e di se janë nga Perëndia dhe po më thonë diçka që është domethënëse. Ky numër mund të ndryshojë në më shumë ose më pak ëndrra në vit, natyrisht. Nuk mendoj se

ka ndonjë rëndësi numri i tyre, por ajo që mëson prej tyre është e rëndësishme.

Një ëndërr jetëndryshuese, e cila vërtet më ndryshoi jetën, ishte kur Zoti më tha të lija kompaninë financiare ku punoja prej tetë vjetësh dhe të hapja kompaninë time për të ndihmuar njerëzit të shpëtonin nga borxhi. Kjo ishte me siguri domethënëse.

Pastaj ka pasur ëndrra paralajmërimi. Më kujtohet një e tillë vërtet e çuditshme që ishte një paralajmërim. Ndodhi në një kohë që financat e shërbimit ishin të ulëta dhe kishte presion financiar. Në ëndërr, isha i shtrirë në shtratin tim për të fjetur. Dera e dhomës së gjumit ishte e hapur dhe dëgjova një zhurmë të lehtë në korridor (në ëndrrën time) dhe hodha shikimin drejt derës. Aty pashë një demon të vogël, rreth një metër i gjatë, duke tërhequr pas vetes një çantë prej pëlhure plot me para. Çanta dukej si një çantë që do të përdorte Babagjyshi. Demoni tërhiqte çantën nga pas, dhe çanta ishte plot, kështu që çanta po tërhiqej zvarrë nëpër tokë. Ai nuk po dilte nga shtëpia, por e dëgjova që po kthehej te cepi dhe po ngjitej për në katin e tretë. Pasi u zgjova dhe mendova për ëndrrën, kuptova se Zoti po më tregonte se fondet po vidheshin ose po humbnin.

Është interesante që në ëndërr pata një ide për sasinë e parave që ishte në çantë. Mbaj mend që mendova se ishin rreth 25 000 dollarë. Ndjeva gjithashtu se për shkak se demoni nuk doli nga shtëpia, por thjesht i çoi paratë lart, se personi ose personat që vidhnin ose lejonin që paratë të keqpërdreshin ishin pjesë e shtëpisë, dhe me shtëpi, e kuptova se bëhej fjalë për shërbimin. Epo, gjëja e parë që bëra të nesërmen ishte të telefonoja plakun e kishës dhe t'i kërkoja të kontrollonte bilancet tona në departamentin financiar. Duke vepruar kështu, gjetëm shumë shpenzime të panevojshme që ishin anashkaluar. Kur i mblodhëm këto shpenzime mujore të panevojshme, ato arritën në pothuajse 25 000 dollarë në muaj. Në e kuptuam se askush nuk po vidhte në të vërtetë, por nga neglizhenca, ato para po shpërdoroheshin, ose mund të bënim

kursim për të liruuar paratë që duheshin bërë. Ne kishim nevojë për ato para në atë periudhë pasi ishim shumë shtrënguar.

Ëndrrat mund të përdoren nga Perëndia për të të dhënë edhe strategji. Vitin e kaluar, 2018, pata një ëndërr shumë të thjeshtë, ku gjithçka që dëgjova ishin fjalët, “Thirrni anijet”. E mbajta shënim por nuk arrita që ta kuptoja. Vazhdova ta pyesja Zotin për këtë dhe nuk ia tregova askujt përveç Drendës. Në takimin e janarit me burrat, po parashtroja kërkesat e mia për atë vit. Njëri prej tyre ishte një plan mbarëkombëtar me një grup të vogël të cilin kisha vite që po e mendoja, por ndjeva se ky ishte viti për ta realizuar. Pas takimit, një nga djemtë u afrua dhe tha se i dukej mbase marrëzi ajo që kishte për të më thënë, por thjesht tha: «Zoti tha që ju jeni si Helena e Trojës». Nuk e mora vesh çfarë donte të thoshte, kështu që filloi të ma shpjegonte vetë. I kërkova të më dërgonte një email ku përsëriste atë që më kishte thënë personalisht. Këtu është emaili i tij.

## **ËNDRRAT MUND TË PËRDOREN NGA PERËNDIA PËR TË TË DHËNË EDHE STRATEGJI.**

*Mbreti i Spartës, Menelau urdhëroi 1000 anije të nisëshin për të shpëtuar gruan e tij, Helenën, nga trojanët. “Fytyra që nisi një mijë anije” është një figurë letrare e njohur dhe i referohet Helenës së Trojës.*

*Të mërkurën, më 30 janar 2019, ndërsa pastori po fliste në mbledhjen e burrave “Apex”, Zoti tha se ai ishte si Helena e Trojës, një mbret që nisi 1000 anije për të shpëtuar të humburit, të humbur në besim, të humbur në familje dhe të humbur në financa.*

*Në shërbimin e Tij,*

*Aaroni*

Ai më dërgoi një email tjetër një ditë më vonë.

*Pastor,*

*Dëshiroj të jap pikëpamjen ushtarake të Helenës së Trojës. Për shumicën e njerëzve, është historia e një mbreti që nisi 1000 anije për të shpëtuar gruan e tij të humbur nga trojanët. Por për një person që mendon në aspektin ushtarak, ky ishte një dislokim ushtarak që u quajt Operacioni “Helena e Trojës”. Çdo dislokimi ushtarak i vendoset një emër operacional. Për shembull, dislokimi kur forcat speciale të skuadrës gjashtë sulmuan kompleksin e Osama Bin Ladenit u quajt Operacioni “Shtiza e Neptunit”. Unë jam dërguar në misione me emra të ndryshëm si Operacioni “Përpara Majk”, “Elvis Marshall” dhe “Babagyshi”.*

*Operacioneve ushtarake u vendosen emra për t’i bërë më të identifikueshëm, ose për të bërë të qartë se çfarë lloj operacioni është dhe kush po e ndërmerr ose po e kryen operacionin. Kur Zoti tha se ishe si Helena e Trojës, mendja ime ushtarake e përkthen këtë si: Pastor Gary po përgatit Operacionin “Helena e Trojës”, një mision për të nisur 1000 anije për të shpëtuar të humburit, të humbur në besim, të humbur në familje dhe të humbur në financa.*

*Për më tepër, kur dëgjoj për dislokimin e 1000 anijeve, mendoj gjithashtu për numrin e ushtarëve, stafin mbështetës, trajnimin, logjistikën dhe proceset administrative që duhen për të dislokuar secilën anije. Nuk ka njeri më të aftë për të komanduar këtë forcë dhe për ta vendosur këtë ushtri për Mbretërinë e Perëndisë sesa ju. Ju keni shpenzuar vite duke na trajnuar për këtë moment. Familja ime, dhe jam i sigurt se*

*edhe pjesa tjetër e Trupit, është e gëzuar që do të marrë pjesë.  
Në shërbimin E Tij,*

*Aaroni.*

Aaroni ishte një pjesëtar i forcave speciale (Navy Seal) dhe shkoi në 9 misione gjatë 21 viteve të shërbimit të tij në ushtri. Ai ka një histori të mrekullueshme të një transformimi rrënjësor nga fuqia e Kryqit. Ai nuk dinte asgjë për atë që Zoti më kishte thënë në ëndërr, për të thirrur anijet. Por «fjala e tij e njohurisë» më konfirmoi se e kisha dëgjuar saktë dhe më ndihmoi të nisesha në rrugën që Perëndia kishte për mua. Synimi ynë është të krijojmë 1000 grupe të vogla mbarëkombëtare për të ndarë lajmin e mirë të Mbretërisë. Nëse dëshiron të jesh pjesë e asaj ushtrie, më kontakto përmes faqes sime të internetit, Garykeese.com.

Mendoj se e kuptove idenë. Ëndrrat janë një mënyrë e fuqishme se si Perëndia i flet popullit të Tij, duke e ndihmuar atë me drejtim, strategji, paralajmërim dhe ngushëllim.

Përpara se të përfundojë ky kapitull, do të doja të shtoja një metodë tjetër që Perëndia përdor për të ndihmuar në drejtimin e strategjisë, dhe kjo është dhurata e profecisë. Aaroni mori atë që quhet një fjalë e njohurive në lidhje me planet e mia për të nisur një iniciativë të re. Fjala e njohurisë është pikërisht ashtu siç e ka emrin, një fjalë njohurie. Kjo është njohuri që të jepet nga Fryma e Perëndisë, diçka që ti nuk mund ta dije vetë. Fjala e njohurisë renditet në 1 Korintasve 12 si një nga nëntë dhuntitë e Frymës së Shenjtë. Tani, qëllimi im nuk është të jap mësim për ato dhunti shpirtërore në këtë libër, por dua të përmend njërën prej tyre, fjalën e profecisë.

Kaq shumë njerëz e ngatërrojnë jetën e tyre për shkak të një keqkuptimi të kësaj dhuntie, saqë mendoj se duhet ta përmend. Kur njerëzit mendojnë për profecinë, ata mendojnë për një profet që i thërret dhe u drejton gishtin në fytyrë dhe u thotë diçka të tillë: “Ti

duhet të shkosh në Afrikë” ose “Ti je thirrur për të qenë pastor”. Të dyja këto pohime mund të jenë një paraqitje e saktë e profecisë së vërtetë, por të dyja mund të jenë gjithashtu krejtësisht të gabuara. Kjo varet nga mënyra se si i lexon ato. Nëse këto pohime lexohen si udhëzuese, atëherë të dyja do të ishin të gabuara, por nëse lexohen si pohuese, mund të jenë të sakta. Pali shpjegon qëllimin e profecisë.

*Kurse ai që profetizon, u flet njerëzve për ndërtim, për nxitje e përdëllim(1 Korintasve 14:3).*

**“KURSE AI QË  
PROFETIZON, U  
FLET NJERËZVE PËR  
NDËRTIM, PËR NXITJE  
E PËRDËLLIM.”**

**—1 KORINTASVE 14:3**

Ja ku është. Nuk ka asnjë fjalë në këtë varg që tregon se ti duhet të gjesh drejtim përmes profecisë, por kjo është mënyra se si shumica e njerëzve e shohin profecinë, sikur ajo jep drejtim. Por sipas Palit, profecia është vetëm për të konfirmuar drejtimin, jo për të dhënë drejtim. E pra, sapo të lindësh përsëri, Fryma e Shenjtë brenda teje do të jetë Ai që do të të thotë se çfarë të bësh. Ti nuk ke nevojë që një burrë ose një grua të të thotë se çfarë je thirrur të bësh për Jezusin. Por një fjalë profetike mund të konfirmojë diçka që ti tashmë e di.

Kështu për shembull, në shembullin që dhashë, “Ti duhet të shkosh në Afrikë», thashë se mund të ishte një shembull i vërtetë i një fjale profetike, nëse Fryma e Shenjtë ta kishte thënë më parë dhe po e konfirmonte atë nëpërmjet asaj fjale. Por nëse nuk kishe ndërmend të shkoje në Afrikë dhe kjo ishte hera e parë që e dëgjoje këtë, atëherë ky nuk do të ishte një shembull i vërtetë i fjalës së profecisë në kishën e Dhiatës së Re.

Është e pabesueshme ajo që i dëgjon njerëzit të thonë. Ndodh që më afrohen të krishterë dhe më thonë: “Perëndia më tha në një



mbledhje se unë duhet të kem mbarësi.” Epo, nuk ishte e nevojshme të ta thoshte dikush se do të kesh mbarësi; këtë na e thotë Bibla. Unë shoh të krishterët që shkojnë sa andej-këndej duke i pyetur njerëzit nëse kanë një fjalë për ta. Nuk ke nevojë që dikush të të thotë një fjalë! Fryma e Shenjtë brenda teje do të të flasë dhe, po, Perëndia mund të dërgojë një fjalë profetike pohimi për të të inkurajuar, por jo për të të udhëhequr.

Shembulli më dramatik i një ndodhie të tillë në jetën time ishte kur dilja me Drendën. Doja të takoja familjen e saj në Xhorxhia për t'i kërkuar dorën për martesë. Ndërsa isha atje, do të vizitoja bashkë me të kishën ku ishte rritur. Në atë kohë, sapo më kishin ofruar një punë në industrinë e shërbimeve financiare për të cilën isha i pavendosur. Në moshën 19-vjeçare kisha marrë thirrjen për të predikuar dhe sapo kisha mbaruar universitetin me një diplomë në Dhiatën e Vjetër, megjithatë u ndjeva i detyruar ta pranoja këtë punë në fushën e financave. Isha i paqartë se çfarë të bëja.

Pas shërbesës së të dielës në mëngjes në kishën e Drendës, një grua që nuk e njihja, por Drenda me siguri e njihte, erdhi drejt meje dhe tha se donte të më thoshte një fjalë. Ajo tha: “Ti je duke shqyrtuar një ofertë pune. Puna ka 10 aspektet e mëposhtme, dhe ajo përmendi ekzaktësisht atë që do të bëja në atë punë të re.” Ajo tha: “Ti duhet ta pranosh këtë punë dhe Zoti është në të». Në këtë rast, e kisha ndjerë tashmë se duhet ta pranoja punën, por isha i hutuar se pse ndihesha kështu. Fjala e saj profetike më solli ngushëllim dhe inkurajim dhe më konfirmoi drejtimin që duhet të ndiqja. E përsëris, Fryma e Shenjtë në ty do të të udhëheqë dhe do të jetë Këshilltari yt



## KAPITULLI 11

# FRYMA E SHENJTË FLET SI SHEFI IM

Unë kisha një familje në kishën time, kur ishte e vogël, që kishte nevojë për punë. Ata ishin një familje e bukur dhe gjithmonë donin të ndihmonin në kishë. Por dukej se gjithmonë kishin probleme me paratë. Epo, kryefamiljari ishte përsëri pa punë, kështu që vendosa t'i ndihmoj ata. Në atë kohë po ndërtoja shtëpinë time dhe i bëja vetë të gjitha punimet elektrike. Mësova se kryefamiljarit i vinte ndoresh për punimet elektrike dhe i ofrova ta paguaja për disa orë me kohë të pjeshme, sepse familjes së tij po i mbaronte ushqimi. Kështu ai erdhi dhe bëri një punë të mirë me instalimet elektrike që i kisha dhënë për të bërë.

Më pas nuk u mendova më për të, por rreth një muaj më vonë, mora një telefonatë nga ky zotëri. Ai tha se disa njerëz ishin mbledhur bashkë për t'u lutur për mua. Unë thashë: “Po për çfarë?” Ai tha se kishte vetëm disa gjëra në kishë që duheshin ndryshuar dhe vazhdoi të thoshte se kishte një listë me 10 pika që ata i kishin diskutuar. E para në listë ishte se shtëpia ime ishte shumë e madhe. Ai më pyeti troç se sa më paguante kisha për të përballuar një shtëpi të tillë. Iu përgjigja menjëherë se kisha nuk po më paguante asnjë qindarkë, se nuk merrja një rrogë nga kisha. Pasi i thashë këtë, pati një heshtje të gjatë. Pastaj ai tha: “Kisha nuk ju paguan rrogë?” “Ashtu është,” u përgjigja. Përsëri

pati heshtje derisa më në fund tha. “Epo, mbase duhet ta bëjnë.” Dhe ky ishte fundi i bisedës.

Epo, rreth një javë më vonë dëgjova për një ofertë pune në një kompani që mendova se mund të ishte në fushën e tij të interesit, kështu që i tregova për këtë. Ai shkoi dhe aplikoi dhe e fitoi vendin e punës. Mos harro një gjë, familja e tij do të dëbohej nga shtëpia e tyre në atë kohë. Kështu që kur javën që ai e fitoi punën, erdhi në kishë dhe më tha se e la, u shtanga. “E le; pse?” Ai më tha se të premten pasdreke ishin mbrapa me punët e javës dhe i kishin kërkuar të fshinte dyshtemenë. Ai më tha se në atë moment kishte dhënë dorëheqjen, duke u thënë atyre se nuk kishte firmosur për të fshirë dyshtemetë. Nuk mund ta besoja atë që po dëgjova. E kuptova se ky i ri duhet të mësonte me pahir nëse donte të kishte sukses në jetë. Gjithmonë më vinte keq për gruan e atij djalit. Ata u larguan nga kisha menjëherë pas kësaj dhe nuk e di se çfarë ndodhi me ta. Megjithatë, mendoj se mund të bëj një hamendësim të saktë. Bazuar në qëndrimin e tij arrogant dhe mungesën e vullnetit për të punuar, mund të supozoj se rezymeja e tij përmbante shumë punë të reja, shumica prej tyre për kohëzgjatje të shkurtër. Niveli i tij i begatisë do të ketë qenë kryesisht ai i mbijetesës. Tani, mos më keqkupto. Njerëzit ndryshojnë, dhe unë sigurisht shpresoj për hir të tij që ai ka ndryshuar. Por këtë e di, se kur e njoha, ai po shkonte në drejtimin e gabuar. E pra, ai po e shpërfillte zërin e Perëndisë.

Ti mund të pyesësh: “Për cilin zë të Perëndisë e ke fjalën?” Jam i sigurt se këtë përgjigje do të të thoshte po ta pyesje, sepse në atë kohë ai nuk e kishte idenë. Por ai po liste pas dore një nga metodat kryesore të Perëndisë për të trajnuar dhe përgatitur njerëzit për fatet e tyre: të mësuarit e nënshtrimit. E di që titulli i këtij kapitulli mund të të ketë ngatërruar. Çfarë lidhje do të kishte shefi im me Frymën e Shenjtë? Në këtë kapitull do të zbulosh se shefi yt ka shumë të bëjë me aftësinë tënde për të dëgjuar Frymën e Shenjtë!

Dua të filloj studimin tonë për këtë temë jetike te Mateu 8:5-10

*Kur Jezusi hyri në Kapernaum i erdhi një centurion duke iu lutur, dhe duke thënë: “O Zot, shërbëtori im rri shtrirë në shtëpi i paralizuar dhe po vuan shumë”.*

*Dhe Jezusi i tha: “Do të vij dhe do ta shëroj”.*

*Centurioni duke u përgjigjur i tha: “Zot, unë nuk jam i denjë që ti të hysh nën strehën time; por thuaj vetëm një fjalë dhe shërbëtori im do të shërohet. Sepse unë jam një njeri nën urdhrin e të tjerëve, dhe i kam ushtarët nën vete; dhe, po t'i them dikujt: “Shko”, ai shkon; dhe po t'i them një tjetri: “Eja”, ai vjen; dhe po t'i them shërbëtorit tim: “Bëje këtë”, ai e bën”.*

*Dhe Jezusi, kur i dëgjoi këto gjëra, u mrekullua dhe u tha atyre që e ndiqnin: “Në të vërtetë po ju them, se askund në Izrael nuk e gjeta një besim aq të madh.”*

—Mateu 8:5-10

Pse ky njeri besoi kaq lehtë se Jezusi mund ta shëronte shërbëtorin e tij? Kësaj pyetjeje i përgjigjet vetë ai. *Sepse unë jam një njeri nën urdhrin e të tjerëve, dhe i kam ushtarët nën vete; dhe, po t'i them dikujt: “Shko”, ai shkon; dhe po t'i them një tjetri: “Eja”, ai vjen; dhe po t'i them shërbëtorit tim: “Bëje këtë”, ai e bën.* Ishte kështu sepse ai e dinte se si funksiononte autoriteti. Ashtu si ai kishte eprorë, ashtu edhe njerëzit e tij ishin nën autoritetin e tij. Ai e kuptonte që fjala e shefit të tij dukej si zëri i Cezarit. Në fakt, e vërteta është se zëri i shefit të tij ishte zëri i Cezarit. Ai gjithashtu e kuptoi se zëri i tij shërbëtorëve të tij u dukej si zëri i Cezarit për ta. Kështu funksionon autoriteti. Pra, ngaqë e kuptonte se çfarë do të thoshte të jesh nën autoritet, ai e kuptoi lehtësisht se si Jezusi mund të vendoste autoritetin mbi atë situatë thjesht duke i

folur. Kjo ishte gjithçka që duhej të bënte edhe ai. Nëse ai i fliste një shërbëtori për të bërë diçka, ai e bënte. Ishte kaq e thjeshtë. Ja një e vërtetë që duhet ta mësosh:

### **TI MUND TË ECËSH ME AUTORITETIN VETËM NËSE I JE NËNSHTRUAR AUTORITETIT!**

Nëse Satani mund të heqë çdo respekt për autoritetin dhe t'i bindë të gjithë se mund të bëjnë çfarë të duan kur të duan, atëherë bota do të shembet në kaos dhe rrënim. Kjo ishte ajo me të cilën ai po e sfidonte Evën në Kopsht: "A tha vërtet Perëndia...?" Dëgjo, çdo individ në këtë planet është nën autoritet ose nën autoritete të ndryshme. Njohja se nën autoritetin e kujt je, do të të ndihmojë të dish se kë duhet të dëgjosh dhe kë jo. Por sot të gjithë duan të kenë autoritet pa qenë nën autoritet dhe kjo është e pamundur.

Kohët e fundit, fola me një kontraktor i cili po më tregonte se si i paguan njerëzit me para në dorë për të shmangur taksat dhe tarifat e kompensimit të punëtorëve. Por unë tashmë e di se si do të jetë përfundimi i kësaj. Një ditë, një punonjës do të lëndohet dhe do të bëjë kërkesë për kompensim dhe më pas do të zbulojë se shefi nuk ka paguar kurrë asnjë qindarkë për programin e detyruar të kompensimit të punëtorëve dhe ai do ta padisë kontraktorin sepse ligji kërkon që të paguhet kompensimi i punëtorëve. Mua më ka ndodhur pikërisht kjo histori në kishën time me disa kontraktorë.

Javën e kaluar fola me një grua që tha se nuk kishte nevojë për pastor; ishte vetëm ajo dhe Fryma e Shenjtë. Vërtet? Epo, ajo bënte mirë të shkonte dhe të fliste me Jezusin për këtë, sepse Jezusi është Ai që emëroi pastorë dhe ngriti kishën lokale në kapitullin 4 të Efesianëve. Nëse i është nënshtruar Jezusit, atëherë ajo do të ndjekë autoritetin që vendosi Jezusi. Fakti është se ajo nuk i është nënshtruar Jezusit dhe dëshiron të veprojë me mendjen e saj. Ajo ka shumë të ngjarë të bjerë në mashtrim dhe kohë të vështira për shkak të saj.

Jo shumë kohë më parë, fola me një shitës i cili po krijonte

kompaninë e tij të shitjeve dhe po merrte me vete të gjithë klientët e kompanisë ku punonte, edhe pse kishte nënshkruar një deklaratë të mospërfshirjes në konkurrencë ku thuhej se nuk do ta bënte këtë. Ai mendon se do të ketë sukses duke vepruar në këtë mënyrë? Kjo është thjesht vjedhje!

E di që mund të mos të të pëlqejë ky kapitull aq shumë sa të tjerët ku kam paraqitur gjërat e mbinatyrshe dhe të lezetshme që bën Fryma e Shenjtë, por nëse nuk e kupton mirë këtë kapitull, mund të harrosh të gjithë pjesën tjetër sepse është Perëndia Ai që nxit.

Më kujtohet koha kur një grua erdhi tek unë në një mbledhje lutjeje dhe ishte e përlotur, duke më pyetur pse nuk e thirra të lutej. Unë u trondita! Pse ishte kaq gjë e madhe që të thirrej për t'u lutur, përveç nëse, sigurisht, ekzistenca e saj ishte për sytë e të tjerëve?

Dhe, sigurisht, mund t'ia kisha thënë për një minutë se përse nuk e thirra, nëse ajo do të dëgjonte ndonjëherë dikë. Kjo grua nuk e respektonte burrin e saj dhe vazhdimisht e fyente për mungesën e frymës sa herë që bëheshin thashetheme. Prandaj nuk e thirra. Fakti që ajo u përlot ngaqë nuk shihej si gruaja shpirtërore që mendonte se ishte para gjithë grupit, zbuloi se ajo nuk e respektonte autoritetin dhe, si rrjedhim, ishte një grua e rrezikshme.

**TË DALLOSH SE  
NËN AUTORITETIN  
E KUJT JE TË  
NDIHMON TË DISH  
SE KË DUHET TË  
DËGJOSH DHE KË  
NUK DUHET TË  
DËGJOSH.**

Kështu që më lejo të të bëj një pyetje. A je i kualifikuar për të shkuar atje ku dëshiron të shkon, atje ku duan të arrijnë ëndrrat e tua? Nëse do të pyesja pastorin ose shefin tënd se cili ishte mendimi i tyre i sinqertë për ty, çfarë do të thoshin? E pra, nuk mund të kesh autoritet pa kaluar testin e nënshtrimit. Nuk e thashë unë këtë, e tha Jezusi.

*Kush është besnik në të vogla, është besnik edhe në të mëdhatë; dhe kush është i padrejtë në të vogla, është i padrejtë edhe në të mëdhatë. Pra, në qoftë se ju nuk keni qenë besnikë në pasuritë e padrejta, kush do t'ju besojë pasuritë e vërteta? Dhe, në qoftë se nuk keni qenë besnikë në pasurinë e tjetrit, kush do t'ju japë tuajën?*

—Luka 16:10-12

### **A mund të të besohet një pozitë autoritare? Provat gjendet në nënshtrimin tënd.**

Le të hedhim një vështrim në një histori në Bibël e cila mund të ketë një ndikim të thellë në suksesin që ke në jetë.

*Edhe Filistejtë u mblodhën për të luftuar kundër Izraelit, me tridhjetë mijë qerre, gjashtë mijë kalorës dhe shumë njerëz, si rëra në bregun e detit. Ata u nisën pra, dhe u vendosën në Mikmash, në lindje të Beth-Avenit. Kur Izraelitët e panë se ishin në rrezik (pse populli u gjend ngushtë), u fshehën në shpella, në gëmusha, ndër shkëmbinj, në guva dhe në hauze. Disa Hebrej kaluan Jordanin për të vajtur në vendin e Gadit dhe të Galaadit.*

*Sauli ishte akoma në Gilgal dhe tërë populli shkonte pas tij duke u dridhur. Ai priti shtatë ditë sipas kohës së caktuar nga Samueli; por Samueli nuk po vinte në Gilgal dhe populli kishte filluar të shpërndahet larg tij. Atëherë Sauli tha: “Më sillni holokaustin dhe flijimet e falënderimit”. Pastaj ofroi olokaustin.*

—1 Samuelit 13:5-9

*Atëherë Samueli i tha Saulit: “Ti ke vepruar pa mend; nuk ke respektuar urdhërimin që Zoti, Perëndia yt, të kishte dhënë. Në fakt Zoti do të vendoste për gjithnjë mbretërinë*



*tënde mbi Izraelin. Tani përkundrazi mbretëria jote nuk ka për të vazhduar, **Zoti ka kërkuar një njeri sipas zemrës së tij, dhe Zoti e ka caktuar princ të populli të tij**, sepse ti nuk ke respektuar atë që Zoti të pati urdhëruar”.*

—1 Samuelit 13:13-14

Sauli u skualifikua sepse nuk iu nënshtroi autoritetit. Pra, përsëri ne shohim se, nëse nuk mund t'i nënshtrohesh autoritetit, nuk mund të kesh autoritet. Këtu dua të theksoj një pikë shumë të rëndësishme. Zoti do të kërkonte një njeri sipas zemrës së tij. Çfarë do të thotë «sipas zemrës së tij»?

*Pastaj Perëndia e hoqi dhe u ngjalli atyre si mbret Davidin, për të cilin dha dëshmi duke thënë: “Kam gjetur Davidin, birin e Jeseut, njeri sipas zemrës sime, **i cili do të zbatojë të gjitha vullnetet e mia**”.*

—Veprat e apostujve 13:22

Si e përcakton Perëndia që dikush është sipas zemrës së tij? Në thelb, është dikush që urren atë që urren Perëndia dhe e do atë që do Perëndia, dikush që do të bëjë atë që do të kishte bërë Zoti po të ishte atje. Me fjalë të tjera, nëse Perëndia e urren mëkatin, ai e urren mëkatin. Nëse Zoti dëshiron të bëjë diçka, ai dëshiron ta bëjë atë gjë. Në botën tonë, ne mendojmë se dikush sipas zemrës së vetë Perëndisë është dikush që ka dhuntinë më shpirtërore. Ne mendojmë se të qenit shpirtëror është muzikë e butë adhurimi. Por Perëndia thotë qartë se adhurim shpirtëror është të jesh i bindur.

*Por Samueli i tha: “Ndoshta i pëlqejnë Zotit olokaustet dhe flijimet si bindje ndaj zërit të Zotit? Ja, bindja është më e mirë se flijimi; dhe të dëgjosh me kujdes është më mirë se dhjami i deshve. Sepse rebelimi është si mëkati i shortarisë dhe*

*kryeneçësia është si kulti i idhujve dhe i perëndive shtëpiake. Duke qenë se ke hedhur poshtë fjalën e Zotit, edhe ai të ka hedhur poshtë si mbret.”*

—1 Samuelit 15:22-23

Pra, përsëri, më lejo të them se zëri i Perëndisë tingëllon si shefi yt! Perëndia po lejon që përgjigja jote ndaj autoritetit të testohet kur askush nuk e di emrin tënd. Shumica e njerëzve thjesht nuk e kuptojnë se si funksionon e gjithë kjo. Ata nuk e shohin punën e tyre të vogël me kohë të pjesshme si të rëndësishme; nuk është asgjë e rëndësishme. Por ajo që nuk dinë është se ata po e trajtojnë veten të kenë nënshtrim subjektiv, të gjykojnë sipas standardeve të tyre nëse diçka është e denjë për t'iu nënshtruar bazuar në dëshirat dhe qëllimet e tyre. Njerëzve nuk po u mësohet se në momentin që pranojnë një detyrë ku u jepet besim, të punojnë atë punë të vogël me kohë të pjesshme, ata pranojnë të punojnë sikur biznesi të ishte i tyre. Shumica e njerëzve nuk i shohin gjërat kështu. Ata synojnë qëllime më të mëdha. Në fund të fundit, kjo është vetëm një punë me kohë të pjesshme për disa para shtesë, jo një punë e rëndësishme. Gabim!!!!

## **PRA, PËRSËRI, MË LEJO TË THEM SE ZËRI I PERËNDISË TINGËLLON SI SHEFI YT!**

Nuk ekziston puna e parëndësishme. Nuk ka detyra të vogla. Davidi kishte një punë të vogël, të parëndësishme, të kujdesej për delet. Por nuk ishte e parëndësishme për të; ai rrezikoi jetën e tij të paktën dy herë për të mbrojtur ato dele. Me fjalë të tjera, besimin që i është dhënë ai e mori me shumë seriozitet. Edhe pse askush tjetër nuk e dinte se kush ishte, Zoti e dinte! Dhe Perëndia e dinte saktësisht se ku ishte në çdo kohë.

Perëndia e di edhe se ku je ti, dhe e njeh si është zemra jote ndaj autoritetit. Në fund të fundit, nëse nuk mund t'i nënshtrohesh një personi që mund ta shohësh, nuk do t'i nënshtrohesh Perëndisë, të cilin

nuk mund ta shohësh. Shumë njerëz që shoh unë kanë një mentalitet të drejte, një mentalitet viktimë; është gjithmonë faji i dikujt tjetër. Ata gjithmonë thonë se ishte faji i shefit, faji i qeverisë, bëjnë vetëm minimumin e nevojshëm, punojnë vetëm kur janë të detyruar. Ata zakonisht kanë një mentalitet përpunues, që duhet t'u thuhet se çfarë të bëjnë në vend që t'u shkojë mendja vetë. Kështu ndodhi me bijtë e Izraelit, të cilët, të dalë nga skllavëria, vazhduan të mendojnë si skllavër edhe pse u liruan. Mentaliteti i tyre prej skllavi nuk do të funksiononte kur të përballëshin me gjigantët e tokës. Perëndisë iu desh t'i stërviste për të arritur suksesin para se t'i afroreshin vendit. Atij do t'i duhet të stërvitë edhe ty para se t'i afroresh vendit. Vendi për të cilin po flas është fati yt. Pra, a i trajnoi Ai ata?

*Kështu, pra, ai të bëri të ulesh kokën, të provosh urinë, pastaj të ka ushqyer me mana që ti nuk e njihje dhe as etërit e tu s'e kishin njohur kurrë, me qëllim që ti të kuptosh se njeriu nuk rron vetëm me bukë, por rron me çdo fjalë që del nga goja e Zotit.*

—Ligji i përtërirë 8:3

*Dhe që në shkretëtirë të ka ushqyer me manë të cilën etërit e tu nuk e njihnin, **për të të përrulur dhe për të të vënë në provë dhe së fundi për të të bërë të mirë.***

—Ligji i përtërirë 8:16

Perëndia i përruli ata, që do të thotë i bëri të pamjaftueshëm, të etur për ndihmë. Ata duhej të mësonin të mbështeteshin te Perëndia dhe jo te vetja. Ata i prisnin beteja më të mëdha sesa thjesht gjetja e ushqimit për të ngrënë. Kishte gjigantë dhe qytete me mure përpara tyre që do t'i frikësonin lehtësisht nëse nuk e shihnin Perëndinë më të madh se problemi i tyre.

Së dyti, ata do të duhet të mësojnë të bëjnë zgjedhjet e duhura vetë pa qenë të detyruar ta bëjnë këtë. Sot, shoh që prindërit bëjnë gabim duke u përpjekur të stërvitin performancën e fëmijës së tyre në vend të zemrës së tyre. Një fëmije i thuhet të pastrojë dhomën e tij dhe më pas përplas derën me inat ndërsa bindet, por e bën detyrën me zemër rebelimi dhe jo me zemër nënshttrimi. Prindërit që duan të jenë miq me fëmijët e tyre do të hyjnë dhe do të shohin dhomën e pastër dhe më pas do t'i tregojnë fëmijës se sa punë të shkëlqyer kanë bërë. E gabuar. Fëmija u bind së jashtmi por jo së brendshmi. Nënshttrimi është funksion i zemrës. Një ditë, prindi nuk do të jetë aty për të imponuar zgjedhjen e duhur. Kur prindi të mos e mbulojë më, fëmija do të jetë i lirë të bëjë si të dojë. Ajo që është në zemër tani do të ekspozohet. Kjo është ajo ku shumë prindër e gjejnë fëmijën e tyre në telashe dhe habiten, duke thënë se Xhoni i vogël ishte gjithmonë një fëmijë shumë i mirë, si dhe tronditen me sjelljen e tij kur shkon në universitetin ose del në shtëpi më vete.

Bibla thotë se Perëndia do ta vinte në provë Izraelin që ata të kishin mbarësi fund. Pikërisht për këtë po flasim. Ndryshe nga prindi që shqetësohet më shumë për t'u pëlqyer nga fëmija, Zoti është i shqetësuar për mirëqenien afatgjatë të fëmijës. Ai do të korrigjojë qëndrimet e vogla të zemrës përpara se ato të bëhen sjellje kronike. Kjo është ajo që nënkuptohet kur thuhet se Perëndia do t'i vinte në provë ata. Perëndia do të mund t'i korrigjonte ata pasi qëndrimi i zemrës do të zbulohet kur do t'ju kërkoj të nënshtroheshin.

Të gjithë duhet të kalojnë provën e nënshttrimit! Pra, ku na stërvit Perëndia sot pasi nuk ka shkretëtirë për të kaluar? Ku mund ta dëgjojmë zërin e Tij që të mund të mësojmë nënshttrimin dhe të kualifikohemi për promovimin tonë të ardhshëm? E mban mend atë që tha Perëndia për Saulin? Bindja është më e mirë se sakrifica. Veprimet e tua të jashtme të adhurimit në kishë nuk janë baza e promovimit tënd të ardhshëm. A mund të ta besojë Perëndia autoritetin? Ku fillon kjo? Shtëpia.

*Fëmijë, binduni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë. “Ndero babanë tënd dhe nënën tënde,” ky është urdhërimi i parë me premtim, “që ti të jesh mirë dhe të jetosh gjatë mbi dhe.”*

—Efesianëve 6:1-3

Pse bindja ndaj prindërve do të bënte që të kesh një jetë të gjatë dhe të suksesshme? A të jep Perëndia pikë për bindjen? Jo, por nëse mëson të respektosh dhe nderosh prindërit e tu, autoritetet në jetën tënde, atëherë do të nderosh dhe respektosh Zotin. Nëse e respekton autoritetin e Perëndisë në jetën tënde, do t’i bindesh Atij dhe gjërat do të shkojnë mirë për ty. Kështu që mund të them se Perëndia tingëllon si prindërit e tu kur je më i ri dhe nën kujdesin e tyre.

Vendi i dytë ku Perëndia do të të stërvitë për t’iu nënshtuar autoriteteve është duke u vendosur nën autoritete njerëzore. Shefi yt, pastori yt, oficeri i policisë dhe qeveria janë të gjithë shembuj të autoriteteve të cilëve Perëndia na udhëzon t’i nënshtrohemi.

Më kujtohet një familje në kishën tonë që gjithmonë dukej se ankohej dhe fliste për problemet e veta. Ata sa nuk po e humbnin shtëpinë e tyre dhe u duheshin 10 000 dollarë për të bërë pagesat dhe për të shmangur konfiskimin. Ata duhet t’ua kenë treguar historinë e tyre dhjetëra njerëzve në kishë. Më në fund, një familje vendosi t’i ndihmonte dhe u dha 10 000 dollarë. Por brenda pak muajsh, ata u kthyen aty ku ishin në fillim dhe e humbën shtëpinë. Kisha folur me këtë çift, të dy të papunë, për situatën. U sugjerova që të paktën të bënin diçka ndërsa prisnin që të gjenin punët e duhura. Ata mund të kishin punuar në çdo restorant të qytetit, por më thanë se ato lloj pune nuk ishin për ta. Mendoj se është e qartë se problemi i tyre nuk ishte ai financiar, por ai i të kuptuarit të autoritetit dhe përgjegjësisë. Për disa arsye, ata nuk arritën të kuptonin se kishin një përgjegjësi personale për të marrë autoritetin mbi jetën e tyre dhe për të bërë gjithçka që duhej për ta zgjidhur problemin.

Rik Rener, një miku im, thotë se përpara se të punësojë dikë, ai kërkon të shohë makinën e tij, ose ndonjëherë do të kalojë nga shtëpia e personit pa e lajmëruar. Ai e kupton që nëse dikush nuk është i përgjegjshëm me makinën e tij, ai nuk do të jetë kurrë i përgjegjshëm as për gjërat e tij. Do të ishte vetëm çështje kohe përpara se zyrat e tij të dukeshin fiks si makina e tij.

Unë e kam kaluar kohën time të stërvitjes në shkretëtirë. Dhe jam i lumtur që Perëndia nuk më lejoi që t'ia hidhja paq për asnjë nga qëndrimet e mia apatike ndaj autoritetit. Ai më përuli dhe më vuri në provë që të mund të më përgatiste për shërbimin tim.

Më kujtohet koha kur paratë ishin jashtëzakonisht të pakta në ditët e shtëpisë në fermë. Fatmirësisht, kisha arritur një investim të madh që do të më ndihmonte të shlyeja faturat e mia, me të cilat kisha gjithmonë vonesa. Por çeku nuk erdhi në kohë, kështu që më lindi ideja e shkëlqyer që do të hapja një llogari rrjedhëse në një bankë që nuk ishte banka ime kryesore dhe atje të nënshkruaja një çek të zbuluar për llogarinë time kryesore, me shpresën se do ta merrja çekun që prisja të nesërmen dhe do ta depozitoja për të mbuluar çekun e zbuluar në bankën e re. Por çeku nuk erdhi për dy javë! Çdo ditë, i nënshkruaja një çek të zbuluar njëerës prej bankave të mia përpara se të vinte çeku i zbuluar. Kjo funksionoi për dy javë dhe shuma e çekut të zbuluar arriti në pak më shumë se 2000 dollarë pasi më duhej të blija ushqime. Gjatë kësaj periudhe kohe, sasia vazhdoi të rritet.

Por gjithçka përfundoi kur menaxherja e bankës më telefonoi herët në mëngjes dhe fjalët e para nga goja e saj ishin: “Z. Kisi, e di se çfarë po bën dhe po e mbyll llogarinë tënde. Ju duhet të sillni paratë për ta shlyer këtë llogari dhe nuk mund të hapni më kurrë një llogari në këtë bankë.” Më zbuluan! Gjëja vërtet e keqe e kësaj situate ishte se po përdorja çeqe ku shkruheshin shkrime të shenjta, si dhe që i kisha dëshmuar menaxheres së bankës se sa i madh ishte Perëndia. Falë Zotit çeku erdhi atë ditë dhe unë munda ta çoja në bankë për të mbuluar

borxhin. Por m'u desh të hyja në zyrën e menaxheres së bankës, të pendohesha para saj dhe t'i thosha që të mos fajësonte Perëndinë, sepse ishte e gjitha vepër e imja, dhe ishte marrëzi.

Pastaj ishte një rast në vitet e mia të para në biznes kur isha duke u trajnuar nga zv. presidenti rajonal. Teksa po shqyrtonte një nga shitjet e mia, ai vuri re se nuk kisha arritur të merrja nënshkrimin në një nga formularët. Ai tha: "Nuk ka problem, thjesht ngrije në dritë dhe gjurmo nënshkrimin e personit aty ku nuk e ka vënë. Në fund të fundit, - tha ai, - klienti e do produktin dhe ka nënshkruar çdo hapësirë tjetër. Dhe kështu bëra. Rreth një muaj më vonë, më telefonoi avokati i klientit tim duke thënë se klienti po më padiste për 100 000 dollarë për falsifikimin e emrit të tij në formularin bankar të tërheqjes. Shuma u reduktua në 5000 dollarë pasi zv. presidenti im rajonal ishte pjesërisht përgjegjës për këtë, dhe atë e pushuan.

Por nuk kisha zënë mend ende! Një nga përfaqësueset e mia të reja duhej të bënte një provim për sigurimet dhe nuk kishte para për të blerë materialin e studimit, kështu që ia fotokopjova që ta përdorte. Ajo e harroi aty ku bëri provimin dhe mua më telefonoi një avokat që po ngrinte një padi për shkelje të të drejtave të autorit. Në ato ditë, e dija rrugën për në zyrën e IRS-së si përmendsh. Gjithmonë përballesha me vonesa të faturave dhe gjoba tatimore. I kujtoj të gjitha këto tani me ndjenja të përziera. Perëndia po më kërkonte llogari, po më trajnonte. Ai e dinte se një ditë do të menaxhoja miliona dollarë dhe nuk më anashkalonte asnjë gabim. Faleminderit Zotit për këtë!

U desh të mësoja se Perëndia është nxitësi im dhe Perëndia nuk nxit vetëm performancën. Edhe integriteti im duhej të vihej në provë. Kjo është arsyeja pse unë them se Zoti tingëllon si shefi yt. Shefi yt është një instrument i përdorur nga Perëndia për të të trajnuar për detyrën tënde të ardhshme dhe për të të mbajtur të nënshtruar. A do ta kalosh provën?

*Sepse lëvdimi nuk vjen as nga lindja, as nga perëndimi, as edhe nga shkretëtira. Sepse Perëndia është ai që gjykon; ai ul njërin dhe ngre tjetrin.*

—Psalmet 75:6-7

*Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij.*

—Hebrenjve 12:11

*Ju, shërbëtorë, bindjuni zotërinjve tuaj sipas mishit me druajtje dhe dridhje, në thjeshtësinë e zemrës suaj, porsì Krishtit, duke mos shërbyer për sy e faqe, si ata që duan t'u pëlqejnë njerëzve, por si shërbëtorë të Krishtit, duke bërë vullnetin e Perëndisë me zemër, duke shërbyer me dashuri si për Krishtin dhe jo si për njerëzit, duke ditur se gjithsecili, qoftë skllav apo i lirë, po të bëjë të mirën, do të marrë shpërblimin nga Zoti. Dhe ju, zotërinj, bëni po kështu ndaj tyre, duke i lënë kërcënimet, duke ditur që i tyre dhe juaj Zoti është në qiell dhe se tek ai nuk ka asnjë anësi.*

—Efesianëve 6:5-9

Bindje me respekt dhe frikë! Ky është qëndrimi që duhet të kesh ndaj shefit tënd. Bindja jote ndaj shefit tënd përkufizohet nga Pali si kryerje e vullnetit të Perëndisë. I befasuar? Isha!

Pra, si është zëri i Zotit? Si i shefit tënd!



**ËSHTË NJË PROVIM!**

Ndërsa e përmbyll këtë studim, besoj se je frymëzuar dhe inkurajuar. Fryma e Shenjtë është me të vërtetë një Partner i mrekullueshëm për t'u pasur në jetë, Partner që ka premtuar se nuk do të të lërë kurrë, as nuk do të të braktisë. Ka qenë një nder i madh të ndaja këto të vërteta të paçmueshme me ty.

—Gary Keese

Për më shumë informacion rreth daljes nga borxhi dhe investimit në mënyrë të sigurt, mund të kontaktosh shoqërinë time, Forward Financial Group, në numrin 1-(800)-815-0818.

Për më shumë informacion rreth Mbretërisë së Perëndisë, shko në adresën [FaithLifeNow.com](http://FaithLifeNow.com).

Për më shumë informacion rreth kishës “Faith Life Church”, shko në adresën [FaithLifeChurch.org](http://FaithLifeChurch.org).



## KAPITULLI 12

# SI TË LUTESH DHE TË MARRËSH PAGËZIMIN E FRYMËS SË SHENJTË

Çdo gjë që marrim nga Perëndia do të merret me anë të besimit në atë që Perëndia na ka thënë dhe marrja e kësaj dhurate nga Perëndia nuk është ndryshe. Përpara se të lutesh për të marrë, sigurohu që të studiosh Shkrimet e Shenjta që janë renditur në këtë libër derisa të sigurohesh se është vullneti i Perëndisë për ty dhe pyetjet e tua të kenë marrë përgjigje. Pasi të sigurohesh se Pagëzimi i Frymës së Shenjtë është për ty, atëherë thjesht bëj këtë lutje:

**“O Atë, unë kërkoj Pagëzimin e Frymës Tënde të fuqishme sot. Unë e marr atë TANI, sipas Fjalës Sate, me aftësinë për t’u lutur në Frymë. E kërkoj këtë në emër të Jezusit dhe për lavdinë Tënde! Amen.”**

Ti nuk po kërkon një përvojë, apo ndjenja të caktuara, por je i palëkundur në Fjalën e Perëndisë, duke besuar se merr kur lutesh. Pasi të kesh kërkuar dhe marrë, fillo të lavdërosh Perëndinë dhe ta falënderosh Atë që të ka vajosur me Frymën e Tij siç ka premtuar.

Kur lutesh, thjesht sigurohu që e kupton se *merr kur kërkon*, jo kur ke manifestuar prova që ke marrë. Prova jote është Fjala e Perëndisë.

*Të gjitha ato që ju kërkonin duke lutur, besoni se do t'i merrni dhe ju do t'i merrni.* (Marku 11:24b).

Sigurohu që të kalosh kohë duke adhuruar Zotin pasi të lutesh që Fryma e Perëndisë të ketë lirinë për ta shfaqur Vetën në gjuhën tënde të lutjes. Perëndia nuk do të bëjë që goja jote të lëvizë! Ti duhet të jesh i gatshëm për t'u lutur në gjuhë. Zakonisht, njerëzit ndiejnë një gjallërim ose shtrengim në stomak kur luten ose ndiejnë Frymën e Perëndisë.

Ndërsa vazhdon të adhurosh, dorëzoja veten Frymës së Perëndisë. Do të fillosh të ndiesh tinguj ose rrokje të ndryshme që dalin nga fryma jote. Ti duhet t'ia dorëzosh veten atyre tingujve me besim. Ndërsa e bën, rrjedhja dhe çlirimi i Frymës së Perëndisë do të rritet.

Nëse për ndonjë arsye nuk lutesh në gjuhë menjëherë, mos u shqetëso për këtë. Ti more me anë të *besimit*, ndaj vazhdo të falënderosh Perëndinë për vajosjen e Tij. Kam parë njerëz që shkojnë në shtëpi pas një mbledhjeje kishe pasi janë lutur për të marrë Pagëzimin e Frymës së Shenjtë dhe thjesht fillojnë të luten në Frymë gjatë rrugës për në shtëpi, në dush mëngjesin tjetër ose ndërsa kositin barin disa ditë më vonë. Çelësi është të marrësh me besim dhe jo me ndjenja.

Bëje lutjen në Frymë një pjesë të çdo dite të jetës sate dhe zhvillo praktikën e të luturit. Perëndia do të të flasë dhe do të të udhëheqë me përgjigje në lidhje me të gjitha gjërat! Unë besoj se do të gjesh kohë për t'u lutur në Frymë dhe për të shijuar të gjitha përfitimet e Mbretërisë së Perëndisë që tashmë i zotëron!

# SHËNIME

1. Jared Dublin, “Jailed fan suing NFL for \$88 billion over Dez Bryant non-catch vs. Packers,” January 23, 2015, <https://www.cbssports.com/nfl/news/jailed-fan-suing-nfl-for-88-billion-over-dez-bryant-non-catch-vs-packers/>.

2. <http://www.dictionary.reference.com/browse/Edified?s=t>

3. Lin Edwards, “Psychologists say babies know right from wrong even at six months,” May 10, 2010, <https://medicalxpress.com/news/2010-05-psychologists-babies-wrong-months.html>.

Vizito **FLNFree.com**  
për të shkarkuar  
më shumë mësimë  
në gjuhën tënde!



A dëshiron më tepër mësimë FALAS në gjuhën tënde?

Vizito **FLNFree.com**

# REVOLUCIONI YT FINANCIAR

## Fuqia e strategjisë

Jeta është e mbushur me vendime madhore.

*Si e di se cilën shtëpi duhet të blesh, me kë të martohesh, apo çfarë pune të kërkosh?*

Nëse do të jesh i suksesshëm, të duhet një strategji. Por si ta krijosh strategjinë kur nuk i ke gjithë përgjigjet?

Sekretet e Perëndisë janë fshehur për ty, jo prej teje.

**Perëndia do që ti t'i kësh përgjigjet që të duhen – dhe prandaj Ai të ka dhënë një armë secrete!**

Në serinë e tretë të librave *Revolucioni Yt Financiar*, Gary Keesee zbulon një nga përbërësit më domethënës të suksesit të tij dhe një të fshehtë KRITIKE të Mbretërisë së Perëndisë: *Fuqia e Strategjisë!* Të gjithë mund të peshkojnë nëse dinë se ku t'i hedhin rrjetat. Perëndia ka përgjigjet që të duhen, por ti duhet të kuptosh si t'i dëgjosh dhe t'i zbatosh në jetën tënde – dhe ky libër flet pikërisht për këtë.

Bashkoju Gary-it në këtë rrugëtim reflektues, dhe zbulo si të zbatosh *Fuqinë e Strategjisë* në jetën tënde!



Gary Keesee është një autor, folës, sipërmarrës, ekspert financiar, dhe pastor që ka një pasion për të ndihmuar njerëzit të jenë fitimtarë në jetë, veçanërisht në fushat e besimit, familjes, dhe financave. Gary dhe gruaja e tij, Drenda, kanë ngritur një sërë biznesesh të suksesshëm, dhe janë themelues të Faith Life Now, që prodhon dy programe televizive – *Fixing the Money Thing* dhe *Drenda*, marrin pjesë në konferenca kudo në botë, dhe kanë burime praktike. Çifti Keesee gjithashtu pastoron kishën Faith Life Church pranë Columbus, Ohio.